Rruga e Arbërit



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (93). JANAR 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

REPORTAZH

Plani i Bardhë, fshati që pret të ringjallet...

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 13

DEBAT

Për një shoqatë të vetme mbarëdibrane

Nga **HYQMET GONXHJA** - FAQE 14

RECENSË

Martini, koha po ndërton për ty një piedestal...

Nga **HYSEN UKA** - FAQE 16

STUDIM

Martesat dibrane më të famshme

Nga **MENTOR HOXHA** - FAQE 12

RADIKA, RRITET VETËDIJA QYTETARE PËR T'I THËNË JO DEVIJIMIT TË UJËRAVE

Radika - **uji** ynë **që nuk falet!**



Lumi Radika. Janar 2014. Foto: © Bardhyl Marku

MENDIMI I SPECIALISTËVE MBI RADIKËN: Studim Tekniko-Ligjor mbi krijimin e rezervuarit artificial të Llukovës nga Prof. dr. Molnar Kolaneci, Ing. hidrolog. Tefik Jegeni, Jurist. dok. Saimir Shatku

Projekti për marrjen e 2 m³ ujë nga lumi i Radikës për në Vardar **është i parealizueshëm**

Pesë ministra shqiptarë në dy qeveri: Nuk ka projekt. Nuk ka vendim. **Vendimmarrja** do të jetë **transparente**

SPECIALE / ÇFARË KA NDODHUR GJATË KËTIJ MUAJI NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN "RADIKA". A PO PUNOHET NË TERREN? SI PO E MBROJNË ÇËSHTJEN ORGANIZATAT MJEDISORE NË SHQIPËRI, MAQEDONI DHE VENDET EUROPIANE? A DO TËRHIQET MAQEDONIA NGA IDEJA E PROJEKTIT APO DO TA RIBËJË PROJEKTIN? A DO TA FINANCOJË BANKA BOTËRORE DHE EBRD PROJEKTIN FUSHA E LLUKOVËS DHE URA E BOSHKUT? ÇFARË MENDOJNË POLITIKANËT NË TË DY SHTETET? RADIKA - ÇËSHTJE MJEDISORE, POLITIKE APO NDËRSHTETËRORE? NJË KRONIKË E ZGJERUAR DHE OPINIONE NGA: ADEM BUNGURI, MOLNAR KOLANECI, TEFIK JEGENI, SAIMIR SHATKU, BARDHYL MARKU, RRUZHDI LATA, IBRAHIM KOLARI, BUJAR KAROSHI, REXHEP TORTE, AHMET ÇAUSHI, MURAT KOLTRAKA, MUNIR HOXHA, ETJ. - **SPECIALE FAQET 2-9**

cyan magenta yellow black 1

Megjithëse bashkëpunimi ndërqeveritar ka qenë në nivele më të lartë si dhe protestat dhe kundërshtimet e organizatave mjedisore kanë qenë të vazhdueshme, duke përfshirë edhe mediat, debati kthehet sërish në pikën fillestare: Ka një projekt për Fushën e Llukovës apo është vetëm një ide?

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 1 (93). 1 - 31 Janar 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Xh.Martini, M. Dume, S.Mëziu, G.Zota, Z. Lleshi,D. Rama, B.Mashkulli, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Adem BUNGURI
Molnar KOLANECI
Tefik JEGENI
Saimir SHATKU
Ibrahim KOLARI
Bardhyl MARKU
Erion BRAÇE
Hysen UKA
Xhafer MARTINI
Hyqmet GONXHJA
Fejzulla GJABRI
Hysen LIKDISHA
Islam CANI
Naxhi HASA
Xhelal ROÇI
Bujar VITIJA
Ullmar QVICK
Mevlud BUCI
Ali HOXHA
Halil RAMA
Hajrush MANI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Radika, rritet vetëdija qytetare për t'i thënë **JO devijimit të ujërave**

Nga **BUJAR KAROSHI**



Fusha e Llukovës në Parkun Kombëtar të Mavrovës. Një projekt i digave në zonë kërcënon diversitetin unik në rajon. Foto: Gabriel Schwaderer / Euro Natur

Radika ishte çështja kryesore e debatit qytetar dhe politik gjatë muajit të parë të vitit 2014. Gjithashtu, për Radikën u fol edhe në dy parlamentet e Maqedonisë dhe Shqipërisë ditën e fundit të muajit. Ndërsa në Tiranë, Ditmir Bushati, ministër i jashtëm i Shqipërisë, gjatë një interpelance deklaronte se "çështja Radika deri më tani është një çështje mjedisore, energjetike, ekonomike, por nuk është një çështje ndërshtetërore", në anën tjetër, në Shkup, kryeministri Nikola Gruevski deklaronte se "nëse projekti tregon në të vërtetë se ka probleme, kjo do të çojë në anullimin e projektit ose do të rishihet, për të eliminuar çdo lloj dëmi të mundshëm".

Megjithëse bashkëpunimi ndërqeveritar ka qenë në nivele më të lartë dhe protestat dhe kundërshtimet e organizatave mjedisore kanë qenë të vazhdueshme, duke përfshirë edhe mediat që kanë dhënë informacione, edhe sqaruese, debati kthehet sërish në pikën fillestare: Ka një projekt për Fushën e Llukovës apo është vetëm një ide? Do devijohen ujërat e Radikës apo jo?

RADIKA, ÇËSHTJE MJEDISORE EUROPIANE

Projekt ideja e qeverisë maqedonase për ndërhyrje të dhunshme në mjedis, në një Park Natyrorë si Mavrova, ka shqetësuar edhe opinionin e ambientalistëve europian. Duke i konsideruar problemet e ruajtjes së mjedisit si një detyrë dhe përgjegjësi globale, ata shqetësohen e solidarizohen me lëvizjen tonë qytetare, veç të tjerash duke na dhënë edhe një mësim, qeverive dhe qytetarëve, si të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, se që të integrohesh në bashkësinë e vendeve europiane, duhet të rrisësh përgjegjësinë edhe për mjedisin. Qeveritë dhe shoqëritë që dezintegrojnë dhe shpërdorojnë mjedisin, nuk mund të pretendojnë integrimin në BE. Ky është një mësim që duhet ta përvetësojmë sa më shpejtë, krahas edhe shumë mësimeve tjera që na vijnë nga BE, që rruga e integrimit të jetë më e shkurtër dhe dita e anëtarësimit të jetë më afërt.

Në fillim të vitit, ENDECOCIDE, një organizatë që është kundër dëmeve të mëdha apo të shkatërrimeve të ekosistemeve në Europë, është kundër ndërtimit në Parkun Kombëtar të Mavrovës. Për këtë, ajo ka hapur një peticion online. Peticioni po mbështetet nga "Iniciativa e Qytetareve Europiane", një organizëm i krijuar nga Traktati i Lisbonës për të promovuar demokracinë pjesëmarrëse dhe të drejtpërdrejtë. Peticioni është i vlefshëm në 28 vendet e Bashkimit Europian. Që nisma të shkojë në Parlamentin Europian, duhet të mblidhet së paku 1 milion vota nga një minimum prej 7 vendeve të ndryshme në mënyrë që ajo të konsiderohet nga Komisioni Evropian. Kur kjo arrihet, Komisioni Evropian do të shqyrtojë propozimin me organizatorët dhe për t'u dhënë atyre një shans për të folur në një dëgjim publik në Parlamentin Evropian.

Ndërkohë, Gabriel Schwaderer, president i EURONATUR Foundation dhe dhe Ulrich Eichelmann, president i River Watch, i kanë shkruar një letër z.Suma Chakrabarti, president i EBRD dhe Dr. Jim Young Kim, president i World Bank, dy financuesit e projektit "Fusha e Llukovës". Letra e tyre është nënshkruar nga 119 personalitete dhe shkencëtare të mjedisit dhe natyrës dhe u kërkojnë atyre që EBRD dhe Banka Botërore të mos e financojnë projektin. Përfaqësues të këtyre organizatave, shkruajnë më 14 dhe 15 janar mediat në gjuhën maqedonase, "24 Vesti", "Build.mk" dhe "Slobodenpecat" (Shtypi i lirë), së bashku me koalicionin e organizatave mjedisore "Mjedisi prioritet", "Koalicioni për mbrojtjen e Natyrës" dhe "Natyra 2000", hartuan "Deklaratën për Shpëtimin e Parkut Kombëtar të Mavrovës" dhe ia nisën kryeministrit të Maqedonisë, Nikolla Gruevski dhe ministrit të mjedisit dhe planifikimit hapësinor, Abdulaqim Ademi.

Menjëherë pas bërjes publike të këtij dokumenti, zëdhënësi i qeverisë maqedonase Aleksandër Gjorgjiev theksoi se "Maqedonia është e vendosur për ta vazhduar projektin Fusha e Llukovës".

NISIN PROTESTAT

Pas kësaj deklarate, shoqatat mjedisore në Dibër, në të dy shtetet, si dhe Aleanca Kundër Devijimit të Lumenjve, paralajmëruan protesta. Protesta e parë ishte më 19 janar në Peshkopi dhe Tiranë. Protestuesit i kërkonin qeverisë shqiptare që ti thonë JO këtij projekti.

Më 20 janar, deputeti i Dibrës që i përket LSI inicoi një interpelancë me ministrin e jashtëm Ditmir Bushati, nismë e cila u bë publike nga prej drejtuesve kryesore të LSI. Më 23 janar, po ashtu, nxitur nga reagimet publike, kryeministri Edi Rama tha në parlament se "Nuk ka projekt! Sepse projekti në këtë rast, nuk quhet një ide apo një skicë-ide e një qeverie tjetër, por quhet një projekt-zbatimi që e ka në tryezë edhe qeveria jonë, përderisa përfshin apo prek edhe Shqipërinë. Por as ne nuk e kemi një të tillë, as qeveria maqedonase nuk e ka një të tillë. As Banka Botërore nuk e ka financuar një të tillë. As bëhet fjalë që një projekt i tillë të financohet nga Banka Botërore apo nga cilido institucion financiar ndërkombëtar pa miratimin edhe të qeverisë së Shqipërisë dhe në respekt të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare", deklaroi zoti Rama.

Zëri i Amerikës në kronikën e lajmeve të po kësaj dite, citonte zyrtarë të Bankës Botërore në Shkup të cilët deklaruar se me "kërkesë të qeverisë së Maqedonisë, Banka Botërore po punon për projektin energjetik të "Fushë Llukovës". BB është duke bërë ende vlerësime për projektin e paraqitur që prej vitit 2011, e sipas të cilit, sasia e ujërave që parashikohet të devijohen në kaskadën e Mavrovës do të jetë më e vogël se 2 metra kub për sekondë. Por meqë ky devijim ujërash prek edhe vendet fqinje, si Shqipërinë, Kosovën dhe Greqinë, sipas rregullave të Bankës Botërore, këto vende duhet të vihen në dijeni".

Kryeministri i Shqipërisë zhvilloi më 24 janar një takim të përbashkët mes ministrit të jashtëm, atij të mjedisit dhe të energjisë si dhe me dy ministrat shqiptarë të qeverisë së Maqedonisë, që drejtojnë ministritë e energjisë dhe mjedisit, Saraçini dhe Ademi. Pas këtij takimi, kryeministri Edi Rama shkroi në faqen e tij zyrtare në FB: "Sot me dy ministra shqiptarë të qeverisë së Maqedonisë për të rinënvizuar njëzëri se burimet natyrore të shqiptarëve as nuk mund të cënohen në mënyrë të njëanshme dhe as mund të negociohen në dëm të Shqipërisë. Nëse do të ketë projekt ai do të gjykohet nga shqiptarët me përgjegjësi të plotë kombëtare dhe në respekt të plotë të marrëveshjeve ndërkombëtare. Zhurmë e kotë pseudopatriotike me synime politike për një problem që nuk ekziston!".

Të pesë ministrat dolën në një konferencë të përbashkët shtypi dhe dhanë shpjegime lidhur me çështjen "Radika".

Pas deklaratave të pesë ministrave, u duk se situata po merrte një rrugë për mirë për zgjidhje, por media zbuloi një dokument të ish-ministrit të ambientit dhe planifikimit hapësinor, Nexhati Jakupi. Gjatë kohës kur ai ka qenë ministër ka nënshkruar një dokument për studimin që duhet të bëhet në lidhje me ndikimin e projektit "Fusha e Llukovës" në ambientin jetësor. "Bëhet fjalë për një projekt të rëndësishëm infrastrukturor dhe ky projekt kalon me disa procedura të parapara me ligj, duke filluar nga studimi i tij. Fillimisht, ky projekt kërkon miratim të studimit për mbrojtjen e ambientit jetësor, kjo është baza, jo vetëm ky, po çdo projekt infrastrukturor, në këtë rast projekti energjetik "Fusha e Llukovës", deklaron Nexhati Jakupi. "Duhet të përqendrohemi në atë se ka projekt-ide dhe jo projekt përkatës, citohet të ketë thënë Jakupi për agjencinë e lajmeve PORTALB. Jakupi mohon faktin se në vendngjarje kanë nisur punët dhe se akoma nuk ka projekt".

Pas këtyre deklarimeve kontradiktore, një anëtar i shoqërisë civile në Dibër tha se tani "Dibranët nuk i besojnë më asnjërit prej ministrave dhe as funksionarëve tjerë pasi flasin ndryshe në çdo paraqitje të tyre, pra ndryshe në Dibër, ndryshe në Tiranë dhe ndryshe në mbledhjen e qeverisë së Maqedonisë".

Dy ditë më vonë, më 26 janar, në debat u përfshi edhe kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski, i cili deklaroi se "Kjo Qeveri asnjëherë nuk ka bërë projekte me të cilat e ka dëmtuar dikë, më së paku njerëzve të vendit, por edhe vendeve fqinje. Ky është një projekt të cilin e udhëheqim bashkë me Bankën Botërore. Banka Botërore përgatit edhe projekt ekologjik, i cili duhet t'i tregojë përparësitë dhe dobësitë eventuale, ku pas këtij projekti do të sillet edhe vendimi përfundimtarë. Kuptohet, nëse projekti dëshmon se nuk ka ndonjë dëm serioz për natyrën, ambientin jetësorë, për qytetarët, në atë rast do të vazhdojmë më tej dhe projektin do ta realizojmë", tha ai.

Pas këtyre deklaratave, deputetja dibrane në parlamentin e Maqedonisë, Luljeta Marku, u shpreh e vendosur kundër projektit. "Jam kundër ndërtimit të objekteve energjetike në lumin Radik në rrjedhën natyrore të lumit, mirëpo jam edhe kundër ndërtimit të objekteve energjetike me devijimin e lumit Radika. Këtë e them pasi është e qartë që do të ketë një katastrofë ekologjike dhe të ekosistemit", tha ajo. Deputetja Marku propozoi edhe mundësinë e miratimit të një ligji, i cili do të pengojë devijimin e rrjedhës së Radikës.

Gjithashtu, Dardan Gashi, ministër i ambientit dhe planifikimit hapësinor në qeverinë e Republikës së Kosovës, deklaroi për Top Channel se "qeveria e Kosovës nuk ka asnjë njoftim zyrtar nga ana e qeverisë së Maqedonisë dhe se "Kosova nuk do të miratojë asnjë projekt që është në dëm të Shqipërisë".

Siç shihet edhe nga deklarimet e zyrtarëve të lartë të tre shteteve, çështja nëse ekziston apo nuk ekziston projekt, është akoma e paqartë. "Ekziston një projekt ideor, por deri në këtë moment nuk ka një projekt zbatues. Ministrat shqiptarë përdorin termin "projekt final". Ata me termin "projekt final" nënkuptojnë projektin zbatues, apo në mungesë të njohurive apo me qëllim për të qetësuar njerëzit, ata thonë se nuk ka projekt fare", thotë Bardhyl Marku, i cili e njeh problemin që në fillesat e saj. "Ministrat në qeverinë e Shkupit duhet të sqarojnë në bazë të cilit projekt ideor është punuar deri më tani dhe cilat janë rezultatet që tregojnë studimet mjedisore, ndikimin në mjedis, avantazhet energjetike dhe ndikimin social", thota ai. ⟶



Mala Reka në Mavrovë, Park Kombëtar. Një projekt i financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, parashikon vendosjen e një dige në këtë lum. Pasi diga të jetë ndërtuar, uji do të rrjedhë vetëm nëpërmjet shtratit të lumit një herë në ditë, në formën e një përmbytje të shpejtë.
Foto: Ulrich Eichelmann / RiverWatch

Megjithëse bashkëpunimi ndërqeveritar ka qenë në nivele më të lartë dhe protestat dhe kundërshtimet e organizatave mjedisore kanë qenë të përditshme, duke përfshirë edhe mediat që kanë dhënë informacione të vazhdueshme, edhe sqaruese, debati kthehet sërish në pikën fillestare: Ka një projekt për Fushën e Llukovës apo është vetëm një ide? Do devijohen ujërat e Radikës apo jo?

“Ambientalistët në Maqedoni janë kategorikisht kundër projekteve të qeverisë në lidhje me hidrocentralet “Ura e Boshkut” dhe “Fusha e Llukovës”. Koalicioni i shoqatave mjedisore në Shkup në deklaratat pwr shtyp tw dhwnw mw 23 dhe 31 janar 2014, thonë se me ndërtimin e këtyre dy digave, Parku i Mavrovës do të humbë statusin e saj Kombëtar dhe se qytetarët nuk do të marrë ndonjë përfitim. “Është e palogjikshme që të shkatërrohet ekosistemi për të ndërtuar një hidrocentral të vogël, i cili do të prodhojë energji elektrike vetëm në një pjesë të caktuar të vitit”.

→ A PO PUNOHET NË KORAB?

Ambientalistët në Dibër thonë se gjatë verës është punuar në mbledhjen e ujërave në burimet e Radikës. Informacione nga terreni, njerëz që kanë parë makineri të rënda të kalonin andej, apo edhe nga ata që ishin punësuar për ca ditë, tregonin pas nisjes së protestave për atë që kishin parë dhe dëgjuar. “Unë kam parë disa kamionë me tubacione me diametër rreth 2 metra, të kalojnë andej, citon një banor të Dibrës një përfaqësues i një shoqate ambientaliste në Dibër. Por fatkeqësisht, nuk kemi video apo fotografi”. Për ta vërtetuar këtë, duhet të pritet muaji prill, kur të hapet rruga dhe të mos ketë rrezik nga ngricat.

Bashkim Mashkulli, kryetar i Këshillit Komunal të Dibrës, tha për gazetën “Rruga e Arbërit” pas protestës së 23 janarit në Tiranë, se ndërmarrja ndërtimore “Beton” ka bërë punime. “Përroi i Kadiut, thotë Mashkulli, është devijuar tashmë, por ndërkohë po punohet në Përroin e Thellë, për të cilën kanë protestuar shoqatat mjedisore europiane që të mos ndodhë”.

“Për ti vërtetuar këto dyshime duhet që të shkohet në terren, por rruga rreth 12-15 km e gjatë dhe ka disa burime të vogla, të cilat tani e kanë shndërruar krejt atë pjesë të rrugës në akull, prandaj nuk mund të udhëtohet andej”, thotë Bardhyl Marku.

Petr Hlobil, drejtor i çështjeve ndërkombëtare në “CEE Bankwatch Network”, një organizatë që punon në të gjithë rajonin e Europës qendrore e lindore për të monitoruar aktivitetet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe që merret me propozimet e alternativave konstruktive mjedisore dhe sociale të politikave dhe projekteve që ata mbështesin, vizitoi në mesin e vitit 2012 Maqedoninë. Ai kërkoi të vizitonte zonën ku do të ndërtohej hidrocentrali i Llukovës, por “në mënyrë ironike, kur kërkuam leje për të vizituar zonën e “Fusha e Llukovës” jo vetëm që na u mohua leja por autoritetet kërkuan që të ishte e nevojshme që disa prej stafit të tyre të mbikëqyrnin praninë tonë”. “Ne besojmë që disa prej zonave duhet të jenë dukshëm zona të ndaluara, shkruan ai opinionin e tij në bankwatch.org, por kjo duhet të aplikohet si për buldozerët ashtu edhe për ambientalistët.”

Gazetari Philip Bethge i revistës gjermane “Spiegel” vizitoi Vjosën dhe Radikën për të parë në realitet shqetësimin e ambientalistëve europianë. “Luftë për hidrocentralet: digat kërcënojnë lumenjtë e fundit të egër në Europë”, ishte titulli i tij te Spiegel Online. Ai bën një pasqyrë të veprave hidroenergjetike në Shqipëri dhe Maqedoni, dhe thekson se në nevojën për energji në rritje, efektet mjedisore janë një hap pas. Bethge e shoqëron shkrimin e tij me disa foto nga terreni, të cilat janë bërë nga Ulrich Eichelmann dhe Gabriel Schwaderer, drejtuesit e dy organizatave mjedisore RiverWatch dhe Euro Natur.

REAGIMET KUNDËR

Pas shkrimtarëve Kim Mehmeti, Agim Vinca, personalitete të tjera të kulturës, artit dhe politikës kanë reaguar kundër projekt idesë për devijimin e ujërave të Radikës.

Artan Fuga, sociolog i njohur, në një postim të tij në faqen personale të FB, shkruan se “Nuk matet vlera e lumenjve me sasinë e sotme të prurjeve. Matet me dëmin në mikroklimë, me nevojat e nesërme të brezave shqiptare, me energjinë elektrike që një prurje e madhe jep shumë më tepër, me prurjet në kohë thatësire, me aftësitë ujitëse dhe rendimentet në bujqësi, me strategjinë në marrëdhëniet me fqinjët, etj. Po ashtu, për ujërat e lumenjve kombet hidhen në zjarr.”.

Pandeli Majko, deputet i Partisë Socialiste në parlamentin e Shqipërisë, ish-kryeministër në kohën e luftës në Kosovë, i cili ka një ndjeshmëri të lartë ndaj çështjeve të shqiptarëve në Ballkan, iu bashkua iniciativës kundër devijimit të Radikës. “Dibranët historikisht kanë ditur ti zgjidhin punët e veta. Ata nuk janë individë që kërkojnë dhe ankohen duke u qarë për problemet që jeta u nxjerr përpara. Dibra ka nxjerrë njerëz që njohin fjalën përpara të bërtiturës. Qetësia dhe urtësia gjithmonë ka fshehur trimërinë që mbart karakteri i tyre. Kam vendosur të jem pjesë e “Besëlidhjes së Radikës”, pasi sot dibranët kanë nevojë dhe po kërkojnë ndihmën e cilitdo që dëshiron ta japë atë. Duhet të pohojmë vetveten duke dalë në krah të shqiptarëve në Maqedoni, pa asnjë dallim politik, krahinor dhe shtetëror. Ata janë vëllezërit tanë dhe interesat e tyre janë edhe tonat. Forca e një kombi është e barabartë me forcën e asaj pjese të tij, mbi të cilën ushtrohet presion më i madh...”, shkruan ai në Facebook.

MEDIAT DHE RADIKA

ALSAT M është një nga televizionet kombëtare në Maqedoni që emeton programe në gjuhën shqipe dhe maqedonase. Televizioni i ka injoruar lajmet mbi Radikën që nga nisja e protestave. Megjithatë, ditët e fundit të muajit, ka filluar të përcjellë lajme për Radikën. “Pas reagimeve të shumta të popullatës nga rajoni i Dibrës, të organizatave ekologjike nga Maqedonia dhe jashtë saj, dhe pasi që çështja mori dimensione ndërkombëtare, Ruzhdi Lata, kryetar i komunës së Dibrës, ishte i ftuar në emisionin ‘15 minuta’, më 29 janar, me temën ‘Fusha e Llukovës’.

“Nëse studimi për “Fushën e Llukovës” tregon se akumulimi është i dëmshëm për mjedisin, financuesi i projektit, Banka Botërore do të tërhiqet nga ndërtimi i liqenit artificial”, citon televizioni Alsat M, Ranxhit Lameku, zyrtare e BB në Maqedoni.

Edhe televizioni proqeveritar TELMA në Shkup i kushtoi një hapësirë të madhe më 31 janar konferencës së organizuar nga dy koalicionet e shoqatave mjedisore, të cilat sollën argumente dhe fakte se pse ishin rreshtuar kundër investimit në Fushë të Llukovës dhe Urës së Boshkut.

Ndërsa televizionet dhe gazetat në Shqipëri i kanë kushtuar një vëmendje të posaçme çështjes. Emisione të përgatitura enkas për këtë rast, por edhe kronika nga terreni, ishin të pranishme gjatë muajit. Një autobus me gazetarë nga media të ndryshme të shkruara dhe vizive vizituan Dibrën e Madhe në mes të muajit, duke përcjellë edhe shqetësimin e komunitetit vendas.

Ndërsa të enjten, më 30 janar 2014, në Radio Shkupi, programi në gjuhën shqipe, organizoi një emision të hapur, me lidhje të drejtpërdrejtë edhe me studio në Tiranë dhe Prishtinë.

REAGIM I ORGANIZATAVE MJEDISORE NË MAQEDONI

Ambientalistët në Maqedoni janë kategorikisht kundër projekteve të qeverisë në lidhje me hidrocentralet “Ura e Boshkut” dhe “Fusha e Llukovës”. Në një deklaratë për shtyp më 23 janar 2014, ata thonë se me ndërtimin e këtyre dy digave, Parku i Mavrovës do të humbë statusin e saj Kombëtar dhe se qytetarët nuk do të marrë ndonjë përfitim. “Ata thonë se është e palogjikshme që të shkatërrohet ekosistemi për të ndërtuar një hidrocentral të vogël, i cili do të prodhojë energji elektrike vetëm në një pjesë të caktuar të vitit”.

“Hydropeaking (një metodë për prodhimin e energjisë elektrike që do përdoret për hidrocentralin Ura e Bashkut, që nënkupton vërshimin e ujërave në formën e përmbytjeve një herë në ditë), thonë ata, do ta shkatërrojë ekosistemin në këtë rajon. Ata argumentojnë se paratë për ndërtimin e dy digave mund të përdoret për të zëvendësuar dy blloqe shkatërruara në termocentralit të Manastirit si dhe për të financuar realizimin e hidrocentraleve “Çebren “ dhe “Galishte “, të cilat aktualisht përdorin teknologji të vjetër të prodhimit të energjisë.

“Parqet kombëtare janë zona ku është e ndaluar ndërtimi i hidrocentraleve të madha dhe çfarëdo forme tjetër e shfrytëzimit duke shkatërruar mjedisin”, thonë organizatat mjedisore në Maqedoni, cituar nga gazeta “Shtypi i lirë”. “Në peizazhin malor të Mavrovës jetojnë ujq, arinj, lundërza dhe rriten mbi 1000 lloje të bimëve që janë në listën e bimëve të mbrojtura në një numër të konventave ndërkombëtare. Por, banori më interesant është rrëqebulli i Ballkanit, një nënspecie e rrëqebullit të Euroazisë. Sot ka vetëm rreth 50 çifte të këtyre maceve të rralla, dhe deri më tani ka dëshmi për shumimin e tij vetëm në Parkun Kombëtar të Mavrovës. Ndërtimi i këtyre projekteve hidroenergjetike mund të nënkuptojë fundin e rrëqebullit të Ballkanit!”, - thuhet në një deklaratë të përbashkët të këtyre organizatave.

Më 22 janar, mbi 30 shoqata nga Gostivari, u janë bashkangjitur shoqatave të tjera në Maqedoni, duke nënshkruar një letër proteste, kundër ndërtimit të hidrocentralit në Fushë Llukovë. Koordinatori i këtyre shoqatave, Lulëzim Fejzullai shpjegon arsyet: “Konsiderojmë se dëmtohet bota bimore, dëmtohet bota shtazore, humbet biodiversiteti, ç’rregullohet bota nënujore e lumenjve, disbalancohet ekosistemi, zhduken llojet e shtazëve në rrezik, siç është Rrëqebulli (macja e egër), shkaktohen ndryshime klimatike dhe humbet kapaciteti për zhvillim të blegtorisë”.

ALEANCA KUNDËR DEVIJIMIT TË LUMENJVE

Aleanca “është bashkim rajonal qytetarësh të ndjeshëm ndaj çështjes së devijimit të lumenjve Vjosa dhe Radika dhe ka si qëllim të bëjë presion veçanërisht ndaj qeverisë shqiptare që të kundërshtojë projektet e qeverive të Greqisë dhe Maqedonisë. Qëndrimet tona janë tërësisht qytetare, demokratike dhe ligjore”, thotë Albi Bardhi, drejtues i saj. Ai shton se “përjashtojmë të gjitha format e reagimit agresiv, nacionalist dhe partiak. Dënojmë të gjitha qëndrimet e shprehura nga individë që nuk respektojnë frymën e Aleancës”.

Kjo ishte një nismë e disa të rinjve që po e ndiqnin këtë problem me shumë vëmendje si Vehap Kola, Ilir Kaso etj. Ilir Kaso ka qenë pjesë e një studimi që është bërë në lumin Vjosa që në korrik të vitit të shkuar dhe ka bërë dhe një dokumentar për këtë çështje. Ai thotë se ne “nuk mbështetemi vetëm te protestat, por po shohim dhe po kërkojmë forma të tjera legjitime. Ndoshta duhet një referendum lokal për të gjithë ato zona që preken nga devijimi i lumit Radika, dhe pasi të merrni përgjigje zyrtare që projekti nuk do të realizohet t’i kërkoni qeverisë së Maqedonisë që të kërkoj falje publike për çdo shqetësim që ka sjellë”.

Vehap Kola shprehet se ndërkohë, disa organizata dhe shoqata, po dalin më media dhe po flasin në emër të Aleancës. “Konferenca e fundit për shtyp mbajtur më 31 janar në Hotel Tirana, nuk ka të bëjë me aleancën. AKDL ka pranuar të bashkëveprojë edhe me individë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për të bashkuar përpjekjet për kauzën e ruajtjes së rrjedhës natyrore të lumenjve Radika dhe Vjosa. Ky bashkëveprim është ngritur mbi parimin se nuk do të lejojmë të devijohet asnjë cm3 ujë nga rrjedha natyrore e Radikës dhe Vjosës si dhe kërkesa jonë i drejtohet qeverisë shqiptare dhe vetëm asaj”. “Edhe pse këto projekte janë iniciuar nga qeveritë e vendeve fqinje, ne besojmë se qeveria shqiptare ka detyrimin të përfaqësojë interesat tona dhe është në pozitën të ndalojë çdo projekt të tillë të dëmshëm”, thuhet në deklaratën e saj.

Aleanca ka nisur edhe një peticion online nëpërmjet faqes www.secure.avaaz.org (shih linkun në fund të shkrimit), ku i kërkojnë qeverisë shqiptare të mos e pranojë këtë fakt, duke respektuar kështu edhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe direktivat e BE për mjedisin. “1 Milion Shqiptarë Kundër” është sllogani i peticionit, duke u bërë thirrje 1 milion shqiptarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë që të firmosin peticionin si presion ndaj qeverisë për të mos marrë asnjë vendim në dëm të interesit kombëtar. Në këtë faqe janë mbledhur rreth 1500 firma, shumë pak në krahasim me synimin.

RRJETET SOCIALE: TË MBROJMË LUMIN RADIKA

TË MBROJMË LUMIN RADIKA ishte faqja e parë e hapur në FB për mbrojtjen e ujërave. “Faqja synon tu ikë argumenteve për të bërë politikë”, shkruan administratori i saj. “Ne synojmë bashkimin e qytetarëve me qëllimin që të mbrohet Radika. Ky grup iniciues, me entuziastë që qëndrojnë në mbështetje të lumit Radikë dhe në mbështetje të ambientit jetësor, nuk është grup i iniciuar nga interesat e ndonjë bashkësie etnike; nuk është grup i iniciuar nga ndonjë parti politike dhe as që përkrah ndonjë parti politike, por është grup që i mbron dhe i përfaqëson interesat e të gjithë qytetarëve që kanë prekje me ekologjinë, me lumin Radikë dhe me liqenin e Dibrës... Lumi Radika u takon të gjithë qytetarëve, por jo shoqërisë aksionare, ELEM”, thekson administratori i faqes. Ai ndërkohë, ju lutet qytetarëve që të postojnë vetëm lajme, ngjarje apo fotografi që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lumit Radika. Faqja përcjell lajme në gjuhën shqipe dhe maqedonase dhe njofton se “komentet me konotacion politik do të fshihen menjëherë”.

Ndërkohë që gazeta bëhet gati për shtyp, administratorët e faqes së mësipërme u bëjnë edhe një thirrje anëtarëve të saj, që të shkruajnë

(Vijon në faqen 4)

Rruga e Arbërit nr. 93

opinion



Parku Kombëtar i Mavrovës në Maqedoni është i kërcënuar nga projektet e digave. Kjo luginë e veçantë në malet e larta Alpine do të gëlltitet plotësisht nga një rezervuari që po planifikohet të ndërtohet në Fushën e Llukovës. Foto Ulrich Eichelmann / RiverWatch

Radika, rritet vetëdija qytetare për t'i thënë **JO devijimit të ujërave**

(Vijon nga faqja 3)

me emrat e tyre të vërtetë, duke treguar kështu një shkallë të lartë civilizimi dhe qytetarie.

Faqja numëron mbi 1100 anëtarë në fund të muajit dhe është vazhdimisht në përcjellje të lajmeve mbi Radikën.

Ndërkohë, është edhe një faqe tjetër që ka një numër më të madh anëtarësh, me titull "STOP Devijimit të rrjedhës të lumit Radika". Faqja, ashtu si e para, ka qëllim të grumbullojë fakte dhe ide për ta mbrojtur çështjen si dhe përcjell, kryesisht, raportime që media të ndryshme në Tiranë dhe Shkup i bëjnë çështjes.

SULMOHET FAQJA NË INTERNET SAVERIVERRADIKA.COM

Pas nisjes së problemit të Radikës, dhe nga nevoja për më shumë informacion për qytetarët, Gazmend Kërkuti, një dibran që jeton në New York, hapi webfaqen saveriverradika.com.

"Vëreja se shumë njerëz përpiqeshin në rrjetet sociale, kryesisht në FB, të sensibilizonin njerëz dhe të mblidhnin informata për atë që po ndodhte në terren. Por, më shqetësonte fakti se nuk mund t'i thuash një shkencëtari, politikani apo ambijentalisti, më bëj mik në facebook, pastaj aty, ndër fotografitë e dasmës, të vajzës, të familjes, të drekave dhe darkave do të gjesh tekstin apo dokumentin që kam shkruar për Radikën! Duhej diçka më profesionale, dhe kjo është një webfaqe e përkushtuar vetëm për protestën kundër devijimit të Radikës", thotë ai.

"Por nuk ishte vetëm kjo arsyeja, shpjegon Kërkuti. Desha të bëj edhe unë diçka për Radikën. Ja kemi borxh! Unë kam pirë ujin e tij, babai im, gjyshi, stërgjyshi dhe deri tek njeriu i parë që ka shkel mbi atë tokë kanë pirë ujin e Radikës! Trupi ynë është krijuar me këtë ujë. Tregom tani, si mund të heshtë!"

Dhe webfaqja e kreu një ndër synimet e veta menjëherë pas hapjes së saj dhe mbledhjes së materialeve. Ambijentalisti gjerman Robert Wager kontaktoi Gazmendin dhe në këtë mënyrë mori udhë protesta e 119 shkencëtarëve europiane të Euronatur dhe RiverWatch, të cilët dërguan një ankesë pranë Bankës Botërore, EBRD dhe qeverisë maqedonase.

Tani Webfaqja, edhe pse vetëm 3 muaj online, ka nga 50 deri në 400 vizitorë në ditë, nga të gjitha vendet e Europës. Por, faqja nuk ka vetëm vizitorë, por edhe sulme. Vetëm gjatë janarit ajo është sulmuar mbi 50 herë për tu vjedhur nga hakerat. Shumica e tyre nga IP në Rusi, ndërsa më seriozja ishte nga një IP e një biznes të madh në Shkup. "Kjo ndodh, thotë Gazmendi, sepse u prishim punë atyre që ndërtojnë një projekt të tillë antikombëtar. Ata dëshironin që kjo gjë të mos bëhet e zhurmshme nëpër mediume. Falë këtij grupi aktivistësh jemi këtu ku jemi sot, dhe nuk do të ndalemi derisa përsëri ministrat të rreshtohen dhe të thonë përfundimisht se nuk e prekim Radikën dhe ky projekt ka marrë fund!"

"Njerëzit më shkruajnë emaile çdo ditë. Me falënderojnë. Janë tepër të kënaqur sepse ua bëjmë më të lehtë për të shkarkuar informacione specifike vetëm për çështjen e Radikës. Kemi marrë komplimente edhe nga politikanë që janë mirënjohës për angazhimin që bëjmë për të shpëtuar tharjen e Radikës. Vlen të theksoj që, Pandeli Majko, në profilin e tij në Facebook, ka përdorë fotografinë e një vajze dibrane me parullën "SAVERIVERRADIKA", produkt i besëlidhjes për shpëtimin e Radikës".

A po i shikon avantazhet e faqes Gazmendi? Sigurisht që po. "E mira e momentit, thotë ai për gazetën, është që njerëzit u informuan se çfarë po planifikohet për Radikën. Kjo është edhe qëllimi i nismës tonë. Patëm protesta në Dibër, në Peshkopi, Tiranë dhe New York. Tani do të presim vendimin e Bankës Botërore, pastaj në Qershor të presim vendimin e shtetit Maqedon. Jam i sigurt që ndërkohë, ELEM do të kthehet me ndonjë formë tjetër negociuese! Tani duhet të kemi më shumë kujdes se kurrë, pasi ata po blejnë kohë! Heshtja për 5 muajt e ardhshme është strategji për të na vendosur në gjumë, ndaj duhet patur kujdes".

Gazmendi edhe herë të tjera ka kontribuar me video, foto, lajme nga Dibra nëpërmjet faqes dibra.org, por kur njerëzit filluan të mos shihnin te Dibra vetëm fotot e mira, por edhe gjërat e këqija që nuk duhej të ndodhnin, ai u sulmua nga zyrtarë dhe qeveritarë, me pretekstin se kështu nuk po ndihmonte "në të mirë të Dibrës". Kështu që vendosi ta mbyllte faqen. "Ndoshta bëra gabim, thotë tani ai. Po ta kishim faqen funksionale, ndoshta opinioni do të kishte pasur më shumë mundësi të informohej për atë që po i përgatitej Radikës që prej dy vitesh".

Ata që e lexojnë tani këtë tekst, mund ta bëjnë një "klik" te www.SaveRiverRadika.com. Do mësojnë shumë më shumë se sa po lexojnë në këtë shkrim.

ÇDO TË NDODHË?

Ministrat e BDI, partisë në qeverisje në Maqedoni, gjithë kohën kanë qenë në rrjedhë me këtë proces, por asnjëherë nuk kanë thënë JO, thotë Bardhyl Marku. Ka dy shpjegime lidhur me këtë: ose nuk kanë lexuar fare çfarë nënshkruajnë, ose nuk kanë pasë fuqinë t'i thonë JO këtij projekti".

Këto 5-6 vitet e fundit, dy ministritë kryesore që kanë lidhje me çështjen, ajo e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe ekonomisë, janë drejtuar nga shqiptarë. Para Abdulaqim Ademit që është sot ka drejtuar Nexhat Jakupi, ndërsa para Valon Saraçinit ka qenë Fatmir Besimi. "Tani kanë dalë dokumente që vërtetojnë se ata e kanë ditur, por nuk kanë reaguar, thotë Bardhyl Marku. Ai i ka dërguar edhe një letër Këshillit Komunal në Dibër të Madhe, nga e cila kërkon që të formohet një grup ekspertësh për të siguruar informata zyrtare dhe për të përpiluar një strategji për veprime të mëtejshme.

Gjithashtu, thotë Bardhyli, ne jemi edhe në pritje vlerësimit të ndikimit social në mjedis që pritet të dalë së shpejti, për të parë rrugët dhe mundësitë se si do veprojmë më tej në këtë çështje.

LINKU I PETICIONIT KUNDER DEVIJIMIT TE LUMENJVE
https://secure.avaaz.org/en/petition/Qeveria_e_Shqiperise_Government_of_Albania_Te_mos_lejohet_te_ndalohet_devijimi_i_lumenjve_VJOSA_dhe_RADIKA/?cYIvdgb

Lumi i Radikës përshkon nga veriu në jug zonën e Rekës. Kjo zonë përfshin 28 fshatrat e Rekës së Poshtme dhe të Epërme, që shtrihen në të dy anët e lumit të Radikës, nga Kosovrasti në jugperëndim deri në qafën e Mavrovës dhe të Dufit në verilindje.

Përmbytja e fushës së madhe të Udovës, me sipërfaqe 1340 ha, më e madhja dhe më pjellorja fushë e Dibrës, ishte hapi i parë i sulmit ndaj Dibrës. Asaj i hiqej qëllimisht baza kryesore ekonomike, pasuria më e madhe e saj, që e kishte qenë baza e zhvillimit të qytetërimit ilir që nga kohët prehistorike, antike e mesjetare dhe kishte ushqyer popullsinë dibrane aty prej mijëra vjetësh. Kjo bazë e fuqishme ekonomike, kishte mbështetur fuqimisht edhe epopenë skënderbejane të mesit të shek. XV. Jo rastësisht Skënderbeu zhvilloi 19 nga 24 betejat e tij të mëdha. Me përmbytjen e kësaj fushe të bekuar u thuhej dibranëve të iknin nga të donin, vetëm në Dibër të mos rrinin, se Dibra u duhej atyre, të pavatanëve, ardhacakëve të stepave.

Prof. dr. ADEM BUNGURI

LUMI RADIKA: SHUMË ZHURMË PËR ASGJË!" Me këtë sentencë shekspiriane i cilëson kryeministri ynë të gjithë përpjekjet që po bëhen nga banorët e Dibrës së Madhe dhe të Peshkopisë, nga shoqatat ambientaliste në Tiranë, nga dibranët e Tiranës dhe të New Yorkut, për të ndaluar realizimin e projektit të devijimit të lumit Radika të Dibrës së Madhe, aktualisht brenda kufijve të FYROM. Këtij pohimi ai i shton në twitter edhe tre argumente të tjerë, që e pamundësojnë realizimin e këtij projekti: "1. s'ka projekt. 2. s'ka gjasa të fillimit të njëanshëm 3. s'ka shans të lejojmë prekjen e interesit tonë". Me këtë sentencë shekspiriane të thënë nga kryeministri ynë, ne të gjithë duhet të jemi të qetë se ky projekt nuk do të materializohet. Ajo pasohet edhe nga ministri i energjetikës, që deklaron se "nuk ka marrëveshje për Radikën me Maqedoninë" dhe e konsideron të gjithë këtë zhurmë si "furtunë në një gotë ujë". Pra, bazuar në këto deklarata të qeveritarëve tanë, dibranët dhe shqiptarët duhet të jenë të qetë dhe as që duhet të mendojnë daljen në protestë.

Unë do të dëshiroja sinqerisht t'u besoj qeveritarëve tanë, por përballë lajmeve që vijnë nga shteti fqinjë, nuk mund të mos shqetësohesh apo të futësh kokën në rërë, kur dëgjon se pala maqedonase flet hapur dhe qartë se ka ndërmend të ndërtojë një HC në fushën e Lukovës dhe për këtë iu dashka të marrë ujërat e lumit të Radikës me një tunel nëntokësor dhe për këtë ka të hartuar edhe projektin përkatës. Madje, sipas informacioneve më të fundit, nga kryetari i Komunës së Dibrës z. Ruzhdi Lata dhe kryetari i këshillit komunal të Dibrës z. Bashkim Mashkulli, ky i fundit ka parë me sytë e tij se në terren po punohet me mjete të rënda për realizimin e këtij projekti. Gjithashtu, konferenca e shtypit e datës 24.01.2014 i 5 ministrave shqiptarë, tre të Tiranës dhe dy të Shkupit, e zhvleftësoi qëllimin e organizimit të tij. Në këtë dështim ndikoi edhe deklarata e dy ministrave të vendit fqinjë, që pranuan se "projekti mbi Radikën ekziston dhe se po punohet për plotësimin e tij deri në qershor të këtij viti!" Këto lajme konfirmohen edhe nga njoftimi i Bankës Botërore (News 24, datë 23.01.2014), i përsëritur edhe nga VOA e datës 24.01.2014, sipas të cilit, BB është duke e vlerësuar projektin për devijimin e lumit të Radikës, projekt i dorëzuar nga pala maqedonase që në vitin 2011. Madje BB sqaron edhe faktin se projekti parashikon që nga lumi i Radikës të merret sasia e ujit prej 2m3/sec. Ajo thekson gjithashtu se ky projekt duhet t'u bëhet i njohur edhe Shqipërisë e Kosovës, si dhe faktin se ai është kundërshtuar nga komuniteti i Dibrës. Ndërkaq drejtoresha e degës së BB në Shkup, përmend edhe një farë marrëveshje ndërshtetërore të vitit 1956, juridikisht e pavlefshme, midis Shqipërisë dhe një shteti tashmë të vdekur. Ndërsa një profesor universitar, ish deputet i parlamentit të Shkupit, deklaron se projekti i devijimit të Radikës, përfshirë edhe projektin e fizibilitetit të tij, i firmosur nga një ish ministër shqiptar i BDI, janë miratuar nga ai parlament si veprimtari parësore në fushën e energjetikës për vitin 2011-2015. Ai madje publikon edhe të dhëna të detajuara të fondeve vjetore të akorduara për këtë Project, kryesisht me fonde të BB, që në total kapin shumën 62.27 milion Euro (A1 Report, 25.01. 2014). Këto fakte të çojnë në përfundimin logjik se ky problem duhet të jetë diskutuar midis të dy qeverive, që duket se janë dakorduar në parim për projektin e devijimit të Radikës. Megjithatë, në seancën parlamentare të datës 25.01.2014, kryeministri ynë vazhdon të hedh poshtë ekzistencën e një projekti të tillë! Në kushtet e mungesës së plotë të transparencës nga dy qeveritë e Shkupit dhe Tiranës, dëshiroj t'u kujtoj atyre që e kanë harruar se kanë kaluar rreth 2000 vjet nga koha kur filozofi Seneka (4 para Kr.-65 pas Kr.), në vitet e fundit këshilltar i perandorit Neron (54-68 pas Kr.) që dogji Romën, e këshillonte atë që t'i gënjente romakët, pasi "populli beson çdo lloj gënjeshtre që i serviret!".

Pa u zgjatur në hollësi të tjera, me anë të këtij shkrimi, dëshirojmë të shprehim kundërshtimin tonë për t'u thënë pushtetarëve të Shkupit: "Mos e prekni Radikën!". "Mos e prekni historinë!". "Radika është uji i jonë që nuk falet!".

Në gjeomorfologjinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit perëndimor, lugina e Drinit të Zi, përfaqëson padyshim një nga korridoret më të rëndësishme lumore, ndërsa lumi i Radikës, afluentin më të rëndësishëm lindor të tij. Radika përbëhet nga tri degë, dy prej të cilave burojnë në vendin e quajtur Guri i Zi, në malin Vraca të Sharrit në Kosovën Jugperëndimore, në lartësinë mbidetare 2200m, ndërsa dega e tretë vjen nga mali i Korabit në Shqipëri. Pas bashkimit, Radika përshkon të gjithë krahinën e Rekës së Sipërme dhe të Poshtme dhe derdhet në Drini e Zi. Radika me gjatësi 67 km, ka një pellg ujëmbledhës prej 866km2, dhe sipas buletineve të Shkupit me prurje mesatare shumëvjeçare të ujit 25m3/sec. Lugina e Radikës përfaqëson korridorin më të rëndësishëm natyror për lidhjen e pellgut të Dibrës me Pollogun dhe Shkupin dhe më tej me Ballkanin Qendror e Lindor, duke filluar që nga prehistoria e deri në ditët tona. Nëpër këtë luginë janë realizuar marrëdhëniet kulturore të kulturave më të hershme të qytetërimit njerëzor, përkatësisht kulturës së hershme neolitike të Burimit (Maqellarë)1) dhe asaj të Pallçishtit (Tetovë), Zlastrana dhe Tërnova e Poshtme (Ohër)[2] kronologjikisht të lidhur me gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të VII para Kr; kjo ishte arteria tregtare më e rëndësishme për dërgimin e mallrave të Dyrrahut në qendrat e Penestisë dhe të Dardanisë gjatë periudhës antike, nëpër këtë rrugë kanë lëvizur legjionet romake nga Uskana për të pushtuar qytetet ilire të Oaeneas dhe Draudakut dhe 11 kështjella të tjera më të vogla të krahinës së Penestisë gjatë luftës III iliro-romake(169-168para Kr). Nëpër këtë luginë ka ardhur Skënderbeu në Dibër nga fronti i Nishit në nëntor 1443, i shoqëruar nga 300 kalorës dibranë, për të organizuar çlirimin e Krujës dhe kryengritjen e përgjithshme të vitit 1444, nëpër këtë luginë kanë kaluar me dhjetëra ushtri osmane për të mposhtur këtë vend të bekuar e të panënshtruar të quajtur Dibër. Në kujtesën popullore, ajo është memorizuar për luftërat e shumta të dibranëve kundër pushtuesve të huaj, dhe është ngritur në art nga Hazis Ndreu me këngën për Hajredin Pashën që po vjen Radikës.

Radika - uji ynë që nuk falet!

Lumi i Radikës përshkon nga veriu në jug zonën e Rekës. Kjo zonë përfshin 28 fshatrat e Rekës së Poshtme dhe të Epërme, që shtrihen në të dy anët e lumit të Radikës, nga Kosovrasti në jugperëndim deri në qafën e Mavrovës dhe të Dufit në verilindje. Në krahun e djathtë të Radikës shtrihen fshatrat: Skudrinje, Presojnicë, Rostushë, Nistrovë (fshat i Josif Bagerit), Grekaj, Ribnicë, Haxhievc, Bitushë, Veleberdë, Trebisht, Vidushë,

kryesore

Radika - uji ynë që nuk falet!



Pamje e liqenit të HC të Spiles mbi fushën e Udovës në Dibër. Në sfond shihet lugina e Radikës. Tetor 2009. Foto: © Adem Bunguri

Për kontributin e jashtëzakonshëm në historinë tonë nacionale gjatë të gjithë periudhave historike, Dibra gjatë shekullit të fundit është trajtuar me urrejtje nga qeveritë sllavo-ortodokse të Beogradit dhe të Shkupit. Të gjitha veprimet e kryera prej tyre janë pjesë e një plani tërësor dhe të mirëorganizuar nën frymën çubriloviçiane për shpopullimin e Dibrës.

Tani nga qarqet neoçubrilloviçiane të Shkupit po përgatitet goditja e tretë, lënia e Dibrës dhe dibranëve në thatësirë, se ujët i duhet kuçedrës, anipse Radika dhe ujët e saj janë të Dibrës dhe të dibranëve. Ata duket se e kanë harruar këngën e Hajredin Pashës që sillej si somnabul Radikës, pasi kishte humbur ushtarët e tij në fushat dhe malet e Dibrës, plot 170 vjet më parë.

Zhirovnicë, Strazimir, Vrbjan dhe Tanushe dhe në krahun e majtë të saj fshatrat Jançe, Boletin, Osoj, Sushicë, Rosoki, Sencë, Tërnicë, Veleçicë, Mavrovë, Tresonçe, Starcë, Galiçnik dhe Duf. Qafa e Dufit shërben si vijë ndarëse midis pellgut ujëmbledhës të Drinit të Zi dhe atij të Vardarit, dhe për rrjedhojë ana perëndimore e tij përfshihet në pellgun e Drinit të Zi, përkatësisht në rajonin e Dibrës, ndërsa ana lindore në atë të Vardarit ose në rajonin e Pollogut. Ky prag ujëndarës shënon edhe kufirin antik midis Penestisë në jug dhe Dardanisë në veri. Me sa dimë, në asnjë vend të botës nuk ka ndodhur që të tentohet ndryshimi i pragjeve ujëndarës të lumenjve, aq më tepër kur këto rrjedhin në territorin e dy shteteve fqinje. Për ne është e qartë se ky veprim nuk ka vetëm qëllime hidrike, por synon shkatërrimin e ekosistemit të Dibrës saj dhe shpopullimin e saj.

Radika - uji ynë që nuk falet!

Që nga viti 1913, kur thika e ftohtë e diplomacisë evropiane, priste trupin e Shqipërisë, me qetësinë e ndarjes dhe të servirjes së një torte në tavolinën e ngrënies, ishte prerë edhe njëra gjymtyrë jetësore e Dibrës si dhe dy rrugët më të rëndësishme të saj, rruga Ohër-Dibër dhe ajo Shkup-Dibër ose rruga në luginën e Radikës. Që nga ai vendim absurd i 6 fuqive të mëdha në Londër, Dibra ishte ndarë më dysh, dhe jashtë kufirit kishte mbetur gjysma lindore e saj, qyteti i Dibrës së Madhe me hapësirën bujqësore dhe rrethinë, zona e Zhupës, e Rekës dhe lumi i Radikës. Edhe pse Dibra ka qenë gjithnjë një etnitet, një tërësi etno-kulturore, me kufij gjeografiko-hapsinorë dhe kulturorë mirë të përcaktuar. Edhe pse Dibra kishte kontribuar si pak kush në luftërat shekullore për mbrojtjen e integritetit dhe tërësisë territoriale të tokës së të parëve. Edhe pse bijtë e saj kishin luftuar dhe ishin vrarë për vatanin jo vetëm në Dibër, por edhe në të gjithë hapësirën shqiptare, në Kolosian dhe Prizren, në Novi Pazar dhe në Sanxhak, në Janinë dhe në Vlorë, në Shkodër dhe në Ulqin, në Prilep dhe në Manastir, në Shkup dhe në Karadak. Kudo ku zëri i tokës mëmë i kishte thirrur, kudo ku shfaqej kuçedra për t'a kafshuar dhe shkëputur ndonjë copë të vatanit. Tani që kuçedra kërkon të na marrë ujin e jetës, Radikën tonë, atë që na e ka dhënë vetë Zoti, atë që është pjesë e jetës, e historisë dhe e ndërgjegjes sonë mijëvjeçare, të gjithë do të ngrihen në këmbë dhe do t'ia presin kryet kuçedrës.

Radika - uji ynë që nuk falet!

Për kontributin e jashtëzakonshëm në historinë tonë nacionale gjatë të gjithë periudhave historike, Dibra gjatë shekullit të fundit është trajtuar me urrejtje nga qeveritë sllavo-ortodokse të Beogradit dhe të Shkupit. Të gjitha veprimet e kryera prej tyre janë pjesë e një plani tërësor dhe të mirëorganizuar nën frymën çubriloviçiane për shpopullimin e Dibrës. Më poshtë po kujtojmë vetëm disa prej tyre:

ASGJËSIMI I KUJTESËS HISTORIKE

Urrejtja ndaj Dibrës e dibranëve u shfaq sidomos gjatë luftërave për pushtimin e Dibrës në vitet 1912-1921. Ofensiva serbe e tetorit 1913 dhe ajo e vitit 1918, nuk lanë fshat të Dibrës pa djegur dy e tri herë. Pushtuesit serbë me sadizmin e tyre çubriloviçian dhe taktikën e "tokës së djegur", kryen në këtë hapësirë masakra nga më të tmerrshmet, që mund të imagjinohen nga mendja njerëzore. Nuk ka pëllëmbë të tokës dibrane që nuk u skuq nga gjaku i bijve të saj, në mbrojtje të vatanit. Këto krime të përbindshme janë të dokumentuara në arkivat e kohës, në memorien popullore, por edhe në toponimet e shumta të kësaj periudhe si "vorret e vrame", "vorret e serbit", "vorri i gruas", "vorri i nuses", "vorret e cullve" etj, që nuk mund të fshihen nga kujtesa historike. Kjo politikë genocidiste dhe masakrat çnjerëzore serbe shkaktuan emigracionin e parë dibran drejt Tiranës, atë të 100 viteve më parë (1913-1918), kur mijëra dibranë u detyruan të lënë vatanin e të shkojnë në Tiranë, nëpërmjet "Rrugës së Dibrës", ku krijuan "lagjen e Dibrës", dy toponime aq të njohura që prej 100 vjetësh në Tiranë.

Radika - uji ynë që nuk falet!

ASGJËSIMI I TOKËS BUJQËSORE SI BAZË E EKONOMISË

Përmbytja e fushës së madhe të Udovës, ngjitur me qytetin e Dibrës së Madhe, dhe ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës, me ujërat e Radikës dhe të Drinit të Zi, në funksion të HC të Spilesë në vitet 1964-1966. Me emrin Udovë njihet fusha në jug të qytetit të Dibrës, me sipërfaqe 1340 ha, sot e përmbytur nga liqeni i HC të Spiles në Dibër të Madhe. Fusha e Udovës, më e madhja dhe më pjellorja fushë e Dibrës, shtrihej në krahun e djathtë të lumenjëve të Radikës dhe të Drinit të Zi, nga qyteti i sotëm i Dibrës në veri, deri në kodrat e Gorenzës dhe të Ballancës në jug dhe përbënte hambarin agrikulturor të qytetit me rrethinë. Me këtë veprim Dibrës i hiqej qëllimisht baza kryesore ekonomike, pasuria më e madhe e saj, që e kishte qenë baza e zhvillimit të qytetërimit ilir që nga kohët prehistorike, antike e mesjetare dhe kishte ushqyer popullsinë dibrane aty prej mijëra vjetësh. Kjo bazë e fuqishme ekonomike, kishte mbështetur fuqimisht edhe epopenë skënderbejane të mesit të shek. XV, dhe luftërat e tij fitimtare, atdheu historik i të cilave, është vetë Dibra, ku jo rastësisht Skënderbeu zhvilloi 19 nga 24 betejat e tij të mëdha. Me përmbytjen e kësaj fushe të bekuar u thuhej dibranëve të iknin nga të donin, vetëm në Dibër të mos rrinin, se Dibra u duhej atyre, të pavatanëve, ardhacakëve të stepave. Kësaj kohe i përket faza II e emigracionit dibran, këtë radhë drejt Amerikës.

Radika - uji ynë që nuk falet!

Nuk është nevoja të përmend në këtë shkrim për Radikën, ujin tonë që nuk falet, argumente të tjerë të frymëzuara nga Shkupi zyrtar, që plotësojnë platformën antishqiptare të tij, për deilirizimin dhe deshqiptarizimin e hapësirës kompakte shqiptare, si p.sh gërmimet jashtë kritereve shkencore në kalanë e Ohrit, punimet restauruese në kalanë e Shkupit, instalimi arbitrar i një kishe me konstruksion metalik (të papërfunduar) brenda kalasë së Shkupit, rrahja e organizuar e fëmijëve shqiptarë në gjimnazet e Strugës e të Shkupit, ngritja në qendër të Shkupit, e statujës në bronz të Aleksandrit të Madh dhe përballë saj ajo e Filipit II të Maqedonisë, babait të tij, edhe pse e gjithë bota e qytetëruar e di mirë se këto dy personazhe të njohur të botës antike, nuk kishin asnjë lidhje me vendin e njohur sot si FYROM etj.

ASGJËSIMI I DËSHMIVE ARKEOLOGJIKE

Bashkë me përmbytjen e fushës së madhe e pjellore të Udovës, u mbuluan përjetësisht nga ujërat e liqenit të HC të Spiles edhe dëshmitë arkeologjike të një qytetërimi të lashtë ilir. Edhe pse në vitin 1964, u krye këtu një gërmim i vogël arkeologjik me karakter shpëtimi[3], gjurmët arkitektonike, depozitimet kulturore të stratifikuara sipas periudhave, dëshmi dhe artefakte të shumta u përmbytën!. Sipas autores së gërmimit, aty janë zbuluar *"mjaft objekte arkeologjike të periudhës së hekurit dhe të asaj urbane, si dhe themele banesash e vilash rustica, pitosa qeramike dhe mjaft varre të ndërtuara me tjegulla të tipit "çati dyujëshe" të shek.III-IV pas Kr. si dhe objekte të periudhave të tjera të mëvonshme"*[4]. Në interpretim të këtij materiali, është arritur në përfundimin se *"në Udovë gjendet një vendbanim i madh me kontuinitet nga koha e hekurit deri në mesjetë"*[5]. Në fushën e Udovës studiuesit mendojnë se duhet lokalizuar qyteti ilir i Oeneas, një nga qytetet më të rëndësishme peneste të shek. II para Kr.

Radika - uji ynë që nuk falet!

Tani nga qarqet neoçubrilloviçiane të Shkupit po përgatitet goditja e tretë, lënia e Dibrës dhe dibranëve në thatësirë, se ujët i duhet kuçedrës, anipse Radika dhe ujët e saj janë të Dibrës dhe të dibranëve. Ata duket se e kanë harruar këngën e Hajredin Pashës që sillej si somnabul Radikës, pasi kishte humbur ushtarët e tij në fushat dhe malet e Dibrës, plot 170 vjet më parë.

Radika - uji ynë që nuk falet!

SHTREMBËRIMI DHE FALSIFIKIMI I HISTORISË

Të gjithëve na kujtohet e ashtuquajtura "enciklopedi" e Maqedonisë e hartuar nga një grup "akademikësh" në vitin 2011, sipas të cilës *"shqiptarët paskëshin zbritur nga malet në shek. XVII dhe i paskëshin shqiptarizuar sllavët autoktonë"!* Këtë përrallë nuk e besojnë as vetë ata që guxuan të shkruajnë marrëzira të tilla, por gënjeshtarët dhe falsifikatorët nuk kanë turp, ata shpresojnë se këto mashtrime dikur do t'u vlejnë atyre, qoftë edhe pas 100 apo 1000 vjetësh. Ndërsa shkruaj këto radhë, më vjen në mendje thirrja e shqetësuar e prof. E. Çabejt,: *"Hapi i parë në likuidimin e një populli është të fshish kujtesën e tij historike. Shkatërroni librat e tij, kulturën e tij, historinë e tij. Atëherë vini dikë të shkruaj libra të rinj, të krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori të re. Para se të kalojë shumë kohë kombi do të harroj se çfarë është dhe çfarë qe"6).*

Radika - uji ynë që nuk falet!

Nuk është nevoja të përmend në këtë shkrim për Radikën, ujin tonë që nuk falet, argumente të tjerë të frymëzuara nga Shkupi zyrtar, që plotësojnë platformën antishqiptare të tij, për deilirizimin dhe deshqiptarizimin e hapësirës kompakte shqiptare, si p.sh gërmimet jashtë kritereve shkencore në kalanë e Ohrit, punimet restauruese në kalanë e Shkupit, instalimi arbitrar i një kishe me konstruksion metalik (të papërfunduar) brenda kalasë së Shkupit, rrahja e organizuar e fëmijëve shqiptarë në gjimnazet e Strugës e të Shkupit, ngritja në qendër të Shkupit, e statujës në bronz të Aleksandrit të Madh dhe përballë saj ajo e Filipit II të Maqedonisë, babait të tij, edhe pse e gjithë bota e qytetëruar e di mirë se këto dy personazhe të njohur të botës antike, nuk kishin asnjë lidhje me vendin e njohur sot si FYROM etj.

Radika - uji ynë që nuk falet!

REFERIME

1. F. Prendi-Zh. Andrea, Të dhëna të reja mbi neolitin në Shqipëri, Iliria 1981, 2, f. 16-19; F. Prendi, Të dhëna mbi neolitin e hershëm në zonën e Dibrës, Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I, 1995, f. 33-38; A. Bunguri, Prehistoria e Dibrës, 2010, f. 63-64.
2. A. Bunguri, Prehistoria e Dibrës, 2010, f. 63-64.
3. V. Bitrakova-Grozdanova, Prilog kod antićkata istorija na Debarskiot kraj, Istorija na Sojuzot na družvata na istiričarite na Republika Makedonija, Skopje 1966, f. 199-201.
4. Po aty, 199-201.
5. Po aty, f. 199-201.
6. E. Çabej, Studime filologjike të shqipes, Vol. I, Prishtinë 1965.



PESË MINISTRA SHQIPTARË NË DY QEVERI:

Nuk ka projekt. Nuk ka vendim. **Vendimmarrja** do të jetë **transparente**

Konferencë e përbashkët për shtyp e Ministrit të Ekonomisë në Maqedoni Valon Saraçini, ministrit të Mjedisit e Planifikimit Hapësinor në Maqedoni Abdilaqim Ademi, ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, ministrit të Mjedisit Lefter Koka dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë Damian Gjiknuri, pas takimit me Kryeministrin Edi Rama:

DITMIR BUSHATI, Ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë:

Para sëgjithash do të doja të informoja opinioni publik se rregullimi i kësaj çështje, pra i mënyrës se si menaxhohen ujërat dhe ndikimet ndërkufitare, janë çështje, të cilat adresohen në mënyrën më të plotë të mundshme, në një kuadër të mirëpërcaktuar nga e drejta dhe praktika ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme si për Shqipërinë, ashtu edhe për vendet fqinje. E, këtu nuk ka asnjë rast përjashtimor!

Së dyti, të dy vendet tona, janë vende të cilat aspirojnë anëtarësimi në BE. Kanë një marrëdhënie kontratuale në BE, që është marrëveshja e Stabilizim Asoociimit dhe përkatësisht kanë detyrime, në lidhje me regjimin e ujërave dhe janë të detyruara që të zbatojnë normativën që burojnë nga direktivat e BE.

Është për të ardhur keq që edhe në ato raste kur ka një dialog dhe konsulta intensive, siç është rasti mes dy qeverive tona për të adresuar çështje që potencialisht kanë impakt ndërkufitar, sërisht ka spekulime për gjoja humbje të interesave kombëtare të "x" apo "y" shteti. Ne vlerësojmë se mbrojtja dhe përdorimi i ujërave ndërkufitarë dhe liqeneve janë çështje të rëndësishme, realizimi efektiv i të cilave mund të sigurohet vetëm me bashkëpunim të zgjeruar ndërmjet fqinjëve, në përputhje me konventat dhe praktikat ndërkombëtare, të cilat janë jashtëzakonisht solide në të këtë fushë. Në bazë të konventave ndërkombëtare ujërat ndërkufitarë duhet shfrytëzohen në një mënyrë të arsyeshme dhe të barabartë, duke marrë në konsideratë të veçantë karakterin e tyre ndërkufitar, në rast se aktivitetet që shkaktojnë ose kanë të ngjarë të shkaktojnë, kanë një impakt ndërkufitar.

Pala shqiptare, qeveria e Republikës së Shqipërisë, dëshiron t'i diskutojë problemet që lidhen me shfrytëzimin tërësor të ujërave, jo thjesht me Maqedoninë, por me çdo vend tjetër me të cilin ka një problematikë përkatëse, veçse në frymën e së drejtës ndërkombëtare, veçse në frymën e mirëkuptimit në marrëdhëniet dypalëshe, të marrëveshjeve dypalëshe dhe të gjitha detyrimeve që shtetet kanë në këtë drejtim.

Të ashtuquajturat problematika të krijuara për administrimin e ujërave ndërkufitarë ndërmjet dy shteteve fqinjë, mund të rregullohen veçse nëpërmjet mekanizmave të së drejtës ndërkombëtare dhe në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dypalësh.

Qeveria shqiptare ka një bazë të plotë të të dhënave, ka një bazë të plotë të konventave ndërkombëtare ku aderon, të parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje. Sikundër kemi gjithashtu përpara një "libër të madh gabimesh", do të thoja, që na e kanë lënë kundërshtarët, në të ashtëquajturat negociata, për çështje edhe më sensitive se kjo që po flasim sot.

Jam këtu për të garantuar opinionin publik shqiptar, çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë se kjo qeveri do të mbrojë deri në ditën e fundit të detyrës së saj dinjitetin kombëtar, sovranitetin, integritetin territorial dhe gjithë interesat e kombit shqiptar.

ABDILAQIM ADEMI, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i Maqedonisë:

Jemi këtu sot për të informuar në mënyrë burimore, kryeministrin, ministrat, por edhe opinionin në Shqipëri dhe më gjerë rreth temës shumë aktuale në Shqipëri dhe në Maqedoni, pra temën e Radikës.

Ajo pse jemi sot këtu, nuk është vetëm për të informuar në mënyrë burimore, kryeministrin, ministrat dhe opinionin, por edhe për të sqaruar se kjo ide e vjetër ndoshta në letër, sot për sot nuk ka një projekt të caktuar dhe nuk ka një studim të përfunduar për impaktin në ambientin jetësor. Si e tillë, nuk mund të trajtohet dhe nuk mund të ketë shqetësim as për opinionin dhe as për institucionet. Në bazë të konventave dhe të ligjeve ndërkombëtare, ashtu siç e sqaroi edhe ministri më herët, jo vetëm qeveria e Republikës së Maqedonisë, por çdo vend kur zhvillon një projekt të tillë ose ka një ide të tillë, është e detyruar që në një fazë të caktuar, të kyçë opinionin në vendimmarrje, të kyçë institucionet relevante, por në raste të tilla të kyçë në vendimmarrje dhe në konsultime edhe vendet fqinje. Projekti ideor ose ideja për të cilën është ngritur shqetësimi, nëse eventualisht do të zhvillohej më tutje, sigurisht që impakt do të kishte për Shqipërinë, Kosovën dhe Greqinë. Jemi këtu për të garantuar të gjithë se ne si vend, por edhe si qeveri, nuk do të ndërmarrim asnjë vendim, pa patur konsultime me vendet fqinje, por në radhë të parë pa i shfrytëzuar ose pa i ndjekur të gjitha procedurat të cilat i parasheh realizimi i një projekti.

Meqë projekti për të cilin ka shqetësim, është i nociouar në kufijtë e parkut Kombëtar Mavrovë, për mua si ministër dhe për qeverinë ka një vëmendje të veçantë, sepse ai park është i shpallur park kombëtar në bazë të vlerave që janë në atë zonë. E për asnjë moment, ne nuk do t'i rrezikojmë ato vlera për të realizuar një projekt të tillë. Prandaj studimi i cili duhet të përfundojë, për impaktin në ambientin jetësor, do të jetë bazë për të marrë vendim, do të ndërtohet ose jo ky projekt. Ai studim është duke u përgatitur. Shqetësimin që kanë banorët e Dibrës, ne disa herë e kemi sqaruar bashkë me ministrin Saraçini, kemi qenë dhe në Dibër dhe dibranët, por dhe i gjithë rajoni i Rekës, siç quhet ai rajon, do të jenë të kyçur edhe në përgatitjen ose në debatin publik, që do të realizohet për të njëjtin projekt, pra kur do të përfundojë dhe studimi për impakt në ambientin jetësor.

Në bazë të konventave ndërkombëtare, çdo lloj devijimi i ujërave është i ndaluar, kur konstatohet që ka impakt negativ, jo vetëm në ekosistemin dhe biodiversitet, por edhe në aspekte të tjera, siç janë ato socio-ekonomike.

Prandaj dua të bëj apel tek të gjithë se nuk ka nevojë për shqetësime. Jemi në bashkëpunim, jo vetëm me institucionet e vendit dhe pushtetin lokal në Maqedoni, por jemi në bashkëpunim edhe me vendet fqinje, me qëllim që të mos ketë asnjë vendimmarrje pa pasur konsultime burimore, ose konsultime mes vendeve tona.

Edhe njëherë duke ju përshëndetur, dua të përsëris që nuk ka nevojë për shqetësim. Vendimmarrja do të jetë transparente.

DAMIAN GJIKNURI, Ministri i Energjisë dhe Industrisë i Shqipërisë:

Falenderoj ministrat për prezencën e tyre këtu. Duke qenë se jam ministër i Energjetikës dhe një pjesë e kësaj projektideje, lidhet edhe me një projekt energjitik, pra me atë çfarë synohet, si ministër i Energjetikës kam qenë i vëmendshëm, po ashtu dhe të gjitha institucionet tona, në lidhje me impaktet e mundshme mbi burimet energjetike që mund të ketë çdo lloj projektideje apo projekti në të ardhmen. Pikërisht, me këtë synim duke u nisur nga interesat e detyrës që përfaqësojmë dhe nga interesat e vendit, kemi kërkuar shpjegime nga ministria përkatëse në Maqedoni, në lidhje me ekzistencën dhe fazën e këtij procesi. Nuk kam nevojë ta përsëris, jemi në fazën e një projektideje e cila nuk është maturuar në një projekt. Siguroj publikun shqiptar se Ministria e Energjetikës, si pjesë e çdo lloj strukture ndërshtetërore, që mund të trajtojë çdo lloj impakti që kanë projektet me fqinjët, do të jetë në gjendje dhe është e gatshme që të vlerësojë edhe impaktet dhe pasojat që mund të lindin për territorin e Shqipërisë dhe burimet energjetike. Pra, është shumë e rëndësishme që vendet po dialogojnë në lidhje me këtë gjë.

I siguroj shqiptarët që përgjigjet gjenden tek tradita e regjimit të ujërave, tek marrëveshjet ndërkombëtare që e rregullojnë këtë. Qeveria shqiptare do të veprojë në përputhje me interesat më të mira të këtij vendi që të mos cenojë burimet energjetike, sigurinë energjetike, por njëkohësisht të japë kontributin e saj që gjërat të jenë të qarta nga pikëpamja teknike dhe shkencore dhe mos t'i lihet pre spekulimeve.

Fatkeqësisht, do të thoja një gjë, edhe si ironi në një farë mënyre, kur unë këtë çështje e kam ngritur në nëntor me ministrin përkatës që ndodhet këtu, zotin Saraçini, asnjë media shqiptare nuk e pasqyroi. Megjithëse interesi, gjoja ishte i lartë, asnjë media nuk e i dha rëndësi kësaj çështje. Qeveria shqiptare ishte e para që tregoi interes se çfarë problemesh mund të ketë në të ardhmen, nga një shqetësim i nisur nga banorët e Dibrës. Prandaj, spekulimi politik është më se i pastër dhe gjithkush e kupton. Ju faleminderit!

LEFTER KOKA, Ministri i Mjedisit i Shqipërisë

Unë dua të shpreh vlerësimin tim maksimal për zotin Ademi dhe zotin Saraçini, dy anëtarë të kabinetit të Republikës së Maqedonisë.

Në fakt, sot jemi këtu së bashku për të sqaruar një asgjë.

Është një gjë e shumëdiskutuar; Çdo shtet ka për detyrë t'i referohet disa konventave dhe direktivave të BE, në rastin në fjalë, kur përshkohet nga lumenj e liqene të përbashkëta. Ajo që ndodh rëndom me ne në fakt, është se ne jemi shumë sensibël kur ka projektide dhe jo kur ka fakte. Këto janë gjëra të sqaruara kohë më parë. Kemi qenë në një kontakt të vazhdueshëm me kolegët. Kërkuam që të bëhemi sot për pjesën e opozitës, më të besueshëm, që të mos i dëgjojë nga ekranet e Maqedonisë ministrat, por t'i dëgjojë këtu nga kryeministria. Ndaj dua të garantoj edhe një herë të gjithë shqiptarët se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Hera herës duhet të mos bëhemi qesharakë. Kohë për të humbur s'kemi. Është një projektide. Nuk mundemi dot të gjykojmë projektidenë. Gjykojmë projekte konkrete.

Sot jemi mbledhur këtu për të diskutuar një projektide. Ju mendoni se ëndrrat dhe projektidetë gjykohen?! Ministrat e vendeve fqinj, Greqia, Kosova nuk kanë bërë asnjë veprim, siç kemi bërë dhe ne. Ndaj kërkoj mirëkuptimin sidomos të mediave, të mundemi të klasifikojmë dhe të dëgjojmë ata zëra, të së vërtetës, të respektit ndaj ligjit, dhe të konventave e direktivave të BE. Ju faleminderit!

VALON SARAÇINI, Ministri i Ekonomisë i Maqedonisë:

Jemi sot këtu në Tiranë, me ftesë të Kryeministrit shqiptar, Z. Edi Rama për të diskutuar për një ide, për një projektide, e cila kohëve të fundit është sensibilizuar shumë nga mediat dhe për të diskutuar për atë se çfarë, në të ardhmen, planifikohet të bëhet. Siç thashë dhe siç u shprehën deri më tani të gjithë ministrat, bëhet fjalë për një ide të hedhur në letër, për një projektide i cili ka qenë bazë që të fillohet të punohet për një projekt final.

Projekt final ende nuk ka!

Është duke u punuar nga një kompani ndërkombëtare dhe planifikohet të përfundojë në gjysmën e parë të këtij viti, apo deri në fund të muajit qershor. Pasi të përfundojë projekti final, por edhe studimi që do të tregojë ndikimin mbi ambientin jetësor, do të ketë debate publike ku do të jenë të përfshirë të gjitha institucionet përkatëse, njëkohësisht edhe përfaqësuesit e Dibrës së Madhe dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Ne shumë herë kemi thënë se çështjet e ekonomisë ujore duhet të trajtohen me konsensus të përbashkët, duke iu referuar konventave ndërkombëtare dhe nuk mund të ndodhë që një shtet të veprojë arbitrarisht, pa marrë pëlqimin e shtetit tjetër, çdo herë, duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare.

Të nderuar përfaqësues të mediave, më lejoni që edhe në herë të njoftoj opinionin, se në momentin kur projekti do të jetë final dhe ne si qeveri e Republikës së Maqedonisë do ta kemi të gatshëm, atëherë do të njoftohet qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe do të kërkohet pëlqim nga Qeveria Shqiptare. Në qoftë se Qeveria Shqiptare nuk jep pëlqim në lidhje me projektin final, projekt i cili duhet të përfundojë në muajin qershor, ky projekt nuk mund të realizohet. E thashë edhe një herë, këto çështje të ekonomisë ujore duhet të trajtohen çdo herë më konsensus të përbashkët, duke iu referuar konventave ndërkombëtare. Në raste të tilla, shtetet, zakonisht, nuk veprojnë në mënyrë arbitrare. Gjithashtu, edhe komision i përbashkët i të dy qeverive, apo komisioni ndërshtetëror, do të debatojë mbi projektin, i cili do të përfundojë deri në fund të muajit qershor.

Së fundi, më lejoni të siguroj të gjithë shqiptarët, veçanërisht banorët e Dibrës së Madhe, se nuk duhet të kenë aspak shqetësim, nuk duhet të kenë panik në lidhje me këtë projekt, sepse ky projekt ende është në një fazë ideore, ende është në letër dhe ende është duke u studiuar.

Disa herë kemi thënë si ministra, se po qe se edhe dibrani i fundit është kundër këtij projekti, ky projekt nuk do të realizohet. Në fund, pëlqim për këtë projekt duhet të japë Ministri i Ekologjisë i Republikës së Maqedonisë dhe Qeveria Shqiptare.

studimi

MENDIMI I SPECIALISTËVE MBI RADIKËN:
Studim Tekniko-Ligjor mbi krijimin e rezervuarit artificial të Llukovës

Projekti për marrjen e 2 m³ ujë nga lumi i Radikës për në Vardar është i parealizueshëm

Nga **Prof. Dr. MOLNAR KOLANECI**[1]
Ing. Hidrolog. TEFIK JEGENI[2]
Jurist. Dok. SAIMIR SHATKU[3]

Për mendim tonë si ekspert, projekti për marrjen e 2.00 m3 uji nga lumi i Radikës për në Vardar është i parealizueshëm, si në aspektin tekniko-fizik, si në aspektin e të drejtës ndërkombëtare të mbrojtjes së ujërave dhe liqeneve ndërkombëtare e ndërkufitar.

TË PËRGJITHSHME

Pellgu ujëmbledhës i lumit Radika ndodhet në pjesën perëndimore të Maqedonisë (treva e Dibrës) me koordinata gjeografike 41°33.1´ - 20°37.3´. Vendmatja hidrometrike Ura e Boshkovit me kuotë 592.24 m mbi nivelin e detit është hapur në vitin 1958 (sipas buletineve Jugosllave).

Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës të lumit Radika sipas buletinit hidrologjik Jugosllav të vitit 1954 është F = 866 km2 në Urën e Gorenicki. Në vitin 1958 në Urën Boshkut u vendos vendmatja hidrometrike mbi lumin Radika me sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës F = 751 km2 dhe gjatësi L = 67 km.

Zanafilla e lumit Radika është përroi Guri i Zi (Crni Kamen) i cili buron nga shpatet veriore të malit Vraca (në jug të vargmaleve të Sharrit). Përroi Guri i Zi merr drejtimin perëndimor dhe mbas 7 km ndërron rrjedhën në drejtimin jug-perëndimor.

Në bazë të disa hulumtimeve në botimet maqedonase rezulton se prurja mesatare shumëvjeçare e lumit të Radikës të jetë rreth 25 m3/s.

NDËRHYRJA NJERËZORE NË LUMIN RADIKA

Në vitin 1949 krijohet liqeni artificial i Mavrovës (270 milion m3 volum dhe 13.7 km2 sipërfaqe liqeni) duke ndërtuar një dige. Me pas në vitet 50 krijohet një sistem ujor (bifurkacion) që kthen ujërat e Radikës në liqenin e Mavrovës dhe me ane tunelesh e kalojnë ujin nga liqeni i Mavrovës në hidrocentralet Vrutok e Raven për ta larguar përfundimisht në drejtim të lumit Vardar. Ndërtimi i kësaj kaskade hidrocentralesh është bërë në vitin 1957 dhe faza e dytë në 1973.

Në fund të lumit të Radikës është ndërtuar rezervuari i Dibrës për hidrocentralin e Spiljes në vitin 1969 (viti i funksionimit të hidrocentralit). Ka një volum 520 milion m3, nga i cili volumi i dobishëm është 223 milion m3 dhe sipërfaqja e vetë liqenit është 12.2 km2.

MARRËVESHJET SHQIPTARO-JUGOSLLAVE PËR RADIKËN

Në kuadrin e bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy vendeve për ujërat kufitare, janë zhvilluar disa takime (mbledhje protokollare) të komisioneve të përbashkëta shqiptaro-jugosllave ndër vitet: 1947; 1956; dhe ajo e vitit 1962. Në mbledhjen e vitit 1962, u mor vendimi se do të merret uji nga pjesa e sipërme e Radikës në drejtim të lumit Vardar, me sasi të përgjithshme prej 250.000.000 m3 ose 8.00 m3/sek, në vit mesatar, (më poshtë në faksimilen e konkluzioneve të komisionit dy palësh është pika 6 që flet për lumin e Radikës).

Është e rëndësishme të përmendet fakti se tërësia e këtyre marrëveshje bilaterale ndër vite, nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare, mbi marrëveshjet ujore, nuk është sot adeguate dhe në përputhje me Konventat dhe direktivat ndërkombëtare të cilat kanë hyrë në fuqi pas viteve 90'.

Mund të përmendim Konventën për mbrojtjen dhe përdorimin e Ujërave ndërkufitare dhe liqeneve Ndërkombëtare, hartuar në Helsinki, më 17 mars 1992, si dhe referuar miratimit nga Komisioni Europian dhe Parlamentit Europian për Direktivës Kuadër të Ujin te 2000/60/EC.

Siç u tha më sipër nga "Marrëveshja Shqipëri – Jugosllavi" e vitit 1962 parashikohej të merreshin 8 m3/s nga lumi i Radikës së Sipërme në drejtim të lumit Vardar. Sipas informacionit të ELEM (Korporata Energjitike e Maqedonisë) pretendohet se aktualisht merren nga lumi i Radikes mesatarisht 4.9 m3/s në vit me luhatje nga maksimum 20 m3/s deri në minimum 0.4 m3/s. Fakti që pala maqedonase nuk e ka marrë ujin e parashikuar në marrëveshjen e vitit 1962 u jep atyre "argumentin" që të hartojnë projektin e Fushës së Llukovës.



- 11 -

- prurja e instaluar 90,00 m3/sek;
- regjimi i punes se impiantit duhet te rregullohet ne menyre qe ne parim te rritet energjia verore (prej 1 qershor deri 1 nendor) ne koordinim me hidrocentralin e Gllobocices dhe akumulacionin e Liqenit te Pogradecit.

Siguria e diges do te llogaritet per shkarkimin e plotave me siguri 0,1% (me kuote te nivelit te bjefit te siperm 583,50 Y) dhe do te kontrollohet per ploten me siguri 0,01%.

6) Radika e Siperme

Simbas te dhenave te paraqitura nga delegacioni jugosllav gjate viteve 1948 deri 1958 eshte ndertuar sistemi energjetik i Mavrovos, i cili perbehet nga tre impiante: HC Vrben, HC Vrutok dhe HC Raven.

Zona shimbledhese e ketij sistemi perveç ujrave te Sharit, te cilat i takojne pellgut te Vardarit, perfshin edhe zonen e Radikes se siperme, e cila i takon pellgut te lumit Drin i Zi, me gjithesejt 277,00 km2. Nga kjo zone duke filluar nga viti 1958 merren ujrat ne drejtim te Vardarit ne nje sasi te pergjitheshme prej 250.000.000 m3 ose 8,00 m3/sek. ne vit mesatar.

Keto ujra mblidhen ne rezervuarin e Mavroves, kuota e nivelit normal te te cilit eshte 1.233,00 dhe shfrytezohen per qellime energjetike nepermjet te impiantit te HC Vrutok dhe HC Raven, si dhe per vaditjen e zonave te bonifikuara Polloga (30.000 ha) dhe te fushes se Shkupit (20.000 ha).

Ne lidhje me kete çeshtje Komisioni arriti ne

k o n k l u z i o n i n

Se pala shqiptare jep pelqimin per punimet e siperpermendura.

1962
24

./.

Faksimilen e konkluzioneve të komisionit dy palësh. Pika 6 që flet për lumin e Radikës.



Skema e shfrytëzimit hidroenergjetik të ujërave të Radikës.

PROJEKTI I FUSHËS SË LLUKOVËS

Ky projekt është prezantuar nga "Korporata Elektrike e Maqedonisë" (ELEM) dhe mbështetet nga qeveria maqedonase, pra është projekt shtetëror dhe është në kuadrin e Strategjisë Energjetike të Maqedonisë. Ideja e projektit ka filluar që në vitin 1989 dhe tani shteti maqedonas ka paguar 3 milion dollarë për përgatitjen e projektit në fazën e avancuar të gatshëm për të kërkuar një borxh prej 62 milion euro për hartimin e projekt fizibilitetit me mbështetjen e Bankës Botërore.

Projekti ka dy faza: 1- ndërtimi i një dige 71 m të lartë në pjesën e sipërme të Radikës, Fusha e Llukovës, në kuotën 1550 metra mbi nivelin e detit. Kjo digë do të mundësojë grumbullimin e 39 milion m3 ujë; 2 – ndërtimi i një kanali rreth 20 km të gjatë që grumbullon të gjithë ujërat që zbresin nga masivi malor i Korabit në një kuotë 1620 m mbi nivelin e detit. Ky kanal do i çojë këto ujëra në rezervuarin Llukovës. Fillimisht është thënë se sasia e ujit që do të kalojë në rezervuar do të ishte 2.5 m3/s por nga të dhënat e përpunuar së fundi nga ELEM sasia e ujit shkon deri në 4.17 m3/s. Këtu ka një mospërputhje informacioni të marrë nga ELEM. Jemi të mendimit se vlera 4.17 m3/s është vlera që ata mendojnë të jetë pjesë e këtij projekti. Përfitimi për ata është mjaft i madh.

Ujerat e këtij rezervuari do të shfrytëzohen disa herë para se të derdhen në liqenin e Mavrovës dhe më pas në lumin Vardar. Poshtë kësaj dige do të ndërtohet në një faze të dytë një hidrocentral i ri (Guri i Zi me fuqi 5 MW). Më pas, ujërat do të kalojnë në hidrocentralin ekzistues të Verbenit (kuptohet që hec-i i Verbenit do të fuqizohet më tej) dhe pastaj kalojnë në liqenin e Mavrovës për t'u mos u kthyer më në shtratin e Radikës.

KONKLUZIONE:

Për mendim tonë si ekspert, projekti për marrjen e 2.00 m3 uji nga lumi i Radikës për në Vardar është i parealizueshëm, si në aspektin tekniko-fizik, si në aspektin e të drejtës ndërkombëtare të mbrojtjes së ujërave dhe liqeneve ndërkombëtare e ndërkufitar.

---

1. **Inxh. Hidrolog. Tofik JEGENI** ka punuar në Insitutin Hidro-Meteorologjik pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Është bashkëautor i veprës madhore "Hidrologjia e Shqipërisë". Ka qenë sekretar shkencor i Institutit Hidrometeorologjik të Akademisë së Shkencave. Bashkëautor për problemet e ujrave ndërkufitar (Radika, Vjosa) dhe ndërliqenor si: (kompleksi i Shkodrës, Buna, Drini i Zi dhe i Bardhë). Bashkëautor i punimit "Hidrologjia e Lumit Radika dhe Marrëdhëniet Juridike për Ekonominë Ujore Shqiptare-Jugosllave për Ujërat e Lumit Radika".

2. Prof. dr. Molnar KOLANECI ka punuar në Institutin Hidrometeorologjik të Akademisë se Shkencave. Objekti i aktivitetit kryesor ka qene studimi i ujërave të Shqipërisë. Është specializuar në Francë dhe Zvicër. Mban gradën "Profesor Doktor". Ka kryer studime të ndryshme të objekteve ujore (lumenj, liqene dhe dete). Bashkautor i monografisë "Hidrologjia e Shqipërisë" dhe shumë studimeve me karakter aplikativ. Ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në projektet për ndërtimin e rrugëve në vend si edhe për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël.

3. Dok. Jurist. Saimir SHATKU ka studiuar për Drejtësi pranë Fakultetit të Jurisprudencës, në Torino-Itali. Është specializuar në fushën e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Bashkimit Europian si dhe në Shkollën Europiane të Studimeve Politike në Strasburg-Francë. Ka ushtuar detyrën e Avokatit si dhe është Lektor i të drejtave të Njeriut dhe të drejtës Komunitare. Bashkëautor i punimit "Hidrologjia e Lumit Radika dhe Marrëdhëniet Juridike për Ekonominë Ujore Shqiptare-Jugosllave për Ujërat e Lumit Radika".

Rruga e Arbërit nr. 93

opinion

Foto: Protesta në Tiranë kundër devijimit të lumenjve. Foto: AKDL



Radik-a-politike

Nga **BUJAR KAROSHI**

Duket se "Çështja Radika" po kthehet në çështje politike. Sado që shoqëria civile kërkonte mospolitizimin e çështjes, partitë politike në Shqipëri gjetën një argument me çfarë t'i shtyjnë ditët dhe netët e ftohta të janarit. Partia Demokratike, PDIU, Aleanca Kuq e Zi, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe parti të tjera të spektrit politik shqiptar dolën me deklarata për shtyp dhe shprehën qëndrimin kundër këtij projekti. Në të njëjtën valë ishin edhe dy partitë kryesore të shqiptarëve në Maqedoni, BDI dhe PDSH.

Më 18 Janar, kreu i BDI-së Ali Ahmeti u takua në Pogradec me ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati. Media raportoi se temë e bisedës ishte edhe "Çështja Radika". Një ditë më vonë, më 20 janar, kryeministri Edi Rama shkroi në Facebook se "Lumi Radika - shumë zhurmë për asgjë! 1.S'ka projekt 2.S'ka gjasë të ketë fillim të njëanshëm 3. S'ka shans të lejojmë prekjen e interesit tonë!".

Por ndërkohë, një gazetë në gjuhën shqipe në Maqedoni, raportoi se "për shkak të reagimeve të shumta të dibranëve dhe efektit negativ që mund të ketë ky projekt në rezultatin zgjedhor në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ku rrezikohet partia shqiptare, BDI, ministrat e kësaj të fundit dhe autoritet zyrtare në Shkup kanë vendosur që këtë projekt ta shtyjnë për disa muaj dhe ta realizojnë pas zgjedhjeve". "Këtij projekti nuk mund t'i ikim. Qeveria nuk mund të bjerë në presion të qytetarëve, të cilët janë manipuluar dhe keqinformuar nga mediat dhe disa pseudoanalistë, por ne jemi ata që duhet të punojmë dhe t'i shpjegojmë popullit se ky projekt nuk i dëmton banorët e Dibrës. Për shkak të rrezikut që ky projekt të përdoret nga opozita në fushatë, ne do ta heshtim dhe do t'i rikthehemi shumë seriozisht pas zgjedhjeve", - tha një zyrtar i lartë për Tetova Sot.

Vladimir Peshevski, zv.kryeministër i Maqedonisë, tha në parlamentin e Shkupit më 31 janar se "Projekti ka marrë dimension politik në mënyrë të panevojshme, si dhe se nuk janë të sakta pohimet se me të do të thahen ujërat e lumit Radika, respektivisht se Radika do të mbetet pa ujë, do të bëhet lumë i thatë, ndërsa uji do të riorientohet. Të pasakta janë edhe pohimet e motivuara nga qëllimet politike se me projektin do të prishen konventat ndërkombëtare".

Nga ana tjetër, Menduh thaçi, kryetar i Partisë Demokratike Shqiptare në Maqedoni, në një intervistë për News 24, pohoi se "Çështja Radika ekziston, janë dokumentet, ka 6 vjet që ekziston, po manipulimi politik nga ana e atyre shqiptarëve që janë pjesë e qeverisë, duke qenë tërësisht të paaftë që ta pengojnë këtë çështje arritën që të implikojnë qeverinë e Shqipërisë në këtë çështje pa qenë nevoja". Ai shkoi më tej kur akuzon BDI-në, se "ka patur gënjeshtra. Projekti ekziston. Qeveria shqiptare është në të drejtën e saj, asnjë dokument zyrtar nuk ka nga qeveria e Maqedonisë. Qeveria shqiptare do të hyjë në lojë ku të merrni njoftim zyrtar".

Ndërkohë, kryetari i komunës së Strugës, Ziadin Sela, akuzoi pushtetin lokal në Dibër të Madhe për dyfytyrësi dhe mashtrim. "Dibra udhëhiqet nga BDI-ja, ato i fituan zgjedhjet atje që në raundin e parë, ato janë në qeveri dhe i kanë edhe ministrat. Nëse duan, ato mund ta zgjidhin këtë problem shumë shpejt. Shkuarja e tyre në Shqipëri për të kërkuar ndihmë me këtë rast paraqet një dyfytyrësi dhe mashtrim", - citon zotin Sela portali informativ Drini.mk.

A po kthehet "çështja e Radikës" në çështje politike? Në fakt, në Tiranë, kryetari i Dibrës së Madhe nuk e ka takuar Edi Ramën. Madje ai nuk është parë as me Pandeli Majkon, i cili i është bashkuar 'Besëlidhjes së Radikës'". Bashkim Mashkulli, kryetar i këshillit komunal të Dibrës së Madhe, u tha gazetarëve nga mediat e Tiranës që shkuan në Dibër, se ai "e kishte njoftuar kryeministrin Rama që më 28 qershor 2013". Media publikoi një foto të zarfit, por që mbi emrin e Ramës shkruhej Qeveria e Shqipërisë. Por a ishte Rama kryeministër në kohën që thotë ai?

Në fakt, drejtuesit e Komunës së Dibrës u janë bashkuar protestave dhe kanë dhënë siguri se projekti nuk do të realizohet. Por ndërkohë, Ruzhdi Lata dhe Ali Ahmeti nuk janë parë së bashku ta diskutojnë këtë çështje.

Më 21 janar, Kryetari i Komunës së Dibrës ishte në Top Channel në emisionin "Top Show". Ai, si dhe herë të tjera gjatë këtyre muajve, e ka vlerësuar projektin "Fusha e Llukovës, më tepër si një projekt politik të qeverisë së Maqedonisë se sa për nevoja ekonomike". "Në momente kur ka leverdi shteti i Maqedonisë, ligjet ish-jugosllave nuk i pranojnë, por kur është çështja që ka të bëjë me shqiptarët aktualizojnë ligjet dhe raportet mes ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Këtu është zanafilla e gjithë kësaj problematike, që për mua më shumë ka karakter politik sesa ekonomik, ngase në baza ekonomike nuk ka arsye devijimi i lumit", ka theksuar Lata. "Radika është përgjysmuar, dhe nëse e marrin përsëri atëherë do të mbetet një vend i përshtatshëm ku mund të çmontohen armët e Sirisë. Ajo do të thahet në tërësi sepse do të marrin gjashtë burimet e saja që rrjedhin në Parkun nacional duke i shkelur të gjitha normativat ndërkombëtare", deklaroi ai gjatë emisionit. Ai shkoi më tej, duke theksuar se mes dy qeverive, "janë bërë pazare për të marr ujin Radikë, duke ofruar linjën e interkonjeksionit Manastir-Elbasan".

Të nesërmen, Lata pati një takim me ish-kryeministrin Sali Berisha. "Vendet e rajonit nuk duhet të merren me devijime të rrjedhjes natyrale të ujërave që i bashkojnë ato. Ujërat duhet të lihen në rrjedhën e tyre natyrale dhe se devijimet e tyre pa marrëveshje, në dëm të interesave të komuniteteve dhe vendeve, duhet patjetër të shmangen sepse mund të sjellin ngarkesa të panevojshme për rajonin", shkruan ish-kryeministri Berisha në FB, pas takimit me kryetarin e Komunës së Dibrës. Por Berisha nuk thotë asgjë për dy vitet që ka qeverisur më problemet e Radikës të bëra publike, të paktën që nga nëntori 2011.

Në morinë e lajmeve mbi këtë çështje, ka ndikuar edhe qëndrimi dualist i zyrtarëve të dy qeverive. Leftër Koka, Ministër i Mjedisit, në deklaratën e tij në selinë e qeverisë më 24 janar, në fillim tha se "ne jemi shumë sensibël kur ka projektide dhe jo kur ka fakte", ndërsa në fund të deklaratës së tij tha se "nuk mundemi dot të gjykojmë projekt-idenë. Gjykojmë projekte konkrete".

Në fakt, ky dualizëm në qëndrime, jo ka projekt, jo s'ka projekt, jo ka ide, jo projekt ide, po punohet mbi projektin, jo po punohet mbi ndikimet në mjedis, jo ka ndikime, jo s'ka ndikime, e kanë shoqëruar gjithë muajin në debate, thënie e kundërthënie që nuk i kanë rezistuar kohës më shumë se 24 orë. Fakte të reja, materiale të vjetra dhe të shitura si të reja, thënie e kundërthënie, citime dhe replika kanë shoqëruar mjedisin politik dhe mediatik gjatë janarit, duke e bërë çështjen jo vetëm të paqartë, por edhe duke krijuar hapësira spekulluese.

Në këtë vorbull "ka-s'ka" u përfshi edhe Presidenti i Republikës, i cili, sipas mediave qendrore të Tiranës, zhvilloi një takim me ministrin e jashtëm Ditmir Bushati për këtë çështje.

Spekullimet politike kanë arritur deri aty, sa kjo çështje të bëhet edhe një ushqim i majmë për qarqet nacionaliste. Protestat për Radikën e rikthyen në vëmendje një projekt ide të Serbisë për të bërë Vardarin e lundrueshëm. Hipotezat e hedhura në publik se ujërat e Korabit mund të shërbejnë për të bërë Vardarin e lundrueshëm, fusin në lojë edhe hipoteza të tjera, kryesisht të karakterit nacionalist. Në faqen e FB, anëtarët hodhën më 27 janar një lajm që flet mbi "kthimin e Vardarit në lum të lundrueshëm", një projekt 100 vjeçar i Serbisë për dalje në det. Lajmi riqarkullon në median onlinë sa herë shtrohen çështje për t'u zgjidhur mes dy vendeve, sikur kërkohet të tregohet prushi që nuk duhet prekur...

Koço Danaj, Kryetari i Listës për Shqipërinë Natyrale, një lëvizje politike që synon bashkimin kombëtar, në një intervistë për PORTALB, tha se "qeveria Rama, qeveria Thaçi, por edhe secili shqiptar është i detyruar sot a nesër të ndodhet në Dibër të Madhe, në Radikë. Nuk bëhet fjalë për fatin e një lumi, bëhet fjalë për fatin e një kombi". "Radika, thotë Danaj, është lumi i Shqipërisë natyrale dhe të jemi të sigurt se në këtë "Lumë" do të mbytet përfundimisht si shovinizmi maqedonas dhe ai serb, ashtu edhe disa gjakprishur shqiptarë që ju shërbejnë atyre për një "trastë me euro".

Ndërkohë, Sulejman Abazi, një vëzhgues politik dhe ekspert ushtarak, në një postim të tij në Facebook në 30 janar, e quan devijimin e lumit "një krim me pasoja kombëtare". "Brenda konceptit "Radika" dallojmë dhe luftën e ashpër politike brenda vendit, në heshtje brenda shumicës parlamentare dhe hapur nga krahu opozitar", shkruan ai. "Projekti Radika është një krim me pasoja kombëtare, rrezik për sigurinë kombëtare, thekson Abazi, duke vazhduar se qytetarët duhet të marrin shpjegime nga "Mediu, Berisha, Gjiknuri, Rama, Meta, Bushati, Ali Ahmeti, Valon Saraçini, Abdylaqim Ademi, Bujar Nishani dhe të tjerë që kanë pasur dhe kanë dijeni për fillimin e punimeve të këtij projekti".

Kryeministri Rama, në seancën parlamentare të 23 janarit, në lidhje me çështjen e Radikës, duke sulmuar

Si në çdo rast në këtë histori pluralizmi shqiptare, çështje të caktuara që shtrohen për zgjidhje nuk i bashkojnë politikanët shqiptarë, por i ndajnë. Njëra prej tyre mund të dalë më e fituar politikisht, disa anëtarë të tyre mund të bëjnë një karrierë të shkëlqyer, por çfarë vlerë do të ketë kjo, në qoftë se ujërat e Radikës do të devijohen?

qeverisjen e deridjeshme, tha se "... duke u sjellë si mos më keq me përfaqësuesit shqiptarë të qeverisë në Maqedoni, të cilët e kanë përsëritur më shumë sesa një herë që projekt-ideja e hidrocentralit mbi lumin Radika nuk ka asnjë shans të përparojë në dëm të Dibrës së Madhe dhe të vetë Shqipërisë. Ne themi s'ka projekt, e jo më të ketë pastaj një vendim për të nisur në mënyrë të njëanshme një projekt, në shkelje të interesit tonë kombëtar dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ujërave, të cilave i'u nënshtrohen po njësoj edhe Shqipëria, edhe Maqedonia, edhe Greqia dhe kështu me radhë..." "Nuk ka projekt!, thotë kryeministri Rama, sepse projekti në këtë rast, për çdo njeri që kupton dhe jo më për çdo njeri që një herë, një ditë të vetme është ulur në një zyrë qeverie apo në një zyrë sipërmarrjeje, nuk quhet një ide apo një skicë-ide e një qeverie tjetër, por quhet një projekt-zbatimi që e ka në tryezë edhe qeveria jonë, përderisa përfshin apo prek edhe Shqipërinë. Por as ne nuk e kemi një të tillë, as qeveria maqedonase nuk e ka një të tillë. As Banka Botërore nuk e ka financuar një të tillë. As bëhet fjalë që një projekt i tillë të financohet nga Banka Botërore apo nga cilido institucion financiar ndërkombëtar pa miratimin edhe të qeverisë së Shqipërisë dhe në respekt të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare".

Shoqatat mjedisore kërkojnë transparencën e qeverisë dhe politikës lidhur më çështjen e devijimit të ujërave, por në fakt ato nuk e bëjnë për vetë atë që ua kërkojnë të tjerëve. Aleanca Kundër Devijmit të Lumenjëve nuk i ka publikuar ende organizatat dhe shoqata i janë bashkuar, duke krijuar kështu edhe hapësira për spekullime. Megjithatë, ata reagojnë kur abuzohet me emrin e tyre. "Kauza jonë nuk është nacionaliste, reagojnë. Komunitetet greke dhe maqedonase janë aleatët tanë në këtë përpjekje qytetare. Për këto arsye, ne gjejmë edhe njëherë rastin të dënojmë qëndrimet nacionaliste dhe luftënxitëse të disa individëve, të cilët nuk përfaqësojnë Aleancën", thuhet në një deklaratë të AKDL.

Si në çdo rast në këtë histori pluralizmi shqiptare, çështje të caktuara që shtrohen për zgjidhje nuk i bashkojnë politikanët shqiptarë, por i ndajnë. Njëra prej tyre mund të dalë më e fituar politikisht, disa anëtarë të tyre mund të bëjnë një karrierë të shkëlqyer, por çfarë vlerë do të ketë kjo, në qoftë se ujërat e Radikës do të devijohen?

Prandaj është në të mirën e vendit që politika t'i largohet me takt kësaj çështje dhe të mobilizojë gjithë energjitë e saj, nga e majta në të djathtë, për ta zgjidhur problemin, në të mirë të vendit dhe të shqiptarëve në rajon.

Kush po tenton të shkatërrojë Dibrën?

Nga **IBRAHIM KOLARI**

Sot po zhvillohet një debat, për vendimarrjen e Qeverise së R. Të Maqedonisë për devijimin e lumit Radika me destinacion për përfitime ekonomike. Mirëpo në vendet me demokraci të mirëfilltë, vendimarrjet e tilla gjithmonë vendosen me referendum mbarë popullor ose me një debat të gjerë publik ku fjalën kryesore e kanë ekspertet të cilët e vlerësojnë dhe e bëjnë të ditur rëndësinë e projekteve të tilla afatgjate. Në rastin e marrjes-devijimit të lumit Radika që ndodhet në rajonin e Dibrës së Madhe, jo vetëm që skemi debate me specialistët e fushës përkatëse, por nga ana e qeverisë së Maqedonisë kemi edhe injorim dhe indiferentizëm ndaj dëgjimit të zërit të popullatës vendase.

Qeveria e Maqedonisë në formë arbitrare po vepron në këtë rast dhe unë si qytetar i Dibrës dëshiroj që përfaqësuesit tanë shqiptar në qeveri të prononcohen drejtë dhe hapët rreth këtij projekti qëllimdashës për bashkëkombësit e mi. Përse qeveritarët dhe politikanët po sillen ka ashpër me Dibrën? Nuk mjafton plaga e mërgimit ekonomik prej 50 vitesh që e ka zbrazur këtë qytet të lashtë me tradita dhe histori kombëtare, por tani duan edhe ta kthejnë në një shkretëtirë në zemër të Ballkanit. Prandaj ne si dibran, por edhe të tjerët duhet ta mbrojmë sot pronën tonë të përbashkët, ujin e Radikës i cili është vetë jeta jonë. Ne, duhet bashkë, pa dallim kombësie dhe feje të protestojmë për këtë projekt që do zhduki Florën dhe Faunën, do shkatërrojë turizmit në këto anët, do të largojë njerëzit që vijnë për shërim në Banjat e Dibrës, shkurt do vdesin të gjitha ato pak biznese që funksionojnë sot.

Nuk mundet një lum të devijohet pa marrë miratimin edhe të shteteve fqinje, në këtë rast Shqipëria sepse uji është pronë e natyrës, pronë kolektive të njerëzimit jo vetëm të një kombi, por të disa kombësive, me këtë projekt qeveria po nxit edhe një urrejtje etnike duke prishur marrëdhëniet midis fqinjëve, midis shokëve dhe bizneseve.

Të gjithë qeveritarët shqiptar si në Tiranë ashtu edhe në Shkup rrahin gjoksin se marrëveshje nuk ka për devijimin e lumit Radika, se projekti është i parealizueshëm, por ka vite që kane nisur punimet në heshtje dhe fshehtësi. Duket sikur jemi të përgjumër këtë periudhë, duket sikur jemi indiferentë ndaj vetvetes, më duket sikur i thërrasim vdekjes kolektive klinike.

Prandaj si qytetar dibran, si biznesmen, si ish-kandidat i pavarur për komunën e Dibrës së Madhe e pash të arsyeshme të shkruaj këto rreshta për çështjen e lumit të Radikës me qëllimin e mirë që të gjithë se bashku të reagojmë si vëllezër sepse uji është më i rëndësishëm se çdo gjë tjetë ne bote.

protesta

Protesta në **Peshkopi: STOP devijimit** të Radikës

Proteste qytetare kundër devijimit të ujërave të Radikës "mori shkas nga disa njoftime të marra nga mediat brenda dhe jashtë", tha në fillim të fjalës së tij gjatë protestës të zhvilluar më 16 janar para pallatit të Kulturës në Peshkopi, Ing .Munir HOXHA, në emër të grupit inicues.

Ing. Munir Hoxha, pasi bëri një përshkrim të rrjedhës natyrore të Radikës dhe dobia e saj për popullatën dhe mjedisin, theksoi se "Jemi shume të shqetësuar për këtë projekt. Me dobitë e ujërave të Radikës e kanë lidhur jetën e tyre jo vetëm popullsia e trevës së Dibrës në të dy anët e kufirit, por edhe më gjerë, në mbarë pellgun ujëmbledhës të Lumit Drin. Në kushtet e një përgjumje të institucioneve shtetërore përgjegjëse, qytetarët dibranë, e ngrejmë sot zërin më forcë, për t'i zgjuar nga gjumi letargjik institucionet përgjegjëse të qeverive e shteteve respektive, dhe veçanërisht ato të qeverisë shqiptare, për t'u dhënë zgjidhje të shpejtë e të drejtë problemeve të devijimit të lumenjve ndërkufitare, si dhe për t'u dalë Zot të drejtave tona të shenjta që na i ka falur Zoti, dhe si te tilla, askush tjetër përveç atij nuk mundet për me na i marrë ...

"Është mëse e qartë se për Shqipërinë, dy lumenjtë e saj kryesor, Drini dhe Vjosa, janë lumenj të rëndësishëm për ekonominë dhe kulturat lokale të shqiptarëve të Shqipërisë dhe të atyre që jetojnë në trojet e tyre etnike në Maqedoni e më gjerë. Por, kohët e fundit po shikohet se vendet përreth nesh si Greqia ashtu edhe Maqedonia, për nevojat e tyre energjetike po përpiqen që të devijojnë rrjedhën natyrale të lumenjve, Vjosa dhe Radika. Këto të drejta mbrohen edhe në bazë të konventave ndërkombëtare, të direktivave të BE, për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave ndërkufitare. Në këto kushte devijimi i rrjedhave të lumenjve është i ndaluar dhe devijimi eventual i tyre do të jepte ndikime shumë të mëdha në aspektin social- ekonomik, por jo me pak në mjedis, e për rrjedhojë do të shkaktonte efekte negative për florën, faunën, ekosistemin, biodiversitetin natyror. Ne kërkojmë të mbrojmë të drejtat tona mjedisore, ekonomike e jetësore të banorëve të pellgut të Drinit ose interesat e Republikës së Shqipërisë, por edhe të banorëve shqiptarë të Dibrës së Madhe në trojet e tyre në Republikën e Maqedonisë. Kjo sipas qytetarëve dibranë do të thotë që edhe kaskada e Drinit me hidrocentralet e saj do të kenë më pak prurje, për pasoje thatësirë në fushën e Dibrës. Ndërtimi i një hidrocentrali mbështetur nga qeveria maqedonase, i cili do furnizohet edhe nga prurjet e Radikes, për banorët është një projekt vdekjeprurës për faunën dhe florën në Dibër të Madhe. Ndaj dhe qytetarët dolën në shesh për ta bllokuar".

Ing. Hoxha citoi edhe mbështetjen që po i vjen çështjes nga ambientalistë dhe shkencëtare europianë. "Ne i kërkojmë autoriteteve të Bankës Botërore dhe të Bashkimit Europian, që para se të vendosin për të financuar këto projekte, të dëgjojnë me vëmendje zërin kundërshtues të qytetarëve të Dibrës, sepse ky projekt do të kishte ndikime negative në mjedisin jetësor ... Për të gjitha këto arsye, qytetarët dibranë janë mjaft të shqetësuar dhe për këtë protestojnë ashpër kundër këtij projekti që synon devijimin e rrjedhës natyrore të lumit Radika. Me këtë projekt, jo vetëm do të nëpërkëmbeshin interesat e gjithanshme të mbarë Dibrës, por edhe më gjerë ,.. si dhe duke prishur e dëmtuar rëndë ekosistemin natyror të kësaj zone, do të bëhej kështu edhe një krim i madh ekologjik. Ndaj ne sot protestojmë fort me moton: "Të bëhemi të gjithë bashkë në një "Lëvizje të gjerë qytetare" dhe të ndalojmë me çdo kusht devijimet e rrjedhjes natyrale të lumenjve Radika dhe Vjosa. Sepse, këto janë krime ndaj natyrës, dhe krimet ndaj natyrës janë krime ndaj paqes dhe njerëzimit....

Në fund të fjalës së tij, në emer të grupit nismëtar, ai tha "se i bëjmë thirrje qeverisë së Republikës së Maqedonisë, që të ndalojë dhe të heqë dorë njëherë e përgjithmonë nga projekte të tilla që nëpërkëmbin të drejtat legjitime njerëzore të komunitetit dibran e më gjerë .. I bëjmë thirrje qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që të vërë në lëvizje të menjëhershme të gjitha institucionet brenda vendit dhe organizatat ndërkombëtare për të ndaluar, njëherë e përgjithmonë projekte të tilla që nëpërkëmbin të drejtat legjitime njerëzore të komunitetit dibran. Presim nga të dy qeverite respektive që të reflektojnë menjëherë rreth këtyre problemeve , dhe në qoftë se brenda një muaji nuk informohet e gjithë popullsia e interesuar për ndalimin e këtij projekti djallëzor në dëm të interesave tona legjitime, lëvizja jonë e protestës do të zgjerohet në përmasa shumëfish më të mëdha se sot...".

Më pas, në këtë protestë qytetare e civile foli edhe Ahmet Çaushi, anëtar i grupit nismëtar për organizimin e protestës në Peshkopi. Ai tha në tubim se "shqiptarët e Dibrës së Madhe dhe Peshkopisë e rrethinave të saj kërkojnë nga qeveritarët dhe të gjitha partitë politike të lënë kundërshtitë midis tyre e t'i bashkojë problemi më patriotik e më i domosdoshëm i kohës, të ndalin marrjen qoftë edhe të një pike uji nga Radika". Ai i kërkoi shqiptarëve në qeverinë e Maqedonisë që "të kundërshtojnë me forcë e me çdo kusht marrjen e vendimit për devijimin e ujit të Radikës. Nëse nuk dëgjohet zëri i tyre , atëherë para se të vendoset, të largohen nga bashkëqeverisja me maqedonasit".

Ndërsa Murat Koltraka, anëtar i bordit drejtues të protestës, pasi bëri një panoramë historike, politike dhe ekonomike të marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase, në fjalën e tij u përqendrua edhe të efektet mjedisore dhe shoqërore që do të sillte marrja e ujërave të burimeve të Korabit. "Devijimi i lumit Radika asgjëson të gjithë ekuilibrat natyrorë të vendosur në një rajon shumë të gjerë, asgjëson florën, faunën, bashkëveprimin reciprok midis botës bimore e asaj shtazore, me ekzistencën e të cilëve është lidhur pazgjidhshmërisht jeta njerëzore në tërë rajonin. Vetëkuptohet se kulturat bujqësore në tokat tona pa Radikën janë të vdekura nga etja për ujë. Pa Radikën në këta troje nuk ka jetë", tha ai. Më pas, Koltraka citoi specialistet, të cilët argumentojnë se nga mungesa e Radikës mund të lindin fenomene me pasoja katastrofike për banorët e këtyre viseve. Nëntoka është e pasur me ujëra të nxehta në të dy Dibrat. Mungesa e Radikës mund të sjellë ndryshim të temperaturës aktuale të këtyre ujërave të nxehtë, për pasojë mund të shkaktohen tërmete , si dhe kushte favorizuese për shpërthim të ndonjë vullkani që mund të sjellin tragjedi shumë të rënda në dëm të jetës njerëzore të dibranëve në të dy anët e kufirit".

"Dibranët më shumë se kushdo tjetër e dinë mirë se uji është themeli i jetës, i kushtueshëm si gjaku. Gjaku dhe uji nuk falen", përfundoi ai.

Në këtë tubim foli edhe kryetari i bashkisë së Peshkopisë, i cili ashtu si dhe homologu i tij në Dibër të Madhe, u janë bashkuar protestave me moton "Stop devijimit të Ujërave të Radikës".

***

Pas takimit të Kryeministrit Edi Rama me dy ministrat e Maqedonisë, Ademi dhe Saraçini, lëvizja qytetare në Peshkopi "Kundër Devijimit të Rrjedhjes Natyrore të Lumit Radika" , nxori një deklaratë për shtyp, ku mes të tjerash theksohet: "Në deklaratën e bërë së bashku me ministrat shqiptarë të qeverisë së Maqedonisë, u pranua hapur se një kompani ndërkombëtare po punon për të hartuar brenda muajit qershor 2014, projektin final për devijimin e lumit Radika në drejtim të Fushës së Llukovës, ku mendojnë që të ndërtojnë disa h/c dhe pastaj në liqenin artificial të Mavrovës dhe përfundon në lumin Vardar dhe në Detin Egje ...

Ju kujtojmë se lëvizja qytetare dibrane do të kërkojë edhe mbështetje mbarëkombëtare dhe nuk do t'i pushojë protestat deri sa qeveria e Maqedonisë dhe kryeministri Gruevski, të heqë dorë një herë e përgjithmonë nga bërja e këtij projekti famëkeq, antishqiptar, për devijimin e rrjedhës natyrore të lumit Radika ....

I drejtohemi ministrave shqiptarë të Maqedonisë se çfarë kuptimi kanë fjalët e tyre, se "në qoftë se edhe dibrani i fundit të jetë kundër këtij projekti, ky projekt nuk do të realizohet!" Atëherë me të drejtë lind pyetja tjetër, se ju keni dëgjuar jo një, por me mijëra qytetarë dibranë që kanë kundërshtuar me forcë bërjen e një projekti të tillë. Atëherë pse qeveria juaj po vazhdon të shpenzojë para për një projekt që e pret dështimi i sigurte?!

"Jemi të vendosur se lëvizja jonë qytetare, nuk do të ndalojë deri sa të hidhet përfundimisht poshtë ky projekt djallëzor", përfundon deklarata e tyre.

Korresp. "Rruga e Arbërit"



Pamje nga protesta në Peshkopi.

Gazetarët e Tiranës vizitojnë Dibrën e Madhe

Lata: Nuk do lejojmë devijimin dhe degradimin e lumit Radikë

Në mjediset e Komunës në Dibër të Madhe, të enjten më 23 janar 2014, Mr.Ruzhdi Lata, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe dhe Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë mbajtën konferencë me gazetarët nga Ora News, News 24, Klan TV, UTV, Top Channel, Sky TV, A1 Report si dhe gazetat 55, Panorma, Gazeta Shqiptare, Shqiperia.com dhe "Rruga e Arbërit".

Në fillim ta takimit, Mr.Ruzhdi Lata, pasi bëri një ekspoze të marrëdhënieve historike e sociale të Dibrës më pjesën tjetër të Shqipërisë, kontributin që kanë dhënë dibranët që nga perandoria osmane e deri në themelimin e shtetit shqiptar e më vonë, u ndal në çështjen më të debatuar të këtyre ditëve, që ka të bëjë me devijimin e ujërave të Radikës dhe degradimin e luginës dhe parkut kombëtar të Mavrovës.

"Ndërtimi i pendës së Spiles e gëlltiti hambarin e Dibrës, gëlltitje i kanë bërë Dibrës me gjithë qenien e vet. Toka ku tani është liqeni ka qenë toka më e begatë dhe kishte prodhime më maksimale. Pastaj ana bujqësore dhe materiale na dëmtoi shumë në vlerat historike ngase Dibra si qytet sëpari ka qenë rreth Radikës në ata përmbytje që u bënë nuk ka shanse më të bëhet ndonjë hulumtim arkeologjik të merret ndonjë e dhënë se në çfarë mënyre ata njerëz kanë jetuar", tha ai. "Ishte një premtim vaditja e fushës së Dibrës, por ajo fushë kurrë nuk u vadit edhe pse u bë infrastruktura", thotë ai. "Nga liqeni që ju sot e shihni, Dibra nuk ka asnjë të ardhur, ngase ndërmarrja për prodhimin e rrymës elektrike, që është një shoqëri aksionere, nuk dëshiron të mos ketë edhe një lidhje të vogël me Dibrën. Kjo ndërmarrje për Dibrën nuk ka dhënë asnjë kontribut, sado të vogël, qoftë edhe për fëmijët me aftësi të kufizuar, e jo më për një shkollë, për një rrugë apo për një spital".

"Dibra është qytet i pasur me pasuri natyrore , është i pasur me bukuri natyrore, ka banja natyrale , ka fabrikën e gjipsit e cila mundë të ndërtohet, të rindërtohet, mundë të bëhet një hotel dhe të bëhet edhe një tjetër por në trekëndëshin Shqipëri, Kosovë, Maqedoni në malet e Korabit është një dhunti e natyrës, një bukuri e veçantë që për interesat e veta shteti maqedon e ka futur në projektin e parkut nacional për nga bukuria dhe për nga të mirat që i ka ajo natyrë. Aty gjenden gjashtë burime uji. Është karakteristikë e Radikës në krahasim me të gjithë lumenjtë e tjerë në Europë, është i vetmi lum i cili është i pijshëm dhe i pastër".

"Në këtë sallë kanë qenë të pranishëm para dy muaj edhe përfaqësuesit e Elemi-t së bashku përfaqësuesit e Bankës Botërore. Asnjë shqiptar me tyre. Herën e dytë ishin përgatitur dhe kishin marrë edhe një shqiptar. ata ishin kontradiktor në shpjegimet e tyre, nga 2.3 metër kub deri në nëntë metër kub... Po qe se merret ai ujë, Dibra duhet të shpërngulet përsëri", tha Lata. "E refuzuam këtë projekt dhe nuk do ta pranojmë atë projekt me parimin historik dhe tradicional se gjaku dhe uji nuk falet!".

Marrja e atyre burimeve jo vetëm që na dëmton ne, dëmton natyrën është fjala se kryesore që do bëhet prodhimi i rrymës elektrike, burimet janë në një lartësi mbidetare 1800 metra. Lartësi ku burojnë deri në Dibër sëpaku mundë të ndërtohen deri në pesë hidrocentrale. Nëse është për rrymën elektrike ai vjen në hidrocentralin e Spiles mundë të përsoset hidrocentrali dhe të prodhohet më shumë mundë të ndërtohen edhe tjera. Gjatë rrjedhjes së atij uji dhe të prodhohet më shumë energji elektrike. Ne nuk jemi kundër asaj që Maqedonia mos ketë rrymë elektrike, ne nuk e pengojmë prodhimin energjetik të Maqedonisë, por ju ofrojmë alternativë që të kemi prodhim energjetik, por mos kemi edhe dëm ekonomik. Ato shohin vetëm prodhimin energjetik dhe pastaj vijnë punët tjera që ata i shohin në planet dhe projektet e tyre. Në këtë rast duhet falënderuar gjithë shqiptarët pasi nuk e di a mbeti ndokush që të mos na bashkëngjitet. Projekti për ndërtimin e HC në Fushë të Llukovës është në dëm të Dibrës dhe të shqiptarëve. Nuk ekziston ndonjë shqiptar që të jetë dakord me këtë projekt, tha Mr.Ruzhdi Lata.

Ilir Krosi, shtoi se në Dibër ndodhen resurse që na i ka falë Zoti dhe në këtë kontekst, siç funksionon shteti, siç funksionon vetë bota, këto gjëra hyjnore nuk mundë të devijohen nga individë ose interesa ekonomike. Në aspektin njerëzor nuk mundë të ndodh, në aspektin hyjnor kryesisht nuk mundë të bëhet. Në aspektin ligjor këto janë çështje të karakterit ndërkombëtar të cilat kanë marrëveshje strikte, të cilat nuk mund të shkelen".

Më pas, gazetarët nga Tirana bënë vizita në grykën e Radikës, takuan specialistë dhe qytetarë të Dibrës për të mbledhur opinionet kundër devijimit të ujërave të Radikës.

Rexhep TORTE

Rruga e Arbërit nr. 93

Një plan i tërë zhvillimi i gjithë zonës minerare është detyra jonë dhe këtë duhet të bëjmë! Jashtë krimit dhe larg interesit të tij!

Ekonomia *dhe* **krimi** *nuk mund të rrinë bashkë*

Nga **ERION BRAÇE**



Krimi ka kapur një prej sektorëve më fitimprurës të ekonomisë: industrinë e nxjerrjes së kromit!

Vrasjet në Bulqizë e në Tiranë, kohë pas kohe, janë të lidhura me përfitimet marramendëse në këtë sektor të ekonomisë. Përfitimet që vijnë nga lejet koncesionare, çmimi i lartë i produktit, evazioni i llahtarshëm fiskal! Një grusht "biznesmenësh" pasurohen, ndërsa shteti dhe shoqëria nuk marrin asgjë. Madje më keq. Shteti dhe shoqëria vuajnë traumën e larjes së hesapeve mes këtij grushti "biznesmenësh"!

Ka 8 vjet që ndodh kështu dhe struktura kriminale tani është konsoliduar, forcuar, pasuruar aq sa shpesh, gjithnjë e më shpesh, flitet për një dysheme pasurie për çdo "familje" që kontrollon vrimat apo stoqet e kromit; vlera e përmendur është mbi 20 milionë dollarë për secilin!

Këtë e kam thënë kur kam qenë në opozitë; këtë po ju them dhe sot! Ministri i Industrisë po bën në tre muaj më shumë seç është bërë në 8 vite për të vënë rregull në sektorin e kromit!

Por, në kushtet e kriminalizimit të thellë, në kushtet kur çdo përpjekje për rregull, thjesht gërvisht pasurinë shumëmilionëshe të kësaj strukture kriminale, duhet një zgjidhje radikale: shtetëzim të të gjithë zonës minerare të kromit në rrethin e Bulqizës! Pra, kthimin e të gjithë pasurisë minerare te shteti. E di që do të krijohen probleme sociale për disa javë për shkak se kjo strukturë kriminale përdor njerëzit në nevojë për t'u mbrojtur, por kjo është e përkohshme dhe shpëtim nga krimi!

Një plan i tërë zhvillimi i gjithë zonës minerare është detyra jonë dhe këtë duhet të bëjmë! Jashtë krimit dhe larg interesit të tij!

Pas botimit të këtij komenti në Facebook, disa gazeta shkruan të nesërmen, se propozimi im për "shtetëzimin" e minierave të kromit në Bulqizë qenka "formula e Çavezit" (ish udhëheqësi i Venezuelës). Gazeta, gjithashtu, citon disa kolegë të mi (që për gazetën ishin anonimë!), të cilët kanë kundërshtuar, sepse qenka kthim prapa dhe se zgjidhja është bërja e shtetit të funksionojë!

Të gjitha këto, gazeta i shkruan pasi pranon se kromi është në dorë të krimit, zona minerare e Bulqizës është kthyer në Far-Ëst etj.

Lidhur me to, duhet të bëj edhe disa sqarime, që më shumë se sa lidhen me gazetën dhe "koleget anonime" qe sajohen, ka të bëjë me qytetarët.

E para, është tërësisht e padenjë, e padrejtë dhe jo korrekte, reflekton padituri përqasja e Shqipërisë me Venezuelën, problematika e zonës minerare të Bulqizës me zonën naftëmbajtëse të Venezuelës, formula e faktit të kryer të Çavezit me atë që propozoj unë.

Çavez i shkoj deri në fund idesë së tij të shtetëzimit si praktikë qeverisëse në shfrytëzimin e pasurive kombëtare, rritjes së përfitimeve personale prej abuzimit me pushtetin në administrimin e këtyre pasurive kombëtare, por gjithashtu është e vërtetë rritja e një dimensioni social tej çdo logjike, për më tepër pa punësim, në forcimin e pushtetit të tij personal edhe përmes këtyre përfitimeve, në izolimin total të vendit sipas bindjes së tij revolucionare.

Unë nuk kam propozuar këtë! Asfare!

Çavez përzuri nga Venezuela kompanitë e mëdha të përbotshme, zotëruese të kësaj industrie anekënd botës!

Më tregon dot njeri një korporate të këtij standardi në Bulqizë?

Nuk ka dhe ky është njëri nga problemet!

Shënim i redaksisë:

Lajmet që vijnë shpesh nga Bulqiza, nga nëntoka dhe sipërfaqja e saj, të shumtën e herëve janë të hidhura, megjithëse flitet për një qytet që jeton mbi pasuri të mëdha. "Vdekje", "varfëri", por edhe "vrasje", janë tre fjalët kyçe që shoqërojnë kronikat nga qyteti i minatorëve. Qeverisja e re shqiptare, që gjatë fushatës së saj elektorale, njërën nga pikat kryesore për qarkun e Dibrës, ka qenë rehabilitimi i minierës së Bulqizës dhe kthimi i kësaj pasurie në dobi të shoqërisë. Por, lajmet që vijnë nga institucionet për shfrytëzimin e kësaj pasurie në mënyrë të ligjshme dhe sipas standardeve, shpesh kundërshtohen nga media, një pjesë e të cilave kanë përqindjet e tyre mbi këto galeri, si kthim prapa dhe "shtetëzim" sipas teorive komuniste.

Damian Gjiknuri, ministri i Energjisë dhe Industrisë, tha gjatë një takimi në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në mes të muajit janar, se "është zhvilluar një kontroll i imtësishëm në Bulqizë, ku janë marrë disa masa për ndërhyrje emergjente". "Kërkoj që brenda një afati të shkurtër të përcaktohen zona e rrezikshme në Bulqizë, në mënyrë që aty të mos zhvillohet më asnjë aktivitet minerar dhe të revokohen ato licenca që operojnë në atë zonë. Kjo bëhet për të siguruar jetën e minatorëve", theksoi ai. Por, dy ditë pas këtij takimi, në Tiranë u vra një biznesmen, i cili shfrytëzonte një nga galeritë e minierës së Bulqizës. Media, bazuar në disa burime të policisë, e përcolli lajmin si një luftë mes "bandave të kromit".

Pas këtyre lajmeve, Erion Braçe, deputet në Kuvendin e Shqipërisë, kryetar i Komisionit të Ekonomisë, botoi një opinion të tij në faqen e Facebook, duke kërkuar hartimin e një plani masash, për t'ia rikthyer pasuritë e Bulqizës shoqërisë. Media e Tiranës, shpesh nxitur nga interesa ekonomike të momentit, si dhe herë të kaluara, pati kundërshtime rreth propozimit të tij, edhe duke e quajtur si "kthim prapa", apo "reforma si të Cavezit, ish liderit komunist venezuelian.

Meqenëse lajmet që vijnë nga Bulqiza dhe për Bulqizën kanë qenë vazhdimisht nën vëmendjen e gazetës sonë, ne vendosëm të botojmë qëndrimin e deputetit Erion Brace, i cili e rishkroi qëndrimin e tij, posaçërisht për gazetën tonë.

Me këtë rast, redaksia mbetet e hapur në botimin e mendimeve mbi këtë çështje, me synimin e mirë që të ndalohet njëherë e mirë masakra mbi pasuritë e qytetit të minatorëve.

Gjithë pasuria kombëtare e shqiptarëve në krom, mbase më e madhja që ka ky vend, përmes 197 lejeve minerare është në duar të një grushti njerëzish të paditur, pa pikën e përvojës në administrimin minerar, pa kapacitete njerëzore për të menaxhuar sipas ligjeve dhe në të mirë të interesit publik këtë pasuri, me precedentë të fortë kriminal - evazioni fiskal është barra më e lehtë që mbajnë mbi kurriz. Ky është profili i "biznesmenit" që po u luftuaka në Bulqizë!

Dhe ky është problemi i madh!

Këta e kanë kriminalizuar këtë sektor të ekonomisë! Vendimmarrja politike e 8 viteve të fundit e ka favorizuar këtë strukturë kriminale të fitojë, të rritet, të akumulojë padrejtësisht pasuri të madhe, të mos paguaj, të bëhet agresive, të vrasë në punë e të vrasë edhe në rrugë!

Çfarë lidhje ka kjo me Çavezin?

E dyta, është jo vetëm anonime, por tërësisht e padenjë teza e hedhur m'u aty, pas kësaj të Çavezit, se kthimi tek administrimi publik i zonës minerare të Bulqizës përkohësisht, është kthim prapa.

Cila ka qenë ecja përpara në Bulqizë që unë po e kthej prapa? Po si ka mundësi që bërja e zonës minerare vrima-vrima, që këta "biznesmenët" i quajnë galeri, zgjatimi më pas në tunele pa asnjë kusht sigurie, plan zhvillimi e investimi, të cilat sa herë shemben vrasin punëtore dhe sa herë afrohen e kryqëzohen me njëri-tjetrin, pjellin vrasje "biznesmenësh" në Bulqizë, Durrës apo Tiranë, marrja prej kësaj pasurie kombëtare (e përsëris, kombëtare) e përfitimeve marramendëse, shmangia nga detyrimet fiskale ligjore të këtyre përfitimeve si përfitim ekstra për çdo "biznesmen" dhe si plotësim kombëtar i zhvatjes dhe humbjes për shtetin, qënkërka e ecur përpara dhe, kthimi në administrim publik për të luftuar këtë krim e këtë mafie qënkërka kthim mbrapa?!

Ekonomia dhe krimi nuk mund të rrinë bashkë! Të paktën për mua. Një ekonomi e kriminalizuar është problem kombëtar, jo problemi im personal.

As që më bëhet vonë se më quani Çavez apo Erion!

Më shqetëson interesi publik, puna e njerëzve - e sigurt, e ndershme, e paguar në çmimin që ka, pasuria kombëtare e shpërndarë drejt dhe në shërbim të ekonomisë kombëtare dhe asaj familjare, investimet publike dhe të huaja, një plan zhvillimi afatgjatë që zhvillon këtë vend përmes hapjes së vendeve të punës së sigurt këtu!

Rruga e Arbërit

Njoftim për bashkëpunëtorët

Na shkruani email:
<**rrugaearberit@gmail.com**>

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.
Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

vëzhgim

A mendohet se ç'dëm do ti bëhet ekuilibrave ekologjikë të zonës? Si do të zgjidhet furnizimi me ujë vaditës i Gjoricës së Epër, Çerenecit, Lubaleshit e Zall Strikçanit, ku merren kanalet vaditës shekullore?

A po **rrezikohet Liqeni i Zi**, kjo mrekulli natyre nga një hidrocentral?

Nga **NAXHI HASA**

Aty ku rruga e Arbrit lë komunën e Fushë-Bulqizës dhe futet në territorin e Komunës Zerqan, para disa vitesh u vendos një tabelë reklamë "Liqeni i Zi, Mrekulli natyre". Vërtetë, kështu ka qenë kjo zonë e trevës së Grykës së Madhe. Malet kryelartë e të pasur me minerale si Dhoksi, Kaptina, Kaziaku, Gollobica etj., mbajnë nën këmbët e tyre bjeshkë të bukura e romantike ku më parë në kohë vere vendoseshin rreth 10-12 stane. Sot s'ka asnjë. Në xhepat e këtyre bjeshkëve ndodhen disa liqene akullnajore, secili më i bukur se tjetri si liqeni i Valikardhës, Liqeni i Sopotit, Liqeni i Bardhë i Sopeve etj. Në qendër të tyre, ai më i madhi, më i bukuri Liqeni i Zi. Dikur e një kohë qindra hektarë pyje vishnin këtë zonë, të mrekullueshme të pasur me ujëra, me drurë të shumëllojshëm, pasuri minerale, bimë të rralla medicinale, duke e bërë bashkë me livadhet e paanë vërtetë mrekulli natyrore.

Çuditërisht, Lura në veri dhe kjo zonë në jug të Dibrës tonë, kësaj "Zvicre të vogël", si dy nuse të hijshme i thonë vizitorit: Mirësevini! Kështu shkruan tabela e famshme që bën "rojen e nderit" pa hyrë në urën e qytetit, ku merr drejtimin rruga për në Zerqan.

Po ç'ndodhi këto vitet e fundit me këtë zonë dhe e zhgënjen vizitorin tabela në fjalë? Fatkeqësisht PO. Me mijëra m3 drurë janë prerë e arratisur nga shpatet e luginat e zonës, sa thua s'kanë qenë kurrë të pyllëzuara. Janë prerë, transportuar, shitur sikur këtu s'ka patur pushtet vendor, polici pyjore e hallka të tjera drejtuese. Janë shëndoshë e mirë kryetarët e Komunës së Zerqanit që për 23 vjet e kanë ndërruar atë karrige me të njëjtën ngjyrë blu, si ujërat e Liqenit të Zi.

E keqja e dytë dhe më e madhe po bëhet këtë vit dhe tjetrin që lamë pas. Në këtë territor me bazë kryesore Liqenin e Zi, po hapen kanale për grumbullimin e ujërave të zonës e të hidhen në liqenin kryesor. Poshtë mbi fshatin Valikardhë po gërryhen shpatet për ndërtimin e një hidrocentrali, dhe askush nga komuniteti i zonës nuk din gjë, nëse është ndërtim i ligjshëm, i studiuar apo firma fantazma që kanë bërë e po bëjnë si të duan në territore të veçanta.

Liqeni i Zi është ujëmbledhësi dhe gjithë furnizuesi i burimeve natyrore për fshatrat Valikardhë, Sopot, Zerqan e Strikçan. Ekologjia, flora dhe fauna e zonës do të rrezikohet rëndë e me pasoja jetësore.

Me gjithë informacionet e dërguara ministrive përkatëse pas 23 qershorit 2013, ende asnjë sqarim të komunitetit të zonës. Duket se drejtuesit e komunës kanë duart në supën e gatuar nën sytë e tyre.

Fshati Strikçan në këtë liqen merr kanalin vaditës dhe s'do të jetë e largët dita kur 160 ha tokë do të kthehen në djerrina, sepse është e vetmja nyje furnizimi me ujë e kësaj vepre 22 km kanal (Liqeni i Zi – Strikçan) që bën furnizimin me ujë vaditës.

Në këto punime që bien erë dallavarexhinjsh pushtetarë, të cilët domosdo të korruptuar lejuan e s'ka sesi të mos kenë firmosur dhënien e lejeve për prerjet tërësore të pyjeve kësaj zone,



Liqeni i Zi është ujëmbledhësi dhe gjithë furnizuesi i burimeve natyrore për fshatrat Valikardhë, Sopot, Zerqan e Strikçan. Ekologjia, flora dhe fauna e zonës do të rrezikohet rëndë e me pasoja jetësore... Fshati Strikçan në këtë liqen merr kanalin vaditës dhe s'do të jetë e largët dita kur 160 ha tokë do të kthehen në djerrina, sepse është e vetmja nyje furnizimi me ujë e kësaj vepre 22 km kanal (Liqeni i Zi – Strikçan) që bën furnizimin me ujë vaditës.

Në këtë territor me bazë kryesore Liqenin e Zi, po hapen kanale për grumbullimin e ujërave të zonës e të hidhen në liqenin kryesor. Poshtë mbi fshatin Valikardhë po gërryhen shpatet për ndërtimin e një hidrocentrali, dhe askush nga komuniteti i zonës nuk din gjë, nëse është ndërtim i ligjshëm, i studiuar apo firma fantazma që kanë bërë e po bëjnë si të duan në territore të veçanta.

që deri pak para ca vitesh nuk ishte kështu si është katandisur. Duke zëvendësuar njëri-tjetrin, këto drejtues komunarë kujtuan se do të ishin "feudalë" të pazëvendësueshëm. Tani populli, banorët e kësaj zone të urtë e punëtore, e ka të qartë se ç'bënë këto zotërinj, por duket se është vonë për katastrofën në pyjet, liqenet e burimet ujore të kësaj treve, po s'duhet të jetë aspak vonë për llogarinë që duhet të japin të gjithë kush e lejoi këtë barbari që po vazhdon. Po kështilli i komunës Zerqan, si ka heshtur dhe hesht. A janë ngritur këto probleme? A ka protokolle mbledhjesh? A janë dokumentet e lejeve etj.? Problemi do të bëhet shqetësues e serioz në qoftë se do të mblidhen ujërat e kësaj zone bujqësore për të vënë në punë një mikrohidrocentral, sikur do të jetë shpëtimtari i zonës me energjinë e tij.

Në krahun tjetër lindor vazhdon masakra me lumin e Okshtunit, ku siç marrim vesh do të ndërtohen disa hidrocentrale nga Borova në Çerenec. Vazhdon hapja e rrugës dhe dëmtimi i shpateve të malit të Strikçanit me pyje të virgjër. Vende-vende ka rrëshqitje masive. Lumi, siç thuhet, do të futet në tubacione.

A mendohet se ç'dëm do ti bëhet ekuilibrave ekologjikë të zonës? Si do të zgjidhet furnizimi me ujë vaditës i Gjoricës së Epër, Çerenecit, Lubaleshit e Zall Strikçanit, ku merren kanalet vaditës shekullore?

Është detyrë e domosdoshme dhe e shpejtë që Ministria e Bujqësisë dhe e Mjedisit, të verifikojë këto probleme që shtrojmë, të evidentojmë rregullsitë e parregullsitë e bëra sidomos pas 23 qershor 2013, veprimeve të shpejta 3-4 mujore që u kryen me shpejtësi në këtë periudhë, që u duk si një vakuum i plotë shteti.

SHËNIM: ***Autori është banor i fshati Strikçan, në Komunën e Zerqanit. Redaksia, në pamundësi t'i verifikojë të gjitha shqetësimet e autorit, fton palët e prekura në këtë shkrim të botojnë edhe ata shqetësimet e tyre.***

Doni te informoni komunitetin rreth jush
per dicka qe ju shqeteson apo ju intereson?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!

rrugaearberit@gmail.com

rreth e rrotull-a

Ç'kemi ásaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ka pas ngjarje këtë muaj. Kryesore RADIKA. Protesta gjithandej, në televizione. Këtë herë pati edhe një protestë burrash në Peshkopi. Më në fund, një protestë siç duhet...

Protesta pati edhe në Tiranë. Shkova dhe unë. Rreth 100 burra dhe gra. Nuk kuptohet për çfarë ishte protesta kur i shihje nga larg. Asnjë parullë në duar! Rrofshin televizionet që ua treguan ju se për çfarë ishte, ndërsa unë pata fatin t'i dëgjoja live...

"Uji i Radikës, - tha njëri prej oratorëve, është uji më i pastër në Europë. Nga Arabia kanë ardhur për ta marrë, ndaj ne nuk ua falim sllavo-maqedonasve..." Por kur dashkan me e marrë arabët, pse të mos ua japim maqedonasve, në fund të fundit fqinj i kemi!

Për të mbrojtur Radikën janë ngritur të shqetësuar ambientalistë, shkencëtarë, biologë, qytetarë... Është në rrezik flora dhe fauna, rrezikohen ujqërit, arinjtë, rrëqebulli i Ballkanit - një lloj maceje, peshku, trofta, luleshqerra dhe 1000 lloje bimësh. Sa mirë, për florën dhe faunën ka kush kujdeset, por njerëzit kush i mbron?

Për Radikën, ti e di që ne kemi shkruar që në 2011-ën, falë dibranëve të përkushtuar dhe që e duan Dibrën, por për të u kujtuan vetëm kur në valle u fut dhe Vjosa... Sa për sqarim, Vjosa nuk është femër, është lum i madh në jug të Shqipërisë...

Meqë jemi te Radika, doli edhe moda e fundit në Facebook. "Të mbrojmë lumin Radika", ishte grupi i parë që synonte të bashkonte aktivistët... Pastaj filluan me radhë "STOP devijimit të rrjedhës së lumit Radika", "Të mbrojmë lumin Radika", "Lumi Radika", "Edhe Dibranët e Arizonës Stop Devijimit të Lumit Radika"... Të gjithë me *Radikë* brenda, por pa ujë... Meqë nuk bëhemi bashkë edhe për ujin, prit tani kur të vijnë edhe ftesë të tjera të thata me Radikën nëpër rreshta...

Ke dëgjuar, besoj, se janari ishte muaj me C4... Nuk bëhet fjalë për llojë makine, po them për një lloj dinamiti... Ngjarjet kanë ndodhur në Tiranë, por që prekin Bulqizën... Boll halle ka Bulqiza, tani i duhen dhe bombat...

Tani do të dal te rruga, se e di që e ke merak...

Një gazetar i yni shkoi të bënte një reportazh në terren, atje ku punohet për Rrugën... Punonin 2-3 makina dhe 4-5 punëtorë... Gazetari ynë jo vetëm që nuk mori dot informacion, por shyqyr që shpëtoi pa e rrahur dhe pa një gjobë..., sepse kishte shkelur pa leje "në një zonë rreziku"...

Ndërkohë, lajmet thanë se po vijnë kinezët. Në fakt, më përpara për rrugën na kanë thënë se do të vijnë gjermanët, pastaj u hap llafi për austriakët, u futën në lojë italianët, pastaj qeveria tha e bëj unë këtë punë, s'kemi nevojë për të huajt... Tani na dalin kinezët... Po ku janë, more aman, se na plasën...

Se desh harrova, Vitin e Ri e kalova në Peshkopi. Shumë ftohtë dhe shumë kapsolla... Era barut i vinte qytetit. Ka lezet, nuk vjen përditë Viti i Ri!

Sapo hyra në qytet, më ra zilja e telefonit:

- Hë mo, erdhe! Do na qesish ni kafe ke turizmi?

- S'kam ardh' akoma, sapo hyra...

- Kë rre taj, unë t'pashë, tu shëtajt bulevardit...

- Ku je, ku më pe?

- Unë jam në shpëj e t'pashë në televizor! Thkeu mbrapa nja 10 metra ene ma luj dorën sa më m'përshëndet, se e shof se s'ke menje për kafe...

Si lum Peshkopia, ka kamera në bulevard, por s'ka as televizion, as gazetarë!

Kam edhe shumë lajme të tjera, por ti them herë tjetër, se mbaroj kolona në gazetë, s'ka më vend!

Një histori mbi lidhjet martesore. Suksesi, por edhe shkaku i ambicjeve midis familjeve të mëdha feudale. Çelësi i forcimit të miqësive por edhe i konflikteve. Nga martesa e Gjergj Kastriotit Skënderbeut te çifti Meta-Kryemadhi... Një studim për tu vlerësuar

studim

Martesat dibrane më të famshme

Nga **Mentor HOXHA**
Master Shkencor në Studime Letrare

Martesat më të famshme dibrane mbajnë emrat e tre prej njerëzve më të fuqishëm dhe më të njohur që ka nxjerrë historia dibrane dhe ajo mbarë shqiptare gjithëkohore e gjithëhapësinore. Ato që kanë dominuar e vazhdojnë të dominojnë skenën historiko-politike shqiptare janë një mashkull e dy femra; Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Nexhmije Xhuglini (Hoxha) dhe Monika Kryemadhi. Dy figurat e fundit, përveç fuqisë së tyre të spikatur politike, intelektuale dhe drejtuese, kanë bërë për vete dhe janë martuar me dy nga burrat që kanë drejtuar qeverinë e shtetin shqiptar në tri prej periudhave më të gjata të historisë shqiptare (1941-1985), (1992-2014), përkatësisht Enver Hoxha e Ilir Meta. I pari kryetar i Partisë Komuniste Shqiptare që nga themelimi i saj më 8 nëntor 1941 dhe për 40 vite me radhë (1941-1985) udhëheqësi absolut i Shqipërisë Komuniste. I dyti, dy herë kryeministër, aktualisht Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë. Edhe ish presidenti shqiptar Bamir Topi është me origjinë nga Dibra, por "kur u hap diskutimi nëse kryetari tanishëm i shtetit Bamir Topi ishte me origjinë nga Sopoti i Dibrës, nuk u dëgjua ndonjë zë dibrani për të dëshmuar prejardhjen e tij1). Në qytetin e Peshkopisë ka punuar për disa vite si mësuese edhe Lidra Meidani, bashkëshortja e presidentit shqiptar Rexhep Meidani.

MARTESA E GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT

Dibrani[2] Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, e drejtoi shtetin e Arbërit në një nga periudhat më të vështira, por më të lavdishme të popullit shqiptar. Më 28 nëntor 1443 ai ngriti për herë të parë në kështjellën e Krujës flamurin shqiptar në vend të atij turk dhe më 2 mars 1444, bashkoi rreth vetes në Kuvendin e Arbërit të gjithë princat shqiptarë në luftë kundër pushtuesve osmanë. Nën drejtimin e tij u zhvilluan 25 beteja, 19 prej të cilave në trevën dibrane[3]. Gjatë mbretërimit të tij, Shqipëria njohu përparimin, fitoren dhe lirinë e mungur ndër shekuj. Origjinën e Kastriotëve nga treva e Dibrës dhe posaçërisht nga krahina e Çidhnës e mbështesin disa burime historike, letrare, arkivore[4].Sipas studiuesit të njohur dibran Ali Hoxha edhe beteja e Torviollit,është zhvilluar në Çidhën[5] ku "sipas traditës popullore dhe në bazë të njoftimeve historike ka qenë banimi i Kastriotëve dhe vendlindja e Skënderbeut[6]. Edhe revista "Albania", shkruan se "Skënderbeu ka lindur në Sinë, në një krahinë të vogël të Çidhnës së Poshtme[7]. Mendohet të ketë lindur më 6 maj 1405 në lagjen Shgjerdh të Sinës së Poshtme [8]. Babain e Skënderbeut, Raffael Volaterrani e quan Gjon Dibra ose Gjon Dibrani[9].

Lufta për mbrojten e Arbërisë nga invazioni osman e kishte shkëputur Heroin nga detyrimi për të krijuar familje. Vitet kalonin, ndërkohë princi i arbëreshëve mungonte. Pas triumfit ndaj forcave turke të Ali Pashës, "banorëve të vënd dhe princët fqinje fare fisi që e kishin lëmsh në zemër se një burrë aqë i dëgjuar po i kalonte gjithë vitet e moshës pa ndonjë filiz e pa fëmijë, (sepse ai ai ish atëherë dyzetvjeçar e, ndoshta më i madh Stefan S. Prifti) po përpiqeshin kush e kush më parë t'i fusnin në mënt idenë për t'u martuar e për të bërë fëmijë legjitimë duke iu qarë e duke i thënë se më kot i kish zgjeruar gjer atëherë kufitë e mbretërisë, më kot e kish madhëruar Epirin, në rast të atyre, të cilëve u kish siguruar për jetë të jetëvet një nder aq të madh dhe një emër e një lavdi trimërie aqë të madhe, nuk do tu siguronte gjithashtu edhe prijësin e ardhëshëm, përveç se nëse dëshironte, ndoshta që bashkë me të të vdiste e të çdukej edhe Arbëria, që bashkë me trupin e një njeriu të shuhej edhe trupi i gjithë mbretërisë. Ai duhej t'ua merrte merrte parasysh dëshirat që u vlonin në zemër njerëzvet të vet, duhej t'ua vinte veshin ankesave tërë hall të popullit, sepese sa për prijës të tjerë dhe pasardhës të huaj, ajo



gjindje s'mund ta duronte zgjedhën e askujt tjetër, ajo përbuzte çdo zot, përveç atij që do të do t'i linte ai si mishërim të trimërisë së vet dhe si trashëgimtar nga gjaku i vet Skënderbeu, i cili s'e kishte aspak përzemër një punë të tillë, sepse i kishte drejtuar me kohë mendimet e veta të larta gjetkë . I mbushur tërë shpresë e vendosmëri për gjithëçka, thuhet se në fillim i hodhi poshtë me fjalë të shumta e plot autoritet këshillat e të vetëvet që po e dëgjonin të heshtur, dhe lavdëroi, nga ana tjetër me arësyetime jo pa vënd, beqarinë, duke thënë se s'kish gjë më të rëndë për njeriun e lirë se sa sundimi i gruas, se, me t'i hyrë në shtëpi ajo kokëçarje, as trupin, as shpirtin s'do t'ia linte më të lirë, se do t'ia pengonte kështu në pjesën me të madhe zgjerimin e mbretërisë dhe suksesin në punët që i mbeteshin përpara për ti bërë. Pastaj për të mos lënë me përshtypjen se s'po merret parasysh ato dëshira aq të mëdha të njerëzvet të tij, të përbashkëta e të veçanta njëkohësisht, tha se s'kish për të refuzuar asgjë që ata do ta çmonin se do të ishte për dobi të të gjithëvet dhe për nder të mbretërisë epiriote, se do t'i vihej çdo zgjedhe që ata do të dëshironin dhe do ta gjënin me vend. Me gjithë këto ai u kërkonte që ta prisnin e t'ia falnin vetëm aq kohë sa tu hiqte armiqve nga duart zotërimin e Sfetigradit dhe të çlironte shpirtin nga ai hall i madh, sepse do të ishte shumë turp për të që të linte shokët dhe njerëzit e gjakut të vet nën zgjedhën armike dhe të bënte dasmë e të merrej me dëfrime".[10]

Për nevoja të luftës çlirimtare dhe për të forcuar pozitat e tij, Skënderbeu vendosi të martohej me Donika Arianitin, vajzën e madhe të Gjergjit. Donika ishte bërë e njohur me kohë dhe mbahej në gojë për atë bukuri fort të rrallë[11]. Ndërkohë babai i saj "Gjergj Arianiti Komneni ishte i dëgjuar si askush tjetër, për mbretërinë e tij të madhe dhe për fisnikërinë



e lashtë të fisit të tij. Kjo krushqi iu shkonte për shtat të dyja familjeve, për nga pozita që ato posedonin.Gjergj Arianiti e mirëpriti këtë martesë, por dhe Skënderbu ishte dakord për këtë fakt[12]. Skënderbeu dërgoi si lajmës Gjin Muzakën kunatin e Arianitit, ndërsa "Paja iu la në dorë Gjergj Arianitit, i cili nga prika që i dha së bijës i kënaqi të gjitha palët[13]. Donika ishte 23 vjet më e vogël se Skënderbeu, megjithatë në rendin fedal (mesjetë) martesat ishin tërësisht politike dhe mosha e dëshirat nuk luanin asnjë rol. Barleti e quan Donikën një grua të zonjë edhe për punë shtetërore. Kur Skënderbeu largohet për në Itali ia la mbretërinë në dorë gruas së vet[14]. Në gravurat e kohës Donika shfaqet si një femër simpatike, me tipare të spikatura të një zonje, por nuk dihet me saktësi roli që ajo luajti gjatë jetës bashkëshortore pranë Skënderbeut (1451-1468, 17 Janar). Andronika (Donika) Gjergj Arianiti lindi rreth vitit 1428 (po të llogarisim se kur u martua me 1451 ishte 23 vjeç). Ajo ishte ndër tetë vajzat që Gjergj Arianiti kishte me gruan e tij të parë Marie Muzakën[15]. Ashtu siç thotë edhe Barleti ajo ishte një ndër vajzat më të bukura të dyerve bujare të Shqipërisë së shekullit të XV. Ajo i përkiste një ndër familjeve më të fuqishme dhe më fisnike, duke qenë e bija e Gjergj Arianitit, njërit prej njerëzve më të shquar të fisnikërisë feudale shqiptare[16]. Martesën e Skënderbeut, Sabri Godo[17] e përshkruan kështu në librin "Skënderbeu: "Më 23 Prill 1451 Skënderbeu bëhej dhëndërr i Gjergj Arianitit. Ai u martua ne Donikën, që kishte vjet aq sa edhe këto ditë prilli, 23, ndërsa vetë ishte 46 vjeç. Në martesat shtetërore nuk luanin rol moshat e dëshirat. Ajo do të ishte një dasmë madhështore, sikur të mos mungonin tre djemtë e Arianitit, që gati u prishën me të atin për shkak të pajës. Në kontratën Muzakë Topia me pazarllëqe të rënda, Skënderbeu merrte toka në anën tjetër të Shkumbinit, para dhe ushqime të shumta. Mungonin në dasmë Dukagjinët, ndërsa Hamzai, nipi i dashur flokëverdhë rrinte i zymtë. Ai shihte të vinin nga kjo martesë një varg me djem, siç ishte zakoni i Kastriotëve



dhe të avullonin shpresat e tij për të trashëguar Principatën e Arbërisë. Por erdhi Proveditori i Përgjithshëm i Venedikut, që solli në emër të Senatit një stoli të habitshme për nusen dhe dy palë rroba të purpurta për dhëndrin, erdhën ambasadorët e Napolit, të Vatikanit dhe Raguzës dhë mëritë kaluan në harresë. Nusja e re dhe e lumtur e priti me faqet flakë burrin e saj, kalorësin e parë të Shqipërisë dhe netët e dasmës i kaluan si një vazhdim i avullt të verës, të muzikës dhe të dollive[18]. Kurorëzimi i çiftit midis Gjergjit 46 vjeçar dhe Donikës 23 vjeçare, u bë në kishën e vjetër të Manastirit të Ardenicës, i cili ndodhet 10 km në veri të Fierit. Çifti mbërriti në Manastir pas dasmës së zhvilluar në shtëpinë e nuses në Kaninë (Vlorë M.H), në 21 prill 1451. Ai shoqërohej nga Pricat shqiptarë, njerëz të famijeve të mëdha, ambasadorët e Napolit, Vatikanit, Raguzës dhe Proveditori i Përgjithshëm i Vendikut në Shqipëri. Shpura udhëtoi nëpërmjet rrugës së Muzakës në itinerarin Vlorë-Ardenicë, vetëm disa ditë pas dasmës në Kaninë. Cermoniali i kurorëzimit u bë në mesditën e datës 26 Prill 1451, i drejtuar nga Peshkopi Feliks, nën kujdestarinë e të cilit ndodheshin dy manastiret më të mëdha të Myzeqesë, ai i Apolonisë dhe i Ardenicës. Të nesërmen, Skënderbeu me Donikën u nisën drejt Krujës, ku u zhvillua dasma madhështore në shtëpinë e dhëndrit, sipas riteve të traditës shqiptare[19]. Në romanin "Kalorësi i Skënderbut" shkrimtari dibran Haki Stërmilli shkruan:

Bajmë dasmë, kem gëzim/ Se martojmë nji kryetrim. / Trimn' e madh Skënderbenë,/Që lufton për atdhenë / Qeshu, nuse, këndo fort!/ Se ke marrë nji Kastriot! / Kërce nuse me gjith' shpirt, More burrë nji petrit! / Rreze drite, nusja jonë,/Erdhe e ndriti në mes tonë / Vash' e bukur pëllumbeshë,/U ba sonte Mbretëneshë... [20]

Martesa e Skënderbeut u pagëzua në kishën e Shën Triadhës, në Manastirin e Ardenicës[21]. Pas kësaj, Skënderbeu "mori një togë luftëtarësh e bashkë me nusen e re kaloi për disa ditë duke shëtitur krahinën me kalë e duke vizituar qytetet e vendet një për një[22]. "Muajin e mjaltit" e bëri në Gramë të Dibrës (M.H), ku ndodhet një toponim që lidhet me këtë histori. Quhet "Rrafshja e Kastriotit", një lëndinë e bukur rreth 3 dynym tokë. Në Bjeshkë të Zojnave ndodhet edhe Kroi i Zojnave. Për këtë flet një legjendë që tregohet në Kastriot, pikërisht për këtë rast, kur Skënderbeu ka ardhur së bashku me të shoqen dhe ka pushuar disa ditë te shtëpia e lindjes, tek Kulla e Gjonit. Sipas legjendës, festë e Madhe është bërë ato ditë tek Kisha dhe janë zhvilluar lojëra në Fushë dhe Kodrën Kalnuer (vendbanime prehistorike). Ushqimet e asaj feste janë përgatitur aty ku sot ndodhet Ara e Vojsavës, në mes të së cilës ndodhen Gurët e Kazanave[23] (d.m.th. është bërë darkë e madhe, pasi janë përdorur shumë kazana për gatim M-H). Tre vjet pas martesës me Skënderbeun me Donikën lindi Gjoni i ri, i cili sipas traditës mori emrin e gjyshit. Pas vdekjes së tij më 17 janar 1468, Donika (Muzaka zonja Skënderbega) sic e quan Gjon Muzaka u vendos më 1468 përfundimisht në Napoli (Itali) bashkë me Gjonin 13 vjeçar, trashëgimtarin legjitim të Skënderbeut. U vendos në dy feudet që Ferdinandi i Aragonës, mbret i Napolit i kishte dhuruar Skënderbeut në vitin 1463, si kompensim i ndihmës së çmuar që i dha heroi atij. Këtu Gjoni u integrua në radhët e fisnikëve feudal vendas, duke administruar pronat e veta dhe titullin e Dukës së Shën Pjetrit të Galantinës dhuruar nga mbreti Ferdinand. U martua me Dukeshën Erina Paleologa, la 5 fëmijë: Gjergjin (e ri), Kostandinin, Peshkop i Izernias, Ferrantin, Federikon, vdekur në Valencie të Spanjës dhe Marien[24].

DASMA E ÇIFTIT META-KRYEMADHI

"Ishte 23 janari i vitit 1994, kur një djalë nga Skrapari tek stadiumi "Dinamo" do të ndizej nga puthjet e një 20-vjeçareje që kishte vite që e dashuronte. Djaloshi quhej Ilir Meta dhe ishte 27 vjeç, ndërsa vajza akoma pa mbushur

(Vijon në faqen 17)

cyan magenta yellow black

reportazh

Plani i Bardhë, fshati që pret të ringjallet me Rrugën e Arbrit



Nga **HYSEN LIKDISHA**

Sapo kalon Qafën e Buallit në Bulqizë, poshtë saj në drejtim të Tiranës, shtrihet fshati Plani i Bardhe, që bën pjesë në bashkinë e Klosit të rrethit të Matit. I ndodhur në një luginë të ngushtë mes dy vargmaleve, por me gjatësi të konsiderueshme shtrirjeje prej rreth 3 kilometrash nga Qafa e Buallit deri tek Ura e Vashës, me gjerësi gjeografike 41o28'14" në veri dhe 20o9'52" në lindje, me lartësi mbi nivelin e detit që shkon nga 400 deri 550 metra, ka kushte mjaft të përshtatshme për zhvillimin agrobujqësor dhe blegtoral të tij. Toka bujqësore e përshtatshme për kultivimin e misrit, grurit, thekrës, etj dhe të gjithë drufrutorëve përfshirë edhe fikun e hurmën dhe terreni kodrinor malor i përshtatshëm për zhvillimin e blegtorisë, ka bërë ndër vite, që banorët e tij të lidhen fort me të.

PLANI I BARDHË, NYJE E RËNDËSISHME LIDHJE MES DIBRËS DHE TIRANËS

Ndër vite Plani i Bardhë, me Urën e Vashës të ndërtuar mbi lumin e Matit me ujëra të kristalta, për pozitën e tij gjeografike ka qenë një nyje e fuqishme lidhëse mes zonës së Dibrës së Madhe dhe trevave të tjera shqiptare të Maqedonisë me Tiranën dhe Shqipërinë e Mesme. Dhjetëra shtëpi kulla karakteristike për këtë fshat dhe Hani i Alushit në afërsi të tij në Klos-Kaund, u regjistruan dhe mbetën të pashlyeshme në memorien e udhëtarëve dibranë të mesjetës, që lëviznin drejt Tiranës, Durrësit apo Krujës, nëpërmjet rrugës së Arbrit, që përshkonte këtë fshat . Kjo veç të tjerave edhe për mikpritjen që banorët e këtij fshati tregonin për këta udhëtarë, që u binte rasti të kalojnë natën në shtëpitë e tyre, veçanërisht shtegtarët e karvaneve të tregtisë së kripës. Kështu në kushte të tilla favorizuese, fshati erdhi në rritje të vazhdueshme të popullimit të tij. Lagjet e këtij fshati me shtrirje nga Qafa e Buallit drejt Tiranës si, Allushe, Alsule, Bardhi, Beta, Sufe etj, etj, të vendosura në të dyja anët e një zalli dikur me ujë të bollshëm që zbret nga Qafa e Buallit, me ujin e të cilit vaditeshin tokat dhe livadhet, nga viti në vit erdhën në rritje të vazhdueshme të numrit të banorëve të tyre.

Plani i Bardhë veç të tjerave duhet thënë se njohu një zhvillim në rritje edhe për shkak të hapjes së minierës së Bulqizës, e cila ndodhet fare pranë tij. Kjo pasi një pjesë e mirë e burrave dhe djemve në moshë pune të këtij fshati u punësuan në minierë. Kështu në mesin e viteve '80-të, fshati arriti të numërojë 330 ekonomi familjare që e siguronin bukën nga tokat e tyre prej gjithsej 163 hektarë. Por fundi i këtyre viteve, i cili përkoi me hapjen e Traverbankut të Klosit dhe rampës së kromit në Qafën e Buallit, bëri që të ndërpritet rrjedhja e lirë e ujërave nga kjo qafë, pasi hapja e galerive të thella të nëntokës bëri që uji nëpërmjet tyre të derdhet në Shëngjun të Klosit. Mungesa e ujit për vaditjen e tokave, si dhe ajo e ujit të pijshëm, përfshirë edhe mungesën e rrugës automobilistike, një qendre shëndetësore, shkollës së rrënuar, etj, sollën fillimin e jetesës së vështirë për banorët. Vitet '90-të të ndërrimit të sistemit, natyrshëm që si kudo, por veçanërisht për këtë fshat, bënë që mes dilemës së ikjes apo qëndrimit në Planin e Bardhë, për mjaft familje të fitojë kjo e dyta. Hemorragjia e braktisjes së fshatit nga banorët, në kushte të tilla nis e bëhet alarmante.

PLANI I BARDHË AKTUALISHT DHE MUNDËSIA E RINGJALLJES SË TIJ.

Në një nga ditët e dyjavorit të parë, të muajit Janar të këtij viti, kapërcejmë Qafën e Buallit dhe drejtohemi në këtë fshat, nëpërmjet trasesë së Rrugës së Arbrit, e cila kalon mes përmes këtij fshati. Edhe pse janar, në zemër të dimrit, moti është me diell dhe i ngrohtë jo si zakonisht, në një stinë të tillë. Përkundër shkëlqimit të natyrës, në fshat duket se asgjë nuk pipëtin. Fshati duket i zhytur në agoni e përgjumje. Lagje e shtëpi të braktisura dhjetëra prej të cilave të rrënuara plotësisht, veçanërisht kullat e vjetra karakteristike të këtij fshati, që edhe ashtu të rrënuara flasin shumë për të kaluarën e tij. Vetëm kur afrohemi në qendër të tij, buzë trasesë së Rrugës së Arbrit, takojmë një grua të moshuar Fatime Hasula, e cila po ruante bagëtinë.

"Mungesa e ujit të pijshëm dhe për vaditje, e bëri fshatin tonë të braktiset nga banorët. Këtu mungon çdo gjë, uji, spitali, shkolla, e çdo gjë tjetër", - thotë ajo. "Të gjithë ata që patën mundësi u larguan, kemi mbetur vetëm ne fukarenjtë që nuk kemi mundësi të largohemi. Kemi qenë dikur mbi 300 familje kemi mbetur vetëm 30." E pyetur nëse ka një mënyrë për rigjallërimin e fshatit, ajo me një buzëqeshje të lehtë edhe pse duket skeptike, thotë se "ndërtimi i nisur për Rrugën e Arbrit dhe uji i pijshëm, janë e vetmja mundësi në këtë drejtim". Ja dhe godina shkollore në qendër të fshatit njëkatëshe dhe mbuluar me eternit, duket krejt e rrënuar. Mësojmë se dikur në këtë shkollë mësonin 250 nxënës dhe jepnin mësim 22 mësues, ndërsa sot ka vetëm dhjetëra nxënës, që sot rastisi të ishin liruar herët, pasi mësuesi i vetëm i kësaj shkolle, do shkonte për të pirë kafe, në një rast vdekje.

Tek vazhdojmë të lëvizim me trasenë e Rrugës së Arbrit, takojmë Gëzim Sallakun, një ish banor i këtij fshati, i cili aktualisht banon në Durrës. Ashtu si nënë Fatimeja, që ruante bagëtitë, edhe Gëzimi, pohon se kushtet e një jete të vështirë në këtë fshat në mungesë të ujit dhe rrugës automobilistike, bënë që ai si shumë të tjerë, të zbrazet nga banorët, të cilët lëvizën drejt Tiranës dhe Durrësit.

-" Kam qenë agronom, nis dhe tregon ai. Në vitin 1986, fshati ka patur 330 familje, me mbi 1500 banorë. Lugina ku dhe shtrihet fshati jonë, ka patur 163 hektarë tokë nën ujë, ku prodhohej misri, gruri, thekra etj. Mungesa e ujit, çoi në lënien e saj djerrë dhe të kthyer kështu në livadhe pa dhënë kështu asnjë lloj prodhimi, duke e vështirësuar në mos duke e bërë të pamundur jetesën në këtë fshat. Edhe pse kemi vite që jemi larguar, nis e tregon ai, përsëri mbetemi nostalgjik e me shpresë se një ditë edhe mund të rikthehemi këtu. Tani sapo vij nga Durrësi, pasi koha po mban mirë dhe dua të shoh shtëpinë, si dhe të nis krasitjen e drufrutorëve dhe hardhive, pasi do bëjmë një pikë raki dhe vë buzën në gaz.



E vetmja shpresë e jona për tu rikthyer mbetet përfundimi i ndërtimit të Rrugës së Arbrit, e cila ka nisur prej të paktën 4 viteve, por siç dhe e shikoni ka ecur tejet ngadalë. ... Dhe nuk e di, por dëshiroj që edhe qeveria e re, ta mbajë fjalën e dhënë për ndërtimin e kësaj rruge, pasi ajo është e rëndësishme jo vetëm për fshatin tonë për t'i dhënë atij gjallërinë e jetën e dikurshme, por ajo do të nxjerrë nga varfëria të gjitha ata zona nëpër të cilat ajo kalon. Vetëm atëherë kjo luginë e bukur do rigjallërohet si dikur para viteve '90-të. Ja shikoni, sapo nisi ndërtimi i kësaj rruge, si një dallëndyshe e parë, u ndërtua edhe një shtëpi e re, në afërsi të saj, e cila pritet të pasohet nga të tjera.

Duke ju bashkangjitur mendimit dhe optimizmit të agronom Gëzimit, se e vetmja mundësi për rigjallërimin e këtij fshati mbetet ndërtimi i rrugës së Arbrit, drejtohemi në segmentin e fundit të hapjes së trasesë të kësaj rruge mbi Urën e Vashës, ku dy tre makina të rënda, si shenjë e vendosmërisë për ndërtimin e kësaj rruge, vijojnë punën. Katër punonjës dhe dy specialistë të stafit teknik të firmës ndërtuese, jo vetëm që nuk pranojnë të prononcohen për gazetën për të informuar në lidhje me ecurinë e punimeve në këtë fazë të ndërtimit të rrugës, por edhe na kërcënojnë me gjobë pasi jemi futur, sipas tyre, pa leje në një zonë rreziku.

Ndërkohë që largohemi, marrim me vete zhurmën e këtyre makinerive, si një kambanë e fuqishme sensibilizimi për rëndësinë e ndërtimit të saj, e cila lidh ekonomitë e tre rajoneve me përparësi të ndryshme natyrore dhe ekonomike si atë bregdetar, malor dhe kontinental.

Në segmentin e fundit të hapjes së trasesë të kësaj rruge mbi Urën e Vashës, dy tre makina të rënda, si shenjë e vendosmërisë për ndërtimin e kësaj rruge, vijojnë punën. Katër punonjës dhe dy specialistë të stafit teknik të firmës ndërtuese, jo vetëm që nuk pranojnë të prononcohen për gazetën për të informuar në lidhje me ecurinë e punimeve në këtë fazë të ndërtimit të rrugës, por edhe na kërcënojnë me gjobë pasi jemi futur, sipas tyre, pa leje në një zonë rreziku.

cyan magenta yellow black 13

Rruga e Arbërit nr. 93

debat

SHËNIM I REDAKSISË: Prof.as.dr. Hyqmet Gonxhja, në shkrimin e këtij numri ngre problemin e unifikimit të shoqatave dibrane, jo vetëm në shkrirjen e tyre në një të vetme, por edhe në reflektimin e saj në më shumë veprimtari për të mirën e komunitetit. Problemet që trajton në shkrim autori janë të debatueshme, kështu që redaksia fton të interesuarit për një debat të hapur mbi këtë temë.

Për një **shoqatë të vetme** kulturore – atdhetare mbarëdibrane

Nga **Prof.asoc.dr. HYQMET GONXHJA**

Qëllimi i këtij artikulli nuk synon që t'i bëje radiografinë e plotë gjendjes apatike dhe dobësive alarmante që karakterizon prej vitesh funksionimin jo normal të "shoqatave'' dhe "shoqatëzave'' të ndryshme ekzistuese dibrane (legale apo të pa licencuara).

Sikurse dihet, këto shoqata e ushtrojnë veprimtarinë (gjithsesi të papërfillshme) sipas parimit: "Me mirë me pak se asgjë", nën siglën e etiketave krahinore, profesionale etj.

Është për të ardhur keq se këto aktivitete po i realizojnë duke abuzuar me faktin se kinse përfaqësojnë " komunitetin dibran" ose pjesë të tij. Dashur padashur, ato i kanë faturuar imazhit të kësaj bashkësie, një dëm të konsiderueshëm. Në këtë shkrim dëshiroj të vë theksin kryesisht të problemi se cilat janë rrugët dhe masat më efektive për të bërë një kthesë historike në veprimtarinë shumëplanëshe dhe gjithëpërfshirëse që aspiron dhe meriton shoqëria dibrane në drejtim të informimit, edukimit të shumëllojshëm dhe për sensibilizimin e saj maksimal në rrafshin etno-kulturor, atdhetar, shoqëror, madje edhe në atë të solidaritetit human.

Kësaj kërkese dhe këtij misioni fisnik nuk duhet t'i shmanget asnjë dibran, pavarësisht nga shkalla e arsimimit, gjinisë, përkatësisë krahinore, fetare, politike etj. Nuk ka dy, pesë apo dhjetë Dibra, por ekziston vetëm një Dibër, që falë Zotit, ka një bashkësi me potencial të fuqishëm njerëzor dhe intelektual. E kemi për nder që jemi trashëgimtarët e atyre të parëve tanë që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme për të zënë merituesheëm vendin që u takon në Panteonin e lavdisë së Kombit tonë.

Dibra përfaqëson një ndër trevat më të shquara të kombit shqiptar sepse në bilancin e saj historik vetëm nga shek. XV e deri në fund të vitit 1921, në këtë trevë janë zhvilluar mbi 12 kryengritje të armatosura e të dokumentuara kundër hordhive osmane, sllavo-serbe; sllavo-bullgare. Në Dibrën tonë janë mbledhur 13 kuvende e kongrese mbarë dibrane e kombëtare, ku përfaqësuesit e 9 maleve të Dibrës, kanë lidhur "besa-besën" sa herë që ka qenë nevoja për të mbrojtur çdo pëllëmbë toke të trojeve tona etnike dhe të drejtat e tyre kombëtare e njerëzore qoftë edhe duke derdhur gjakun e duke u djegur e rrënuar për mbijetesë. Për sakrificat mbinjerëzore që kanë bërë të parët tanë u jemi borxhli që të gjithë, i është borxhli çdo qeveri e shtetit tonë, për të nderuar veprën e tyre madhore me përmendore, me obeliske e pllaka përkujtimore me libra historike e letrare etj.

Ne jemi krenarë sepse ishim të privilegjuar nga i madhi Zot, që nxori nga gjiri i popullit dibran një Strateg vigan siç ishte Gjergj Kastrioti Skënderbeu më i madhi i epokës së Mesjetës, që me 22 betejat e tij fitimtare gjatë një periudhe 25 vjeçare – arriti që të frenonte turrin e ushtrive të Perandorisë Osmane – më të fuqishmen e asaj epoke. Ishte pikërisht kjo rezistencë skenderbeiane që i dha mundësinë Europës Perëndimore për t'u fuqizuar dhe përballuar agresionin osman.

Dibra jonë e dashur i dha kombit shqiptar Iljaz pashë Dibrën (Qoku), kryetar i "Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" (1878), Dom Nikoll Kaçorrin, përfaqësuesin arqipeshkv të Vatikanit në Shqipëri dhe zev.kryetar të qeverisë së Vlorës (1912), Haxhi Vehbi Dibrën (Agolli) – kryetar i Senatit të Pleqërise në Parlamentin e qeverisjes së Ismail Qemalit (1912), Riza Tefik Dibrani, filozof, shkrimtar, politikan etj.

Dibra jonë i dha kombit shqiptar, më shumë se çdo trevë tjetër, mbi 30 prijësa popullorë që në kryengritjet e ndryshme u dalluan jo vetëm për zgjuarsinë dhe popullaritetin, por edhe për cilësitë që kishin si strategë të cilët populli me të drejtë iu thuri këngë duke i quajtur "kapidanë" dhe "gjeneralë me tirqe". Dibra i dha kombit tonë "Kanunin e Skënderbeut" dhe "Kanunin e 9 maleve".

Dibra u shqua edhe për shumë pleq të famshëm për "qokat" dhe frazeologjinë e tyre të mençur. Ajo nxorri një dyzinë teologësh disa prej të cilëve për shumë vitë kryesuan komunitetin mysliman dhe katolik. Dibra nuk ka mbetur pas edhe bnë drejtime të tjera sikurse janë kontributet në fushën e historisë, letërsisë, arteve, ekonomisë, shkencës dhe teknikës në fushën e sporteve, mbrojtjes etj, etj.



Foto gjatë festimit të 20 vjetorit të themelimit të shoqatës "Bashkesia Dibrane"

Dibra i dha luftrave antiosmane, antisllave dhe antifashiste me qindra dëshmorë, dhe 5 "Heronj të popullit. Edhe në periudhën e monarkisë dibranët shkëlqyen në fushën e administratës shtetërore, si politikanë, si ministra dhe si deputetë. Të tillë ishin Zija Dibra, Fuat Dibra, Jashar Erebara, senatorë Xhemal Dibra, ministrat Abdurahman Dibra dhe Faik Shatku, deputete Fiqiri Rusi etj.

Në radhët e ushtrisë sonë kombëtare dhe armës së Policisë së Shtetit, kanë dhënë kontributin e tyre 7 gjeneralë e dhjetëra oficerë madhorë.

Deri më sot, realizimi i një prej kërkesave thelbësore që përmbajnë dhe statutet e shoqatave kulturore sikurse është ajo e sensibilizimit dhe informimit masiv të bashkësisë tonë në rrafshe të ndryshme përfshi edhe kontributet në vazhdimësi të intelektualëve dhe mjeshtrave dibranë në specialitetet që mbulojnë – ka mbetur në nivelet më të ulta. Po të flasim me gjuhën e shifrave, ky sensibilizim kaq i trumpetuar, ka përfshi vetëm 1% të bashkësisë dibrane që i takon Tiranës, ndërsa në qytetin e Peshkopisë dhe në komunën e Dibrës së Madhe, ky sensibilizim ka qenë në përmasa relativisht të kënaqshme.

Në këtë drejtim, shembullin më negativ nga të gjitha shoqatat që veprojnë në metropolin shqiptar vazhdon ta japë Shoqata e Bashkësisë Dibrane. Me të gjithë zellin dhe përkushtimin e treguar nga kryesitë e radhës të kësaj shoqate, gjatë një periudhe 21 vjeçare, ajo ka zhvilluar rreth 30 konferenca me rreth 50 kumtesa me tematikë të ndryshme, ka kryer 2-3 vizita (pjesëmarrje) në simpoziumet e organizuar nga "Shoqata Votra Dibrane" e Dibrës së Madhe. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë, mesatarisht, për çdo vit, rreth 120 veta, që përbëjnë vetëm 0,3-0,5 % të komunitetit dibran prej rreth 20 mijë familjesh që jetojnë në qytetin e Tiranës dhe në rrethinat e tij. Me këtë veprimtari të varfër, të papërfillshme dhe të njëtrajtshme (vetëm me konferenca), pa përdorur mjetet e komunikimit masiv (radio-televizionin, gazetën, almanake, Buletine dhe koncerte masive argëtuese masive të tipit "Sofra Dibrane", minimum njëherë në vit) – as që mund të bëhet fjalë se ky aktivitet i kryer nga SH.B.D (e vetme apo në bashkëpunim të rrallë me "Shoqatën e Intelektualëve Dibranë) ia ka arritur qëllimit të sensibilizimit të bashkësisë dibrane. Kam krijuar bindjen se, veprimtaritë e kryera nga shoqatat e ndryshme kulturore dibrane, duke veçuar deri diku atë të Intelektualëve Dibranë që kanë pasur më tepër sukses, janë llogaritur për të pasur vetëm jehonë mediatike, sesa një punë efektive në përputhje me kërkesat e Program – Statuteve përkatëse.

Faktori "decentralizim", dhe egot e xhelozitë me natyrë të ndryshme, vazhdojnë të pengojnë shkrirjen e plotë të shoqatave e shoqatëzave të ndryshme në një shoqatë të vetme mbarë dibrane me qendër në Tiranë e cila të udhëhiqej nga një Program – Statut i përbashkët, ku të paracaktohen qartë e saktë: Objektivat, mjetet dhe masat propagandistike, kriteret e anëtarësimit, dispozitat me karakter organizativ (forumet drejtuese, procedura e zgjedhjeve, të drejtat e detyrat, kohëzgjatja e mandateve, burimet financiare, etj).

Veprimtaritë tepër të kufizuara të shoqatave ekzistuese dibrane pothuajse pa asnjë ndikim në masën e gjerë të komunitetit mbarë dibran – shpjegohen dhe nga injorimi i dy faktorëve të tjerë përcaktues në suksesin ose mos suksesin e shoqatave të lartpërmendura.

Të tillë janë: mungesa e fondeve të sigurta financiare që garantojnë një pjesë të konsiderueshme të vetëfinancimit mbi bazën e të ardhurave nga kuotizacione të arsyeshme po të detyrueshme të anëtarësisë si dhe mungesa e strukturimit organizativ në të gjitha nivelet e "piramidës" së "Sh.M.D".

N.q.s do të pranohet propozimi që "Sh.M.D" të ketë një strukturë të përbërë prej Asamblesë (ose Kuvendit) gjithë përfshirëse mbarë dibrane prej 501-601 anëtarësh cilësorë, Kryesisë qendrore dhe Këshillit Drejtues pranë saj, Degët dhe seksionet në të gjithë rrethet ku ka prani të komunitetit dibran (Tiranë, Peshkopi, Durrës, Krujë, Burrel, Kurbin dhe në Dibër të Madhe) atëherë, me siguri do të ndjehesh forca ndikuese dhe shumë rezultative e Sh.M.D, në rrafshin propagandistik me rezonancë shumë herë më të fuqishme në mbarë komunitetin tonë. Një strukturë e tillë organizative do të krijonte premisat për të siguruar të ardhura financiare – aq të nevojshme për realizimin e shumë aktiviteteve të larmishme në të gjitha rrethet e lartpërmendura.

Një pyetje e thjeshtë, por parimore, do të ishte me siguri kjo: Cili do të ishte kufiri i kuatizacioneve? Lidhur me këtë pyetje do të propozoja që për të gjithë anëtarët e forumeve të strukturës organizative të Sh.M.D, kuotizacioni mujor të ishte i barabartë me 100 lekë kurse për k/familjarët dibranë të anëtarësuar me libreza, kuotizacioni i vjetër të ishte baraz me 100 lekë, dmth 2 caje në vit (duke përjashtuar k/familjarët tepër të varfër të dokumentuar si të tillë).

Po t'u shtohen këtyre të ardhurave financiare dhe ato të ardhura të adresuara vullnetarisht nëpërmjet llogarisë bankare përkatëse ose drejtpërdrejtë në pikat e caktuara të degëve dhe seksioneve të Sh.M.D – atëherë këto të ardhura të administruara me transparencën e duhur dhe sipas standardeve të rrepta financiare, do të mjaftonin për të siguruar një gamë të gjerë veprimtarish, sikurse do të ishin:

- Zhvillimi i tre-katër konferencave me tematika të ndryshme për cdo vit nga të gjitha degët e Sh.M.D;
- Botimi i gazetës së përmuajshme, ndoshta me emrin "Besa Dibrane";
- Botimi i një almanaku të përvitshëm, me përmbajtje të ndryshme tematike.
- Zhvillimi i të paktën 3-4 emisioneve televizive për cdo vit me tematikë nga ngjarjet historike më të rëndësishme që lidhen me Dibrën dhe personalitetet e saja të shquara në fusha të ndryshme;
- Zhvillimi i një koncerti argëtues dhe folklorik të "Odës Dibrane" në Pallatin e Sporteve ose gjetkë, të dielën e parë të muajit qershor të ëdo viti në bashkëpunim me Bashkinë e Peshkopisë, Komunën e Dibrës së Madhe, Bashkinë e Kamzës, Bashkinë e Tiranës, Bashkinë e Burrelit etj.
- Organizimi i promovimeve të librave dhe veprave të autorëve dibranë;

Kësaj kërkese dhe këtij misioni fisnik nuk duhet t'i shmanget asnjë dibran, pavarësisht nga shkalla e arsimimit, gjinisë, përkatësisë krahinore, fetare, politike etj. Nuk ka dy, pesë apo dhjetë Dibra, por ekziston vetëm një Dibër, që falë Zotit, ka një bashkësi me potencial të fuqishëm njerëzor dhe intelektual. E kemi për nder që jemi trashëgimtarët e atyre të parëve tanë që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme për të zënë merituesheëm vendin që u takon në Panteonin e lavdisë së Kombit tonë.

- Organizimi nga degët e Sh.M.D i ceremonive të ditëlindjeve të personaliteteve të shquara dhe veprimtarëve më të shquar dibranë në rrethin përkatës;
- Përfaqësues të kryesisë qëndrore dhe të degëve e të seksioneve, sipas rastit, të bëjnë homazhet në emër të Sh.M.D në rastin e ceremonive mortore për familjarët dibranë që ndërrojnë jetë;
- Dhënia e dhuratave simbolike për nxënësit dhe mjeshtrat e talentuar dibranë në fusha të ndryshme;
- Dhënia e ndihmave simbolike financiare ose materiale-familjeve tepër të varfëra të dokumentuar si të tilla.

Përveç këtyre aktiviteteve, sipas rastit të dhënë, përfaqësuesit e kryesisë qendrore dhe të degëve të sajë, duhet të angazhohen fuqimisht, brenda ligjeve dh mundësive , për të luftuar për të drejtat dhe ankesat e pjesëtarëve të komunitetit dibran, si edhe të lobojnë pranë organeve përkatëse shtetërore dhe deputetëve dibranë (pa dallime partiake) për investime që i përkasin infrastrukturës, të veprave ekonomike, turizmit, shëndetësisë, arsimit, art-kulturës, sportit etj etj.

Mendoj se, lidhur me propozimet që trajtohen në këtë shkrim, kryesitë e shoqatave ekzistuese duhet të reflektojnë dhe të gjejnë gjuhën e mirëkuptimit me njëri-tjetrin për të vendosur shkrirjen dhe zëvendësimin e tyre me "Shoqatën Mbarë-Dibrane-Gjergj Kastrioti". Në mos qofshin dakord këto kryesi (që s'ma merr mendja), atëherë s'mbetet rrugë tjetër, veçse kjo nismë të merret nga një grup intelektualësh cilësorë, ndoshta prej 50 vetësh për të thirrur mbledhjen e parë konsultative, mundësisht brenda muajit shkurt 2014, në të cilin të diskutohet e të miratohet me shtesat dhe saktësimet përkatëse.

Projekt – Programin dhe Projekt – Statutin e "Sh.M.D" (ku një variant të tij e ka përgatitur autori i këtij shkrimi).

Në mbledhjen e mësipërme ose në një mbledhje tjetër të posaçme mendoj se duhet të diskutohet e miratohet edhe plani paraprak i masave urgjente me karakter organizativ në afatet kur do të kryhen dhe kush do t'i realizojë ato.

Ka shumë rëndësi që në mbledhjen e parë, por sidomos në mbledhjen e dytë, të ftohen 7-8 biznesmenë me peshë, pa dallime partiake, që kanë dëshirën dhe vullnetin e mirë për të qenë mbështetës të kësaj nisme, thjeshtë si qytetarë të nderuar dibranë. Për të ngritur një shoqatë të përmasave mbarë dibrane, nuk është detyrë e lehtë. Kjo nismë që propozohet, kërkon në radhë të parë përkushtim, shpirt, sakrifica dhe aftësi organizative. Sigurisht, ajo kërkon edhe një farë periudhe kohore, përgatitore, ndoshta deri dy vjeçare.

Fillimisht, do të ishte e këshillueshme që kjo nismë, të niste, duke marrë si projekt – pilot, kryeqytetin dhe rrethinën e tij. Shembulli dhe rezultatet pozitive që do të arrihen në rrethin e Tiranës do të nxisnin edhe Komunitetet Dibrane të rretheve të tjera që t'i bashkangjiten "Sh.M.D" dhe ta bëjnë shoqatën tonë një shembull mjaft domethënës për të gjithë shoqatat si motra në të gjithë Shqipërinë dhe më gjerë.

studim

Hilmi Kolgjegja është një nga personalitetet më të shquara të kulturës sonë kombëtare

Kërkuesi i perlave

Nga **XHAFER MARTINI**

Hilmi Kolgjegja është një nga personalitetet më të shquara të kulturës sonë kombëtare. Ai ka kontribuar veçanërisht në mbledhjen e visareve të popullit tonë. Ndonëse i lindur dhe i rritur në Dibër (Lurë), krijimtaria e tij dhe studimet e tij shumë interesante patën një rrezatim mbarëkombëtar. Ai punoi shumë dhe në heshtje, pa ndihmën e askujt dhe në kushte të vështira ekonomike. Shkrimtari Xhafer Martini i është futur prej kohësh punës për të shkruar një monografi për Hilmi Kolgjegjën, një monografi e paautorizuar, pa shtysën e nxitjen e askujt, nisur vetëm nga qëllimi i lartë që ta bëjë të njohur një intelektual me shumë merita. Autori ka shpresë se do të dalin njerëz bujarë dhe artdashës që do të ndihmojnë për botimin e këtij libri. Më poshtë po botojmë një fragment ku shkruhet për kontributin e Hilmi Kolgjegjës për alegorinë.

MJESHTRI I ALEGORISË

Një nga librat më të rëndësishëm të Hilmi Kolgjegjës është ai me titull "Perlat shqiptare" (Hilmi Kolgjegja "Perlat shqiptare", red. Xh. Abazi, Tiranë, Toena, 1999). Pjesa më e bukur e tij është alegoria. Hilmi Kolgjegja ka qenë një mbledhës i ndërgjegjshëm dhe i pasionuar i folklorit. Ai ishte njeriu me formimin e nevojshëm për ta bërë një gjë të tillë. Hilmiu ka lindur në Lurë, një popull me tradita dhe kulturë të lashtë, me banorë krenarë dhe me sedër, të rritur në një mjedis të ashpër, por edhe nga më poetikët, ku natyra ka derdhur tërë lirizmin dhe poezinë. Hilmiu ishte nip në Çidhën, në Fushë Alie, zemra e alegorisë dhe e një kulture të shëndoshë tradicionale. Hilmiu vinte shpesh tek dajat dhe u mëkua qysh në fëmijëri me kulturat e dy trevave shumë të pasura.

Hilmiu ka qenë, për nga karakteri, tip alegorik. Ai pothuaj nuk fliste kurrë pa figura, pa alegori. Por alegoria e tij ishte e këndshme, jo keqdashëse, jo prej atij lloji që lëndonte dhe fyente njerëz. Ka edhe prej kësaj alegorie të ëmbël, të lehtë, të bukur, që i flladit zemrat njerëzore, që vë në lëvizje mendjen, që shkakton humor dhe të qeshura, por nuk prek askënd në ato vede të ndjeshme ku nuk duhet t'i prekësh. Kjo lloj alegorie ka një përngjasim të lehtë me anekdotën, por nuk është e tillë, mbasi deshifrimi i saj është më i vështirë, e qeshura që buron prej saj është më e përmbajtur dhe jo e bujshme si tek anekdota dhe, mbi të gjitha, ajo nuk thuhet në rrugë dhe kudo, por në mjedise më të përshtatshme dhe më komode. Anekdota është më e lehë si zhanër dhe shumë më e përdorshme për vetë specifikat që ka. Anekdota merr vlerë alegorike, por për këtë duhet t'i nënshtrohet përpunimit të thellë në bazë të ligjësive që ka alegoria. Ajo do që të krijohet shtrati alegorik, pra, me pak fjalë, duhet të vihet në ato kushte në të cilat jeton alegoria dhe t'u përmbahet po atyre ligjësive që prodhojnë alegorinë.

Kontributi i Hilmi Kolgjegjës në zhvillimin dhe pasurimin e alegorisë është i trefishtë.

Së pari, Hilmiu është përdorues i shkëlqyer i alegorisë, ai është një nga interpretuesit më të mirë të saj, deshifrues dhe bartës, tregues dhe krijues i saj në përshtatje me mjediset dhe rrethanat. Në procesin e bisedës në oda jo gjithmonë kur të sulmojnë me alegori, të ndodhet e gatshme alegoria me të cilën duhet të përgjigjesh. Ka raste që edhe bartës të shquar mbeten në baltë dhe bëhen batall, siç thuhet. Përveç se bartës alegorish, me thesin plot, siç thoshte Mane Kacani, duhet të jesh edhe improvizues, t'i krijosh ato aty për aty, t'u japësh kuptim alegorik ngjarjeve të jetuara ose të sajosh ngjarje të reja, shkurt, të të pjellë mendja në çast një ndodhi për t'u përgjigjur. Përveç cilësisë krijuese, duhe të kesh një kulturë të madhe, duhet të kesh lexuar shumë, të kesh magazinuar në tru qidra skena, dialogje, episode, duhet të dish qindra vargje përmendësh, sepse të gjitha këto, në sajë të interpretimit, përpunimit të shpejtë dhe të lehtë, përshtatjes, ta krijojnë mundësië që të përgjigjesh me alegori. Hilmiu ishte një thesar i madh, një minierë e pashterrshme. Qoftë edhe në një bisedë të shkurtër, kur kushtet nuk ishin të përshtatshme, ai përgjigjej me alegori, me replika të shkurtëra, me thënie të mençura që linin gjurmë te bashkëbiseduesi dhe e bënin atë të qeshte. Hilmiu t'i lë dhëmbët jashtë, thuhej për të, se nuk kishte rreth sado të vogël shoqëror që, kur mblidhej, nuk e donte Hilmiun në mes; e donte në daç për gojëtarinë e shquar, në daç për këngët dhe çiftelinë, në daç për vallen dhe harmoninë që sillte. Në këtë atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, Hilmiu shkëlqente me mençurinë dhe diturinë e tij. Nuk bënte asgjë për t'u dukur, thjeshtësia e tij ishte e habitshme, organike, si frymëmarrja, egoizmi i tij ishte zero. i donte shumë shokët dhe qëllimi i tij ishte t'i kënaqte, t'i argëtonte. Ai, fjala vjen, mbante mend përmendësh dhe mund të recitonte qindra vargje nga Fishta. Epo, qenka ithtar i Fishtës, mund të mendoje. Por jo. Mbas pak ai mund të recitonte po kaq vargje nga Martin Camaj, nga Naimi për të dalë pastaj tek Pushkini, Uitmani; ai tregonte shkëlqyeshëm dhjetra episode nga jeta e njerëzve të mëdhenj, si: Balzaku, Napoleoni, Shekspiri, Xhek Londoni, Abraham Linkolni, Niçe, Martin Luter King etj., etj. Në atë kohë të mbajturit mend të vargjeve e shikonim si një veti të njerëzve që mësojnë në mënyrë mekanike. Shkurt, këtë dhunti të çmuar e shikonim si mangësi, si zbrazësi në formimin kulturor të përgjithshëm. Por ka shumë kohë që, të paktën unë, të mësuarit përmendësh të Hilmiut e shikoj si pjesë të formimit të tij kulturor, një kulturë e ngulitur, e fituar me shumë punë dhe me shumë lexime, një kulturë në lëvizje, me mundësi manovrimi, që të nxjerr nga situata e vështirë. Unë pak i besoj kulturës së atyre njerëzve që pa hapur librat, pa shfletuar skedat, pa hapur fjalorët, nuk janë në gjendje të përgjigjen për asgjë. Për Hilmiun kjo ishte një kulturë jo vetëm e ngulitur, por disi e veçuar, e evidentuar, e vënë në gatishmëri për t'u përdorur për raste emergjente, jo vetëm për ta pasur të gatshme në tryeza, mes shokësh dhe miqsh, por edhe për të përballuar sfida. Nuk mund t'ia arrish kësaj pa ditur shumë, pa lexuar shumë. Për t'u bindur për këtë hidhni një sy vetëm bibliografisë së përdorur për të shkruar librin "Perlat shqiptare". Janë shfrytëzuar plot dyzet e pesë autorë, me veprat e tyre kryesore, kryesisht autorë të huaj, por edhe shqiptarë, me rreth pesëmbëdhjetë mijë faqe, që Hilmiu i lexonte për një muaj. Një ndihmë të madhe për t'ia arritur asaj që dëshironte, Hilmiut ia jepte prirja për të zbuluar dukuri analogjike, sipas atij ligji që krahason dhe pranëvë, në kushte dhe rrethana të caktuara, objekte, dukuri, gjendje shpirtërore dhe morale, që, në mos qofshin të ngjashme, hedhin dritë mbi njera-tjetrën. Krahas aftësisë improvizuese, krijuese, Hilmiu kishte edhe aftësinë e përzgjedhjes dhe të përshtatjes të çdo materiali për t'i dhënë vlerë alegorike. A dinte qindra anekdota dhe këto janë lënda më e mirë për alegorinë kur nuk ke të mirëfillta. Nga ana tjetër, edhe vetë alegoritë janë polivalente, dhe si të tilla, marrin shumë kuptime, por narratori duhet të jetë i aftë që t'i vejë në kushte dhe rrethana të reja, t'i aktualizojë. Hilmi Kolgjegja e kishte në lartësi të paarritshme këtë cilësi. Ai ishte hazërxhevap, si thuhet. Kur goditej nga dikush me alegori nuk kalonte minuti pa iu përgjigjur, ndaç me të ëmbëla në daç me të tharta, sipas meritës. Gojtaria e Hilmiut ishte emocionuese edhe në një aspekt tjetër. Ai ishte mësues dhe, natyrisht, në shkollë dhe sidomos në klasë, fliste gjuhën normative, gjuhën letrare, të cilën, për çudi, si rrallë gegnishtfolës, e zotëronte shkëlqyeshëm. Por në mjediset shoqërore ai fliste në dialekt, në një dalekt, si të thuash, origjinal, midis atij të dibranishtes dhe të Lurës, duke i kombinuar këto dhe duke u dhënë përparësi trajtave më përfaqësuese që kishin tendencë të ngriheshin në normë. Kur e pyesnin për një gjë të tillë, thoshte se vetë arti me të cilin merrej, alegoria dhe folklori në përgjithësi, nuk mund të artikuloheshin në një gjuhë standarte se ajo sikur i ndrydh dhe i tjetërson.Pastaj kalonte tek teoria e përkthimit dhe jepte dhjetra shembuj nga kultura dhe përkthimet shqiptare duke dashur të theksonte veprat më të arritshme që shqipja i jepte shumë bukur. Ec e përktheje, po deshe, Ferrin e Dantes në toskërisht, merrte hov Hilmiu, dhe të njejtat argumente sillte edhe për vështirësitë e përkthimit të veprave të Homerit në gjuhën standarte. Hilmiu kishte edhe një kujtesë të mrekullueshme. Hilmiu jo vetëm jepte informacion, por edhe i shtjellonte bukur mendimet dhe kishte një të arsyetuar shumë logjik.

Së dyti, Hilmi Kolgjegja, siç e thamë, është mbledhës i shquar i alegorisë. Ai ka mbledhur aq shumë alegori sa është e pamundur t'i numërosh. Këtu unë fus jo vetëm këto pak që ka në librin "Perlat shqiptare", të cilat do tii analizoj edhe për nga risia që sjellin, por edhe dhjetra të tjera si brenda këtij libri, shpërndarë nëpër kapituj të tjerë, ashtu edhe në librat e tjerë, sidomos në librin voluminoz "Folklor nga Dibra". Por të gjitha këto janë vetëm maja e ajsbergut. Me dhjetra dhe qindra faqe me material nga të gjitha zhanret e folklorit, midis tyre edhe alegori, Hilmiu dërgonte çdo vit, dhjetra vjet me radhë, në Institutin e Kulturës Popullore. Po të kesh parasysh edhe këtë kontribut, Hilmiut i bëhet një mal me kulturë popullore të shkruar. Të gjitha alegoritë dhe materialet e tjera Hilmiu i ka mbledhur vetë, i ka shkruar vetë dhe duhet thënë se i ka shkruar me shumë cilësi sa është e pamundur të vesh dorë mbi to, nëse nuk do t'i prishësh. Hilmi Kolgjegja është një "furnizues" i madh i të gjithë studiuesve të etnokulturës jo vetëm me alegori, por me të gjitha llojet dhe gjinitë e folklorit dhe të letërsisë. Janë disa norma morale kanunore që sajohen duke u mbështetur në gjini dhe lloje të ndryshme të prodhimtarisë popullore. Një prej thënieve më lapidare, fryt i përvojave të gjata popullore, është edhe kjo: "Mos bëj mik qeverinë". Kjo thënie buron nga një fragment përralle me titull "Hisen Selmani", mbledhur nga Hilmi Kolgjegja. Fragmentin e mëposhtëm po e jap me mënyrën se si e shkrova unë për të prodhuar normën kanuore: "Mos bëj mik qeverinë!":

"Hisen Selmani ishte një fshatar i vorfën. Ai pajtohet çoban e ruen gjanë e katundit me pa ndonjë hall. Nji mbramje vonë, rrugës për në shtëpi, gjen një pupël zogu që lëshonte dritë. E merr puplën dhe ia çon nanës së vet e ajo mendon me fitue ndonji pare prej asaj mrekullie që kishte gjetun i biri. Po Hisen Selmani i thotë nanës:

- Oj nanë, këtë pupël kam me ia çue mbretit.

- Jo, bir,- e këshillon nana, - se nuk do të të vijë ndonji gja e mirë nga mbreti.

- Në mos më ardhtë noj e mirë, e keqja nuk ka pse të më vijë, - tha djali dhe niset për te mbreti.

Rojet e mbretit e lanë Hisen Selmanin të lirë me hi në pallat. Ky, i gëzue se po i ecnin punët mbarë, i vuni mbretit para puplën që bante dritë. Mbreti e shikoi puplën i habitun dhe ra në mendime nji copë herë të mirë.

- Ti duhet të më biesh zogun nga e ke marrë këtë pupël, - i tha ai.

- Zogun nuk e di, unë vetëm këtë pupël kam gjetun, - i tha Hisen Selmani.

- Pupla e zogut asht. Po qe se nuk më bie ene zogun, do të rrish në burg, - i tha mbreti dhe u dha rojeve urdhën ta burgosnin". (Xhafer Martini: "Kanun", Tiranë 2013, f. 395)

Hilmi Kolgjegja është mbledhës i shquar i alegorisë. Ai ka mbledhur aq shumë alegori sa është e pamundur t'i numërosh. Këtu unë fus jo vetëm këto pak që ka në librin "Perlat shqiptare", por edhe dhjetra të tjera si brenda këtij libri, shpërndarë nëpër kapituj të tjerë, ashtu edhe në librat e tjerë, sidomos në librin voluminoz "Folklor nga Dibra".

Hilmi Kolgjegja është studiues i alegorisë. Ndonëse me shkrime të shkurtëra, ai ka kontribuar për ndriçimin e anëve të ndryshme të saj. Hilmiu herë pas here ka pas kumtuar në sesione shkencore dhe ka botuar nëpër almanakë letrarë të Dibrës probleme që lidhen me alegorinë

Hilmi Kolgjegja ka qenë një mbledhës i ndërgjegjshëm dhe i pasionuar i folklorit. Ai ishte njeriu me formimin e nevojshëm për ta bërë një gjë të tillë.

Hilmiu është përdorues i shkëlqyer i alegorisë, ai është një nga interpretuesit më të mirë të saj, deshifrues dhe bartës, tregues dhe krijues i saj në përshtatje me mjediset dhe rrethanat. Në procesin e bisedës në oda jo gjithmonë kur të sulmojnë me alegori, të ndodhet e gatshme alegoria me të cilën duhet të përgjigjesh.

Unë i jam drejtuar edhe herë të tjera krijimtarisë së Hilmi Kolgjegjës për nevoja shkencore. Dy-tri krijime të mbledhura nga Hilmu, që premtonin për t'u bërë tregime të mirëfillta, me lejen e tij, i kam zhvilluar mbi kritere të reja estetike dhe me pretendime të reja artistike dhe i kam botuar tek "Fjala priu" e "Dasma me treqind nuse". Por ka të tjerë që kanë marrë nga Hilmiu sa kanë dashur e si kanë dashur, pa i marrë asnjë mendim dhe, për fat të keq, i kanë shkruar shumë dobët. Kanë prishur një formë të përsosur artistike për të treguar gjoja se janë "origjinalë", se edhe ato i kanë mbledhur nga populli. Hile të trasha! Por Hilmiu jo tani që ka vdekur, por edhe kur ishte i gjallë, nuk ka bërë pazar dhe nuk ka përdorur kandar me ta. Ai, si ai kopshtari i mirë, që e ka bahçen plot me mollë, nuk le kënd t'i thahet goja, por kushdo që kalon andej, i thotë: merr, bir, po veç mos thyej degët se do të hamë prapë vitin tjetër!".

Së treti, Hilmi Kolgjegja është studiues i alegorisë. Ndonëse me shkrime të shkurtëra, ai ka kontribuar për ndriçimin e anëve të ndryshme të saj. Hilmiu herë pas here ka pas kumtuar në sesione shkencore dhe ka botuar nëpër almanakë letrarë të Dibrës probleme që lidhen me alegorinë. Por kontributin më të madh ai e ka dhënë në mënyrë të pavetëdijshme duke mbledhur atë lloj alegorie që është disi e veçantë duke u dhënë kështu mundësi studiuesve për të arritur në përfundime të reja për zhvillimin e këtij arti. Kur përfundova librin tim studimor "Perlat e Dibrës", në kapitullin e fundit me titull : "Zhanër në gjallëri apo në ngrirje", unë shprehja besimin se alegoria nuk është një zhanër jetëshkurtër, se alegoria nuk e kishte përfunduar misionin e saj dhe kurrë nuk ka për ta përfunduar. Kjo për vetë faktin se "Karakteristikë e përgjithshme e alegorisë është mohimi. Ajo e ka burimin tek dhimbja popullore. Por nuk është art i pesimizmit. Brenda saj është përherë motivi i ardhmërisë së popullit, besimi në fuqinë e tij të pashterrshme. Ky besim është i nevojshëm dhe i bukur. Pa besimin dhe shpresën asgjë nuk është e mundur. Alegoria bën "daiganozën " e shoqërisë, ajo në të njejtën kohë, është edhe "ilaçi" për shërimin e saj. Për këtë arsye alegoria ka premisën e ekzistencës edhe në të ardhmen. Me kritikën ndaj veseve njerëzore, ndaj sistemeve të ndryshme, ndaj pushtetit dhe pushtetarëve, ajo kontribuon për pastrimin moral të njeriut dhe hapjen e rrugës drejt horizonteve të reja. Alegoria ka synuar të grisë errësirën, me të cilën koha dhe konteksti historik mbështjellin popullin dhe, duke kryer këtë mision, ajo ka diellzuar jetën". (Perlat e Dibrës, 2008, f. 164) Megjithatë, në atë kohë kur u botua studimi (botimi i 1999), nuk isha i sigurtë për zhvillimin e alegorisë dhe këtë dyshim e shprehja në fund fare: "Mos vallë po ngrin alegoria? Mos vallë ajo do të mbetet një relike e së kaluarës? Bëhet gati për t'u ngurosur përgjithmonë, apo mbledh forcat për një shpërthim dhe ripërtëritje të re, këtë nuk jemi në gjendje ta themi me vendosmëri. Sidoqoftë, e kemi të vështirë të anojmë nga mendimi që alegoria i ka shterruar mundësitë e zhvillimit. Ajo mund të gjejë struktura dhe forma të reja për t'iu përshtatur shoqërisë në zhvillimin e saj. Arti popullor, kur i bën thirrje koha, vjen me mjete të reja shprehëse, me funksione dhe qëllime të reja". (Perlat e Dibrës, f. 168)

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 93
recensë

Mendime rreth botimit "Kanun" dhe librave të tjerë të Xhafer Martinit

Xhafer Martini, koha **po ndërton** për ty **një piedestal**...

Nga ***HYSEN*** **UKA**

KANUN, botimi më i ri i studiuesit Xhafer Martini, është nga ai lloj produkti intelektual, që frymëzon për punë të tjera, aq të dobishme për kulturën tonë, si: mbledhja, trajtimi e ruajtja e atyre farfurive të mendjes e të shpirtit të popullit, siç është rregullativa kanunore e zakonore. Vlera thelbësore e veprës rri në faktin se ajo është në përmbajtjen e vet shenja jonë dalluese, ndër këtë botë, me lloje e soje, të reja e të vjetra, që lindin e zhduken e në fund vetëm ato, më të qenësishmet, rrojnë e trashëgohen, duke u bërë identiteti ynë, pasaporta e kulturës sonë kombëtarë.

Puna e studiuesit Xh. Martini ka në përmbajtje pasionin dhe përkujdesjen e arkeologut, i cili rrënojat e një monumenti si Kanuni, i zbulon, i pastron, i restauron pa u lodhur, duke e nxjerrë në dritë e duke e ngritur para nesh, ashtu siç ne e kemi parë e po e shohim dhe sot.

Por, me Kanunin nuk ndodh si me çdo krijim tjetër, i cili, sapo del nga dora e shkrimtarit, nis jetën e tij të pavarur, duke i marrë mbi vete pëlqimin, mospëlqimin ose dhe harresën. Xhafer Martini, në rastin e "Kanunit", nuk është më në mjeshtërinë e shkrimtarit, por në atë të studiuesit, ndaj dhe marrëdhëniet e autorit me veprën e tij, janë thelbësisht të ndryshme. Në rastin e "Kanunit", studiuesi Xhafer Martini nuk e përdor lëndën e tij të parë, gjuhën, për të krijuar trope, thjesht për figuracion, për të estetizuar e krijuar ndjesi e emocione, por prodhon dije, më saktë derivon dije nga një konstruksion arkaik i kulturës së popullit tonë, dije nga e cila ushqehet e forcohet vetëdija jonë kombëtare. Dhe prodhimi i dijes është një mjeshtëri e vështirë, që të kërkon të lidhesh besnikërisht, të martohesh me fushën, me objektin e studimit, të mos mërzitesh kurrë e të ruash pasionin për t'u marrë me të, si në ditën e parë...

Fakti që studiuesi Xhafer Martini, edhe pas dhjetë vjetësh, që kur ai zbriti në letër variantin e parë të Kanunit të Maleve, vazhdon e vazhdon, pa u lodhur të merret me të, dëfton më së miri se ka zgjedhur të bëjë punën e duhur. E gjithë veprimtaria e tij, si ajo krijuese, por dhe studimore, zhvillohet në të njëjtin truall, ku është lindur, ka pasur fuqinë dhe juridiksionin e tij Kanuni. E gjithë vepra e tij, prodhimtaria artistike e studimore, tashmë është e lidhur, është një unitet, i cili ndërvepron brenda vetes, me lëndë dhe ide, duke evidentuar qartësisht trajtat e një projekti të madh, të identifikuar me autorin, në tematikë dhe në shtrirjen përgjatë kohës. Projekti i tij studimor, i nisur para njëzet vjetësh, vazhdon...

Me studimin dhe përmbledhjen e parë për alegorinë, "Perlat e Dibrës", nis ky projekt, dhe shkrimtari, tashmë studiuesi Xhafer Martini, i kushtohet seriozisht kulturës popullore, me përkushtimin e një "kulturologu të mrekullueshëm"- siç vlerëson studiuesi A. Tufa, që ka një plan, ka një projekt, projekt me staturën e një instituti. Xh. Martini tashmë, i ka gjetur tapitë e hisës së tij, ai e ka mbrehur pendën në arat e tij dhe domosdo do t'i ketë bereqet puna.

Dikush që e njeh maxhen, laboratorin e shkrimtarit ku nisin, ngjizen e lindin veprat e tij, 33 veprat e shkruara e të botuara prej Xh. Martinit deri më sot, do ta gjente të shtrirë në kohë e të barabartë me 99 vjet jetë artistike.

"Kam vendosur t'u kushtohem vlerave të kulturës dhe prozës popullore... - ky ishte vendi i studiuesit Xh. Martini. Tashmë e shoh se kjo është më e dobishme se të shpenzohem me trille letrare, ... majat në letërsinë shqipe janë pushtuar..."

"Duke qëmtuar e ndërtuar ngrehinën e kulturës së popullit tim, mendoj se do të bëj një punë më të mirë e të dobishme, si për këtë pasuri etnopsikike të popullit, ashtu dhe për emrin tim..."

Xhafer Martini ka atë pjekuri dhe atë përvojë, kur njeriu i ndjen e i percepton plotësisht vlerat kulturore e shpirtërore me të cilat është ushqyer nga dheu i popullit të tij, është i vetëdijshëm e krenar për to...

E gjithë periudha e mëparshme, domethënë para se ai vendos t'i kushtohet mbledhjes, kodifikimit dhe trajtimit të Kanunit; koha e studimeve, përvojat pedagogjike e mësimdhënëse, krijimtaria letrare, ku u provua jo pa sukses në të gjitha gjinitë, në prozë, poezi, dramë, letërsi për fëmijë, sprovat studimore për autorë e vepra, por dhe në kulturën popullore, etj., kanë shërbyer si një bazë dhe një shkollë formuese, për ta përgatitur Xhafer Martinin për etapën e dytë të veprimtarisë së tij intelektuale, atë të studiuesit, që nis mirëfilli në vitin 1993, me botimin e përmbledhjes me tregime alegorike "Perlat e Dibrës", për ta vazhduar pastaj me projektin e madh të Kanunit të Maleve, Kanuni i Dibrës, Kanun, për të cilin flasim sot e do të vazhdojmë të flasim.

Ishte koha kur "zhurmëtarët e rinj të modernizmit" e quanin një kotësi të "rrëmosh në sepetet e rrangullinave të kulturës popullore", mjaft më me folklorizma, anakronizëm, mendësi e vjetër, patriarkalizëm, etj., e quanin deri dhe nacionalizëm e jo patriotizëm. Shumë mjeshtra të shkrimit humbën rrugën në atë gjyrmish të botës së premtuar, nuk qenë të zotët të shquajnë shtegun nga duhet të shkonin dhe ku ishte blatuar ymri i veprës së tyre... Shumë nga ato tashmë janë bjerrur, kanë shteruar, kanë tharë... Gurra ku zgjodhi të pinte Xhafer Martini nuk reshtet se buruari me gurgullimë, atë begati të tokës shqiptare, krejt prej drite e kristali... Xhafer Martini tashmë është bërë vlerë identitare jo vetëm e shkrimit dhe kulturës dibrane, por vlerë kombëtare... Këtë nuk e them t'ju bind e t'ju mbush mendjen sot, por jam shumë i sigurt që me kohë do të mendojnë gjithnjë e më shumë njerëz, siç mendoj unë.

"Kanuni" është enciklopedia shqiptare, është trashëgimia juridike e popullit tonë", i cili përmban në vetvete filozofi, histori, gjuhësi, sociologji, edukatë morale dhe estetike, psikologji, pedagogji popullore, teologji etj., është ai që Herderi e quan Volksgeist-i, shpirti i popullit tonë, i cili gjallon në dy forma si përditshmëri, si praktikë jetësore dhe si rregullator juridik.

Ekzistenca dhe përmbajtja polivalente e këtij korpusi të spikatur identitar të gjakimit të popullit shqiptar është gjithashtu lëndë, objekt, fushë studimi e hulumtimi, për shumë punonjës shkencorë, të disiplinave e nëndisiplinave të shkencave sociale shqiptare.

Kontributi i autorit është i lavdërueshëm në shumë rrafshe, por unë do të dëshiroja të veçoja e të vë në mendje leksikun e pasur, të qëmtuar me kujdes, të përdorur mjeshtërisht për të tipizuar mjedisin jetësor dhe tipin social-historik, që e zotëronin dhe e përdornin në jetën e tyre Kanunin, këtë rregullator unikal nga përmbajtja dhe funksioni; strukturën tekstore, në të gjitha nivelet, që nga sintaksa e thjeshtë e deri në konceptimin e ngritjen e arkitekturës së plotë të veprës, përdorimin e ndërkalljen mjeshtërore të rrëfenjave (sempllave apo kazuseve), ku kodifikuesi i vë mjeshtërisht të veprojnë (aktrojnë) ngado në ato mjedise, nën autoritetin e juridiksionin e Kanunit, të gjithë frymorët: burrin, gruan, mikun, bijën, djalin, shkesin, lajmësin, plakun, gjakësin, klerikun, priftin dhe hoxhën, kumbarën etj., vendosen mjeshtërisht në dekorin epik të botës shqiptare, ku shohim të na shfaqen si në një skenë teatri: kisha, kulla, shohim vathën, pyllin, mullirin, pendën e qeve, krushqit, nusen, qenin e stanit, tufën, kullotën, udhën, krojin, e vijën e ujit e deri tek hallkat e qenit, qenin e bariun, etj... dhe të gjitha këto në një dinamikë e shkathtësi rrëfimi, që vetëm një mjeshtër i sprovuar në punën e të shkruarit të prozës, si asaj të kultivuar letrare e deri tek proza popullore, që mban nën lule thumbin e prozës fabuleske, që mban nën gushë maksima me vlera filozofike e morale universale, përmes së cilave kuptojmë e na kupton gjithë bota njerëzore.

Autori nga gjithë këto vite bashkëjetese me Kanunin ka mësuar një veçori origjinale të artit të popullit, të cilit po "t'i qasësh me dashuri, përkushtim, në vijimësi e me durim, ai të udhëheq vet në rrugën e suksesit". Sikur njërin nga këto çelsa të mos e zotërosh, atëherë s'do të mund të hapësh kurrë derën rëndë të këtij thesari, të kapërcesh pragun sa të thjeshtë në dukje, po aq dhe madhështor të tij. Falë këtij përkushtimi, bashkudhëtimi të gjatë, shumë miqësor e në mirëkuptim të plotë të autorit me kanunet, ai ka kuptuar se e gjithë tradita kanunore "graviton në një qendër", në një bërthamë rreth së cilës edhe rrotullohet gjithë ky univers, që në thelb përkon me shpirtin e popullit që e krijoi.

Studiuesi, falë thellësisë dhe gjerësisë së njohjes së lëndës së kanuneve, kulturës popullore që merr në shqyrtim, arrin të gjejë në to bazën e gjerë, atë që është fundament i përbashkët i të gjithë rregullativës kanunore, pa rënë në krahinarizëm, por duke evidentuar trajtat e plota e të përbashkëta kombëtare të kanuneve.

Studiusi Xhafer Martini futi në kulturën e të shkruarit një gjendje fluide e arkaike të një nëndialekti të gjuhës së folur, ardhur gojë më gojë, nga brezi në brez, deri në ditët tona, nën rrezikun real të humbiste e të mos e kishim më.

Xhafer Martini është qibar i madh i përdorimit të fjalës, ai e kërkon fjalën të pastër e të qëruar, "kokërr më kokërr" si i thonë, pa asnjë kashtë nëpër të. Xhafer Martini nuk ndjehet mirë në shoqërinë e atyre që i përziejnë kashtë e kokrra, (drithë e bykë bashkë), prandaj jo çdo kush mund të shtrohet në sofër me të. Sigurisht, ata që nuk e gjejnë vetën në sofrën e tij, ata që mbeten në këmbë nuk do të thonë fjalë të mira e lëvdata për të. Por kjo veç e mban të pastër mjeshtërinë e tij.

Xhafer Martini në përditshmërinë tonë nuk ndjehet, nuk bën zhurmë, nuk pozon, nuk jeton në teknologjinë e imazhin, por ashtu siç e kanë në nder e për soj raca e mendimtarëve, ai end e mbledh mendimet, tjerr e i ndriçon ato, mu aty ku të gjithë kalojnë e s'i shohin nga krenia e tepruar, a të qenit modern, por në të vërtetë të kapluar nga kotësia apo injoraca.

Pranë tij kalojnë pushtetmbajtës e politikanë, graduatë e ofiqar, deputet e gjithfarë "kallinjsh" pa kokrra, që prej kryenaltësisë bëjnë sikur nuk shohin... E mua më vjen ndër mend një urtësi sa biblike, po aq dhe kuranore për magrurët apo magrubët, si i thonë në Dibër:

Kur të tjerët bëjnë sikur nuk të shohin, nuk të vënë re a përpiqen të të mbulojnë me heshtje, kjo do të thotë se ti je shumë më lart se ata... Por ti mos u lëndo, mos u the nga kjo sjellje, miku im, vazhdo në rrugën tënde....Sepse koha po ndërton për ty një piedestal...



Fakti që studiuesi Xhafer Martini, edhe pas dhjetë vjetësh, që kur ai zbriti në letër variantin e parë të Kanunit të Maleve, vazhdon e vazhdon, pa u lodhur të merret me të, dëfton më së miri se ka zgjedhur të bëjë punën e duhur. E gjithë veprimtaria e tij, si ajo krijuese, por dhe studimore, zhvillohet në të njëjtin truall, ku është lindur, ka pasur fuqinë dhe juridiksionin e tij Kanuni. E gjithë vepra e tij, prodhimtaria artistike e studimore, tashmë është e lidhur, është një unitet, i cili ndërvepron brenda vetes, me lëndë dhe ide, duke evidentuar qartësisht trajtat e një projekti të madh, të identifikuar me autorin, në tematikë dhe në shtrirjen përgjatë kohës. Projekti i tij studimor, i nisur para njëzet vjetësh, vazhdon...

Prezantohet libri "KANUN" i Xhafer Martinit

Shoqata "Çidhna dhe Kastriotet" organizoi më 25 janar, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë promovimin e librit "Kanun" të studiuesit dhe shkrimtarit Xhafer Martini.

Në këtë veprimtari morën pjesë anëtarë të shoqatës, studiues të së drejtës zakonore, si dhe intelektualë dibranë me banim në Tiranë.

Shkrimtari Agron Tufa, foli në mënyrë të zgjeruar rreth vlerave dhe ideve kryesore të librit, duke u përqëndruar në veçoritë dhe dallimet mes Kanuneve të Lekë Dukagjinit, Skënderbeut dhe Kanunit të Dibrës, në rëndësinë e njohjes së tyre nga të rinjtë për të njohur dhe ruajtur tiparet kryesore të kombit dhe familjes shqiptare.

Juristi Kujtim Osmani, në referimin e tij kishte ndaluar në vlerat e traditës zakonore shqiptare në tërësi, dhe atyre të evidentuara e trajtuara nga studiuesi Xhafer Martini, duke vënë theksin se është me vlera të gjithanshme, kulturore por dhe të pasurimit të së drejtës shqiptare mbledhja dhe trajtimi i të drejtës kanunore.

Pedagogu dhe studiuesi Hysen Uka kish zgjedhur të referonte rreth etapës së dytë të veprimtarisë intelektuale të shkrimtarit Xhafer Martini, produktit të tij si studiues i kulturës popullore në tërësi, me theksim të veçantë kontributin e tij në mbledhjen dhe trajtimin shkencorë të trashëgimisë të së drejtës kanunore, duke nënvizuar se është një punë e jashtëzakonshme që meriton vëmendje dhe vlerësim më të madh nga institucionet kërkimore dhe akademike.

Referuesi Enver Kaloshi, vuri theksin në veprimtarinë krijuese e shkencore të Xhafer Martinit, duke theksuar lidhjet e forta të autorit me jetën, kulturën dhe traditat e krahinës së Dibrës dhe të dibranëve dhe duke u bërë një shërbim të paçmuar me mbledhjen dhe integrimin e tyre në tërësinë e vlerave të kulturës kombëtare.

Profesor Ismet Elezi, një njohës shumë i mirë i kanuneve shqiptare, e vlerësoi lart librin dhe veçoi shqetësimin për fenomenin e gjakmarrjes dhe keqinterpretimin e promovimin e këtij fenomeni sot në botë, duke sugjeruar vlerat e Kanunit dhe jo keqinterpretimin e tij, forcimin e shtetit ligjor dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.

Më pas përshëndeti Zenel Hoxha, president i dhomës së tregtisë Britani-Shqipëri

Këngëtari Kujtim Çera dhe një kafe me të pranishmit mbyllen këtë veprimtari shumë interesante.

Aktivitetin e prezantoi shkrimtarja Raimonda Maleçka, nënkryetare e shoqatës.

botime

Kodet e njohura dhe të panjohura të **poezisë** në vëllimin poetik **"N'dritë të hanës t'shkrova një letër"**

Nga **FEJZULLA GJABRI**

Ka pak ditë që në një nga sallat e Muzeut Historik Kombëtar u promovua libri me poezi dhe poema "N'dritë të hënës t'shkrova letër", i autorit Jahe Delia (Selmani), në vijim të disa shkrimeve të tij me rrëfenja, tregime dhe histori të zonës së Radomirës, por edhe mbarë zonës së Peshkopisë.

Mes njerëzve të shumtë që mbushën sallën e Muzeut Historik Kombëtar, ky aktivitet u prezantua nga miku e bashkëpunëtori i autorit, gazetari Dëfrim Methasani, i cili në hapje të aktivitetit prezantoi dhe një video të realizuar bukur për viset e Kalasë së Dodës e veçanërisht për Radomirën, shoqëruar dhe me disa fotografi të realizuara nga ajri nga i biri i autorit, piloti Floran Delia.

Jahe Delia është nga poetët që, bazuar në trashëgiminë popullore, sjell vlera estetike në poezi, të cilat u vunë në dukje nga shumë diskutantë, si Përparim Tomçini, dr.Hajri Mandrri, Mevlud Buci etj. Poezitë e këtij vëllimi ishin përcjellë bukur nga një 'Hyrje" e gazetarit dhe studiuesit Shaqir Skarra, i cili në mes tjerash shënon:

"Tek lëndina në pyll, kur harrohesh në vorbullën magjiplotë të dashurisë, tek dialogu mbresëlënës, tek bahçja e të dashurës së zemrës, aty na shpie. Jo veçse kaq, por autori na çon kudo në vendlindjen e tij, në ato vende të bukura, tek ato bjeshkë dhe burime me ujë akull të ftohtë...".

Ndalemi tek vëllimi poetik. "N'Dritë të hanës t'shkrova një letër". Pothuajse të gjitha poezitë vijnë nga dritëhijet e Korabit, si lirikë, epikë dhe liriko-epikë. Them dritëhije, se poezitë diku të bëjnë të gëzohesh e diku të bëjnë të vrejtur, diku qesh, e diku edhe qan. Fundja poezia është gjendje shpirtërore, është ndjenjë që përjetohet në rrugën e jetës, duke e shijuar direkt ose indirekt nëpërmes tregimeve të të tjerëve. Jaha i ka paraqitur të dy mënyrat. Diku i ka përjetëuar, diku i ka dëgjuar nga të tjerët dhe ka shprehë në të dy rastet vlerësimin ndiesor të vetin.

Konkretisht: Natyra, bjeshka e dashuria ngërthehen njëra me tjetrën për të paraqitur artistikisht vendlindjen, Radomirën, por jo vetëm.

Plot me lule mbushur bjeshka,
Lloj-lloje, ngjyra – ngjyra,
Lulemaravën fort e desha,
se të ngjante nga fytyra…

Është lulemarava, me aromën e këndshme



Fejzulla Gjabri (majtas) dhe autori i librit, Jahe Delia (Selmani). Foto: ATSH

dhe ngjyën e bukur që jep çelësin (kodin) e së bukurës në lirikë.

Nëpër poezi shetisin krojet me emra mitikë, si poezia për Krojet e Zanave, shetisin lulet me ngjyra shumë, thërrasin vendet historike, ngjarjet e shumta të kësaj ane; gjthçka me logjikën e artit.

Sa përmendëm vendet historike. Diku thërret heroi i Qafës së Kolesjanit, Haxhi Ibrahim Zeqiri, diku Shqipja e Arbërit krahët shtrin, diku ngrihet Bajrak mbi Korab, diku është njërzillëku i radomirësve për jetën e një njeriu nga Lura, Isa Mena, diku Tahir Sinani i UCK e kështu lexuesi kupton shpirtin jo vetëm të autorit, por të gjithë atyre burrave e grave në ato anë.

Poezitë që mund t'i dallosh lehtë, për tematikën e tyre, që me lirikën e ëmbël dalin dhe kodet e feminitetit. Në këto poezi, mbizotëron ndjenja e së bukurës.

"Me atë shtat si lisi,
Flokët s'ti ze shamia,
Faqe e buzë të kuqe,
T'ambla si qershia",... thuhet në një stofë të një poezie.

Pra, nuk është vështirë të dallosh kodin e feminitetit, që në vargjet e parë e deri në vargun e fundit në këtë vëllim, duket drita femërore, dialogu i saj me jetën. Është një dritë që na rrëzëllin bukurisht në çdo ditë të jetës, por që në poezi është më ndryshe, më e ëmbël, më jetëdhënëse, të cilën e paraqet mjeshtërisht autori.

Poezia epiko – lirike, ose siç quhen ndryshe në letërsi, baladat, zënë një pjesë të rëndësishme të vëllimit. Baladat janë këngët e dhimbjes, këngët e kurbetit, këngët e shtegtimit, por edhe këngë trimërore që thuren bukur.

E rëndësishme në këto krijime është se autori Jahe Selmani, i ka qëndruar besnik krijimtarisë popullore, këngëve të hershme, ndër të cilat edhe këngë "Moj Fusha e Korabit". Dhe s'ka si ndodhte ndryshe. Aty, pikërisht në Radomirë janë ngjizur vargjet e këngës "Moj Fusha e Korabit", ndoshta edhe vargjet e para të baladës "çou Rexhë, çou bir i nanës". Këtë të fundit, sigurisht duhet marrë me rezerva, pasi "Kënga e Rexhës" është gjithëkombëtare. Po ngjarja duket, gjithnjë sipas një krijimi të paraqitur nga Jaha në këtë vëllim, ka ndodhë në Radomirë.

Poezia epike, bazohet në qëndresën e popullit tonë, lumjanë, dibranë, të Katër Bajrakëve e veçanërisht të Bajrakut të Radomirës kundër pushtesve, veçanërisht të atij sërb.

"Luftë e madhe, sa nuk ish pa,
Afsh po lshon zemra e dheut,
Çdo kullë bahet sot kala,
u ngjall zulma e Skënderbeut"
Ose:
"S'i ka ba hesapet mirë,
Luma mjesin s'e ka pritë,
Faqebardhë, moj Radomirë,
E ke nisë luftën me dritë."

Janë vargje nga poema për luftën e Lumës në Qafë të Kolesjanit.

Së fundi, është vendlindja. Jahe Selmani e do vendlindjen, do vendet e bukura të Radomirës, me ujit e bollshëm, të ftohtë e të kulluar, do pyjet e ruajtura me itifak, do tokën, do bjeshkën me delet rudë. Pra,

"I bekuar ky fshat,
ku së pari qumështin pimë,
Lindëm ktu e qemë me fat,
Radomirë, për nder ta dimë".

Arrin nëpërmjet poezisë të na sjell origjinën e këtyre banorëve:

"Heret erdh nga Grama Radi,
E pëlqeu ktë vend të mirë,
Kjo luginë ku fryn Korabi,
emrin mori Radomirë".

Grama, (Gramatika), një qendër e hershme fort, ku janë edhe shenjat e një vendbanimi, që ndodhet në malin e Gramës. Disa studiues e lidhin Radin me Radomirën, që zbriti në këtë vend, duke krijuar një fshat me emrin Radomirë. Radet janë sot një lagje e Radomirës. Them se mjeshtërisht, pa shumë fjalë, Jaha e sjell nga shqipja këtë emër. Mund të them se këtu si shumëkund ekziston Kodi i Enigmës. Enigma përherë ka qenë porta ku ka dashur të futet njeriu i mençur. Dhe çelësi për të hyrë te kjo portë është pyetje. Pyetje si figurë retorike është një nga figurat letrare më të përhapura letërsinë botërore. Edhe Jaha e ka përdorur bukur në formën e një e një të dhëne:

"Të pesë fshatrat e formuara,
ngjajnë me hanën, ngjajnë me diellin,
I kanë gjëra më të çmuara,
Ujin, ajrin, bjeshkën pyllin."

Në mbyllje, them se në këtë libër është derdhë drita e shpirtit të Jahes, që edhe ne marrim diçka nga ky trazim: Marrim ndjenjën e vendlindjes.

Martesat dibrane **më të famshme**

(Vijon nga faqja 12)

të njëzetat dhe mbante emrin e femrës që kishte tronditur presidentin më të fuqishëm të kohës së atëhershme, Bill Klintonin. Ajo studionte për Bio-Kimi, ndërsa Iliri ishte një figurë mjaft e njohur e politikës shqiptare. Njohja e tyre kishte lindur auditoreve të Forumit Rinor Eurosocialist Shqiptar (FRESH). Kjo ndjenjë rinore nuk do tu shpëtonte shpërthimeve rinore të moshës, e cila ndoshta me dashje apo pa dashje do ti jepte kryeministrit të atëhershëm, të drejtën e lindjes së një fëmije jashtë martese, pikërisht të një vajze, që sihte kopje identike e tij. E pagëzuan me emrin e bukur dhe mjaft domethës Bora dhe shpërndanë biskota. Katër muaj pas martesës, Monika Kryemadhi dhe 29 vjeçari Ilir Meta, të shoqëruar nga dy dëshmitarë; ambasadori zvicerian dhe kryeredaktori i gazetës (ZP), Erion Braçe, trokitën në zyrat e Gjendjes Civile në Bashkinë e Tiranës për t'i thënë "po" martesës në një cermoni të thjeshtë, pa praninë e asnjë të afërmi të tyre[25]. Sot, ata janë tepër të lumtur, por me preukopime të mëdha familjare e shtetërore. Iliri është kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryetar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, partia e tretë më e madhe në kuvend me 18 deputetë, ku një ndër ta është edhe Monika Kryemadhi me origjinë nga Dibra, pikërisht atje ku lindi dhe u rrit zonja tjetër e Shqipërisë, Nexhmije Xhuglini (Hoxha, madje shtëpitë i kanë pasur shumë pranë, por të ndarë me kufij shtetërorë para 100 vitesh kur "prej Shqipërisë së 1913-ës u bënë dy Dibra dhe jo një, siç ishte ndër shekuj; dallimeve etnografike "malësi" - "topallti" dhe ndarjes në male iu shtua edhe "limes-i" politik[26]. Ndryshe nga bashkëqytetarja e saj, Nexhmije Xhuglini, e cila, pas martesës mori mbiemrin e bashkëshortit, Monika ka vendosur të mbajë mbiemrin e vajzërisë. Gjatë kohës së monizmit, prindërit e Monikës, u shkëputën përfundimisht nga Dibra dhe u vendosën në Laprakë, babai i saj punoi si specialist i frutikulturës. Iliri është nga Skrapari, ka lindur në një familje të nderuar intelektualësh. Që të dy janë të kënaqur me njëri-tjetrin. Monikës i vjen mirë që ka bërë për vete njeriun më të fuqishëm të Shqipërisë, por edhe Iliri krenohet që ka për grua një femër, që ndodhet gjithmonë pranë fëmijëve dhe bashkëshortit. Nga martesa kanë tre fëmijë, Borën, Besarin dhe Erën.

ÇIFTI HOXHA: DASHURI QË LINDI DHE U RRIT NË LUFTË

Nexhmije Xhuglini u njoh me Enver Hoxhën në vitet e luftës kundër okuptarorëve nazifashistë. E ka njohur për herë të parë më 23 Nëntor 1941 në Mbledhjen e Themelimit të Rinisë Komuniste të Shqipërisë që bë në shtëpinë e Sabrije (Bije Vokshit) në Tiranë. Më parë as që kishte dëgjuar për të. Nexhmija ishte vetmja vajzë që merrte pjesë nga 12 delgatët e 12 grupeve të ndryshme, ku mbajti dhe një diskutim mbreslënës. Në atë mbledhje u zgjodh Komiteti Qendror i Rinisë Komuniste, me Sekretar politik Qemal Stafën, sekretar organizativ Nako Spiru dhe anëtarë Nexhmije Xhuglini, Tasi Mitrushi dhe Ymer Pula nga Kosova. Mbledhjen e drejtonte Qemal Stafa, ndërsa Enveri ishte dërguar nga Komiteti Provizor i PKSH. Enveri, u dha dorën të gjithëve, dhe kur shkoi tej ajo, Qemali i tha: "Kjo është Shoqja Nexhmije Xhuglini, për të cilën të kam folur". Celebrimin e martesës e kanë bërë më 1 janar 1945 në shtëpinë e tyre në "Tiranën e Re", ku lindën tre fëmijë: Ilirin (13 mars 1949), Sokolin (14 shkurt 1951) dhe Pranverë (24 qershor 1954). Në librin e saj "Jeta ime me Enverin" ajo kujton: "Çdo çift i dashuruar ruan si kujtim të bukur njohjen e parë, takimin e parë. Dikush i bën poezi, dikush këndon këngë, tjetri e pret të dashurën në park, në rrugë, në oborrin e shkollës ose të shkalla e apartamentit. Kështu ndodh pak a shumë në kohë paqeje. Po në luftë? Në kushte ilegaliteti? A lind dashuria? Përderisa je i ri ose e re, edhe atëherë çel dashuria, si lulet në praverë.

(Vijon numrin e ardhshëm)

REFERIME:

1. Prof. Dr. Shaban Sinani, Dibra është stacioni i parë i punës sime krijuese, Rruga e Arbërit, Nr. 73, maj 2012, fq. 1,4, 5, 6. Intervistoi Mentor Hoxha.
2. Mentor Hoxha, flamuri dhe shteti i parë shqiptar u ngritën nga Kastriotët e Çidhnës, Rruga e Arbërit, nr. 79, Nëntor 1912, f. 1, 165, 175.
3. Mentor Hoxha, Shkëlqimi, rënia dhe demonizimi i parisë, Rruga e Arbërit, Nr. 82, shkurt 2013 fq. 1, 10, 16.
4. Kristo Frashëri: Nga ishin Kastriotët? Ku u lind Skënderbeu? Në Studime për Epokën e Skënderbeut II, Tiranë, 1989, f. 451.
5. Ali Hoxha, mbi lokalizimin e fushës së Betejës së Torviollit, në: Në Studime për Epokën e Skënderbeut II, Tiranë, 1989, f. 564-572.
6. Kristo Frashëri, revista "Shkenca dhe jeta", nr. 1/1986, fq. 28.
7. Revista "Albania" London, 4/1903.
8. Mentor Hoxha, flamuri dhe shteti..., cituar.
9. Raffael Volaterrani, Komentarët,
10. Marin. Barleti: Historia e Skënderbeut, përktheu Stefan. I. Prifti, Tiranë 1964.
11. Marin Barleti, cituar, Tiranë 1998, fq. 382-384
12. Ilirjan Gjika, cituar
13. M. Barleti , cituar.
14. Po aty.
15. Dh. Shuteriqi, Arianitët. Studime për epokën e Skënderbeut, II. Tiranë 1989.fq. 37-83).
16. Ilirjan Gjika, cituar
17. Mentor Hoxha, "Sabri Godo, njeriu që u fut në politikë që në moshën 9-vjeçare, SOT, 10.12. 2005, fq.13.
18. Haki Përnezha, Krahina e Çidhnës, Botimet M&B, fq. 29-30.
19. Ilirjan Gjika, po aty.
20. Haki Stërmilli "Kalorësi i Skënderbeut, në vepra letrare 1, ShB. Naim Frashëri, 1982.
21. Haki Përnezha: Krahina e Çidhnës, Botimet M&B, fq. 29-30.
22. M. Barleti, cituar
23. Haki Përnezha, Krahina e Çidhnës, Botimet M&B, fq. 29-30.
24. Ilirjan Gjika, cituar.
25. Mentor Hoxha, një ditë mes cciftit Meta, Emigranti Shqiptar, Maj 2000.
26. Prof. Dr. Sh. Sinani, Dibra,... , cituar.

Rruga e Arbërit nr. 93

analizë

Një vështrim i shkurtër rreth punës 2-vjeçare (28 Nëntor 2011- 28 Nëntor 2013) të Kryesisë së Shoqatës etno-kulturore "Çidhna dhe Kastriotët".

Dy vjet shoqata **"Çidhna dhe Kastriotët"**

Nga **ALI HOXHA***

Ideja dhe puna organizative rreth një vjeçare e nismëtarit Mustafa Tola për themelimin e shoqatës sonë etno-kulturore "Çidhna dhe Kastriotët" u kurorëzua me datën 28 Nëntor 2011 me ceremoninë e promovimit në lokalin "Edisen", për organizimin e së cilës duhet falenderuar veçanërisht z.Mustafa Tola dhe Muhamet Bitri, të cilët harxhuan edhe fonde të konsiderueshme nga xhepi i tyre. Po në atë ditë u bënë edhe zgjedhjet e para të Kryesisë së Shoqatës me konsensus të plotë, me mandat 2-vjeçar me rotacion dhe e përbërë nga zotërinjtë: Ali Adem Hoxha – Kryetar i Shoqatës; Muhamet Sefedin Bitri – nënkryetar; Hajredin Mersim Toca – sekretar,si dhe Nismëtari themelues, ose Kryetari i Nderit z.Mustafa Shaqir Tola, anëtari i përhershëm i Kryesisë.

Ndaj në emër të Kryesisë dhe në emrin tim personal i falenderojmë nga zemra të gjithë anëtarët e Këshillit drejtues (themelues) për besimin e plotë që na dhanë duke na ngarkuar detyrën e drejtimit të Shoqatës për mandatin e parë për periudhën 2-vjeçare (28 Nëntor 2011 – 28 Nëntor 2013). Falenderoj Zotin për frymëzimin që më dha, për të propozuar si datë të themelimit të shoqatës sonë në një datë simbolike, siç është data historike e 28 Nëntorit të vitit 1443, dita e çlirimit të Krujës nga pushtuesit osmanë dhe e ngritjes së flamurit të principatës së Kastriotëve nga Gjergj-Kastrioti-Skënderbeu, bir i Çidhnës, i Dibrës dhe i gjithë Shqipërisë, flamur i cili vetëm pak muaj më pas, më 2 mars 1444, në Kuvendin e Lezhës ku u themelua dhe shteti i parë kombëtar me komandant të përgjithshëm të ushtrisë shqiptare Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe me flamurin mbarë kombëtar shqiptar, kur do të valëvitej triumfalisht në krye të ushtrisë së bashkuar shqiptare të komanduar nga Skënderbeu në betejën kundër ushtrisë së pushtuesve osmanë më 29 qershor 1444, që në histori njihet me emrin "Beteja e Torviollit". Theksojmë se edhe rilindësit shqiptarë në vitin 1912 e shpallën pavarësinë e Shqipërisë nga Turqia, duke valëvitur po atë flamur të Skënderbeut si flamurin e lirisë, pikërisht në të njëjtën datë, 28 Nëntor, ashtu si në vitin 1443. Ndaj 28 Nëntori i vitit 1443 është quajtur Nëntori i Parë i Liriës, kurse 28 Nëntori i vitit 1912 është Nëntori i Dytë i Lirisë së Shqipërisë.

Me këtë rast theksojmë se do të krijohej një traditë e mirë patriotike nëse rotacioni i drejtimit të Kryetarit të Shoqatës do të organizohej edhe në të ardhmen në të njëjtën datë simbolike.

Veprimtaria e Kryesisë së shoqatës sonë, më gjerë edhe e degëve të saj në Dibër, për këtë periudhë 2-vjeçare është e njohur nga shumica e të pranishmëve. Ajo është evidentuar dhe e dokumentuar jo vetëm në protokollet e mbledhjeve të Kryesisë së Shoqatës, në raportin përmbledhës me shkrim për punën një vjeçare të Kryesisë, referuar nga Kryetari i Shoqatës, në mbledhjen e radhës të zgjeruar të datës 13 tetor 2012 etj, por ato janë pasqyruar edhe në shtypin periodik të shoqatës, "Rruga e Arbërit", kryesisht nga anëtari aktiv i Këshillit Drejtues, z.Bujar Karoshi etj, por të gjitha veprimtaritë e Kryesisë dhe më gjerë dhe të veprimtarëve të tjerë të shoqatës janë evidentuar e pasqyruar edhe nëpërmjet internetit në faqen e Fejsbuk-ut (facebook) hapur në emër të shoqatës nga sekretari z.Harjedin Toca. Por shumë prej atyre aktiviteve janë të regjistruara e të dokumentuara



edhe me video filmike, një pjesë e të cilave janë transmetuar edhe në mediat elektronike, në emisione të ndryshme televizive.

Nisur edhe nga qëllimi i krijimit të shoqatës si atdhetare, etno-kulturore, programi dhe tematika e punës së saj është e shënuar dhe miratuar edhe në vendimin e gjykatës nr.3388, dt.10.09.2012 dhe e regjistruar si person juridik (sqarojmë se meqenëse për shkak të shpërndarjes dhe rimarrjes së nënshkrimeve të anëtarëve të Këshillit themelues, u riplotësua pak me vonesë dokumentacioni sipas vërejtjeve të gjykatës), ku, ndër të tjera, theksohet që shoqata të evidentojë vlerat etno-kulturore . . ., t'u tansmetojë brezave traditën dhe kulturën e krahinës dhe t'i zhvillojë ato më tej etj, si dhe për faktin se kjo periudhë 2-vjeçare përkoi edhe me 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, si dhe me 100-vjetorin e luftës çlirimtare të popullit të Çidhnës e të mbarë Dibrës, kundër pushtuesve serbë, (kryengritje e cila zanafillën e organizimit dhe pushkën e parë që shërbeu si sinjal të shpërthimit të Kryengritjes së shtatorit 1913 të mbarë Dibrës e ka pikërisht në Çidhën, në Fushë-Alie) ishte kjo arsyeja që veprimtarinë e shoqatës për këtë periudhë ta intensifikonim e ta kanalizomin kryesisht në aspektin historik, për pasqyrimin e disa nga aktet heroike të popullit të krahinës së Çidhnës në luftërat për liri e pavarësi, duke filluar që nga ato kushtuar kohës së Skenderbeut e më pas, disa nga veprimtaritë më kryesore që meritojnë t'i përmendim edhe sot këtu, janë sa vijon:

-Evidentimi i dokumentacionit shkencor dhe shoqërimi e bashkëngjitja e tij me kërkesën zyrtare të Kryesisë së Shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" drejtuar më 4 prill 2012, Këshillit të Komunave Arras, Fushë-Çidhën e Kastriot dhe më 15.07.2012 drejtuar Këshillit të Qarkut të Dibrës me propozimin për ngritjen e një përmendoreje historike (lapidari), në komunën Arras, në vendin e quajtur "Suka e Arrase" kushtuar Betejës së Torviollit" të datës 29 Qershor 1444 dhe me miratimin e kësaj kërkese për nga Këshilli i Komunës Arras, krijuam bazën ligjore për ngritjen e një përmendoreje të tillë historike në vendin e vërtetë të zhvillimit të asaj beteje me shumë simbolika historike. Jo më kot, studiues të ndryshëm mundohen t'i rrëmbejnë Dibrës lavdinë e kësaj beteje dhe ta çojnë atë në rrethe të tjera, edhe pse pa asnjë bazë shkencore historike, kanë ngritur lapidarë falso (siç dihet, në Domosdovë të Prrenjasit dhe në Fushë të Bulqizës), edhe pse në kundërshtim me dokumentacionin shkencor historik. Dibra e Poshtme (pra teza jonë për zhvillimin e kësaj beteje në Fushë-Çidhën) ka edhe mbështetjen e Akademimsë së Shkencave. (Për më gjerë, përveç dokumentacionit shkencor të Akademisë së Shkencave dhe të Muzeut Historik Kombëtar, shih edhe fjalën e Prof.Stefanaq Pollos në përurimin e Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Çidhnës në nëntor të vitit 1985 (Gazeta "Dibra", Dhjetor 2009, fq.5)

Dua të theksoj këtu, se meqenëse për mungesë fondesh as Komuna Arras dhe as shoqata jonë nuk e realizoi këtë vepër, na mbetet detyrë neve, gjithë këshillit drejtues të Shoqatës, veçanërisht kryesisë së re, që kjo vepër të realizohet e të inagurohet më 29 qershor 2014, që përkon me jubileun e 57-të, me 570 vjetorin e saj.

Në këtë rast duke falenderuar projektuesin e kësaj vepre arti, z.Uzri Hoxha, që e bëri falas, theksoj se sipas llogaritjeve (preventivit) të tij, shpenzimet për atë vepër arti nuk i arrijnë as 2 milionë lekë të vjetra. Falenderim të veçantë meriton për këtë çështje Këshilli i Komunës Arras dhe Kryetari i asaj Komune, z.Sali Tërshalla. Me këtë rast i rikujtojmë z.Sali Tërshalla duke iu lutur që në planifikimin e fondit të vitit të ardhshëm të mos e lërë në harresë edhe atë vendim, pavarësisht se ai është i preokupuar me një vepër tjetër madhore, siç është Ura e re automobilistike mbi Drin, që kërkon fonde shumë herë më tepër.

-Në kuadrin e aktiviteteve të Shoqatës sonë "Çidhna dhe Kastriotët" duhet llogaritur edhe inagurimi në nëntor të vitit 2012 i "Dhomës muze" të Qeverisë së Arrasit të vitit 1920 më shtëpinë e Riza Lushës, në Arras. Themi kështu sepse ajo vepër u realizua si rezultat i bashkëpunimit të anëtarëve të shoqatës sonë, z.Sali Tërshalla, Munir Hoxha, Vesel Hoxha, Ali Lusha etj, në bashkëpunim me shoqatën e historianëve dhe të Muzeut të rrethit të Dibrës, kryesisht z.Moisi Murra e Ilias Kaca etj. si dhe nga Bashkia e qytetit të Peshkopisë, z.Ilir Krosi Kryetari i kësaj Bashkie, të cilët i falenderojmë nga zemra për kontributin e tyre. Në emër të Kryesisë së Shoqatës sonë në atë ceremoni ishin të ftuar dhe asistuan z.Ali Hoxha e Mustafa Tola, të cilët ligjëruan para të pranishmëve.

-Një aktivitet tjetër me shumë rëndësi, gjithnjë në kuadër të shoqatës sonë që duhet evidentuar dhe përmendur këtu, është edhe bashkëpunimi i Kryesisë së shoqatës sonë, sidomos e anëtarëve të kryesisë z. Mustafa Tola, Bujar Karoshi, Ali Hoxha, Hajredin Toca, Islam dhe Shkëlqim Cani, si dhe në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit të Peshkopisë, nën drejtimin e Kryetarit të saj z.Ilri Krosi, u bë e mundur që në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, të kontribuonim në botimin e librit "Historia e Dibrës" të akademikut Prof.dr.Kristo Frashëri në nëntor të vitit 2012.

-Një tjetër aktivitet në kuadrin e 100 vjetorit të Pavarësisë, duhet përmendur këtu edhe ai i Komunës Fushë-Çidhën me nismën për të vlerësuar figurat historike dhe patriotët e zonës që luftuan për mbrojtjen dhe pavarësinë dhe çlirimin e Dibrës e më gjërë nga pushtuesit serbo-malazes (është fjala edhe për kontributin e çidhnakëve në mbrojtjen e Shkodrës në 1913). Aktiviteti u zhvillua në fshatin Blliçe, më 23.11.2012 në orën 11:00, i organizuar nga dega e Dibrës, ku meritë të veçantë kanë z.Aranit Skepi – Kryetar i Komunës, z.Haki Përnezha, Aqif Doçi etj. të cilët i falenderojmë nga zemra për kontributin e tyre. Në emër të Kryesisë së Shoqatës, asistoi në atë ceremoni Kryetari i saj z.Ali Hoxha.

-Veprimtaria finalizuese e shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë së atdheut tonë, pa dyshim, qe sesioni shkencor me temë "Çidhna dhe pavarësia e Shqipërisë", i organizuar nga shoqata në përkujtim të ditës historike të dy nëntorëve të lirisë, të 28 Nëntorit 1443 dhe të 28 Nëntorit 1912, pikërisht më 28 Nnëntor 2012, në një kohë dhe në një vend simborlik, tepër domethënës në sallën shkencore "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave në Tiranë, pikërisht në një kohë kur pushtetarët kremtonin vetëm nëntorin e dytë, ndërsa ne e kremtuam atë eveniment duke e filluar, së pari, me nderimin për "28 nëntorin e parë" me kumtesën "Karakteri atdhetar i luftrave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar" (me autor Ali Hoxha) dhe pastaj kumtesa e dytë me temë "Kontributi i Çidhnakëve për pavarësinë" (të autorit Mustafa Tola) etj.

Siç dihet në atë sesion u lexuan 8 kumtesa nga 12 të parashikuara, respektivisht nga Ali Hoxha, Mustafa Tola, Moisi Murra, Hysen Repa, Islam Cani, Ruzhdi Bitri, Zyber Gjoni dhe Haki Përnezha, ndërsa kumtesat e Afrim Doçit, I.Kacës dhe A.Bungurit, që i kishin dërguar kumtesat, por që mungonin vet, nuk u lexuan. Për organizimin e këtij sesioni, kontribuan Hajredin Toca, Bujar Karoshi, Muhamet Bitri, Huzri Hoxha dhe Përparim Alia. Në emër të shoqatës i falenderojmë nga zemra të gjithë të lartpërmendurit, si referuesit që i përgatitën kumtesat pa shpërblim, ashtu edhe dhuruesit që kontribuan për realizimin e këtij aktiviteti me vlera historike për krahinën, por edhe për shoqatën. Na del detyrë që materialet e këtij sesioni t'i botojmë në një vëllim më vete, edhe pse disa prej atyre kumtesave janë botuar edhe në shtypin e kohës, si "Rruga e Arbërit", "Republika" etj.

-Aktiviteti i fundit i shoqatës sonë për vitin 2012 është organizimi për hapjen e një ekspozite të piktorit Huzri Hoxha (anëtar i Këshillit Drejtues të shoqatës sonë) në kuadrin e veprimtarive të 100-vjetorit të pavarësisë, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, në Tiranë në sallën e madhe, kati I, me datë 16 dhjetor 2012 nën siglën "Udhë drejt jetës". Ekspozita u çel me një fjalë përshëndetëse për autorin dhe për të pranishmit. Fjalën e rastit në emër të Kryesisë së Shoqatës e mbajti Kryetari i saj, z.Ali Hoxha, një kopje e së cilës është arshivuar në dokumentacionin e shoqatës.

Edhe gjatë vitit 2013 Kryesia e shoqatës sonë ka bërë një sërë aktivitetesh duke i kanalizuar në kuadrin e 100-vjetorit të luftrave çlirimtare të popullit shqiptar për ruajtjen e tërësisë së tokave (trojeve) të shtetit të ri shqiptar nga sulmet e pushtuesve të rinj serbo-sllavo-grekë gjatë viteve 1913-1920, ndër të cilat një vend nderi në këtë kuadër zë edhe kryengritja mbarë popullore e Dibrës e vitit 1913 kundër pushtuesve serbë, zanafilla e së cilës ësthë pikërisht në Çidhën, më saktë, në Fushë-Alie, në momentin kur nga shtëpia e Xhetan Vajshës (Martinit) shpërthyen pushkët e para nga Halim Marku, Han Tota etj, duke asgjësuar një patrullë të pushtuesve serbë, të cilët po i kërkonin për t'i arrestuar si ish-luftëtarë vullnetarë që kishin luftuar për të mbrojtur Shkodrën nga pushtuesit serbo-malazezë.

Në këtë kontekst, më 17 janar 2013 me rastin e 545 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, Kryesia e shoqatës së bashku me një grup të rinjsh të veshur me kostume kombëtare dhe me flamuj kombëtare e të shoqatës, vendosën një kurorë në përmendoren e vendvarrimit të Skënderbeut në Lezhë. Ajo veprimtari është e pasqyruar në faqen e shoqatës në Fejsbuk (facebook) i shoqëruar edhe me fotot e rastit.

Po në të njëjtën datë, me 17 janar 2013 në mbrëmje me ndërmjetësimin e z.Dëfrim Met'hasani, Kryesia e shoqatës e përbërë nga z.Ali Hoxha, Muhamet Bitri e Mustafa Tola si dhe i ftuari nga ana jonë, Prof.dr.Adem Bunguri, dhamë një intervistë, një emision në TVSH, në përkujtim të Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ku në të njëjtën kohë iu bë edhe një publicitet punës së shoqatës sonë. Edhe ky aktivitet është regjistruar në video.

Qysh në momentin e përfundimit të sesionit të shkencor të 28 Nëntorit 2012, mbështetur në programin e punës të miratuar në statut, njëra prej

(Vijon në faqen 19)

ZGJIDHET KRYESIA E RE E SHOQATËS ÇIDHNA DHE KASTRIOTET

Më datë 27 dhjetor 2013, anëtarët themelues të shoqatës "ÇIDHNA DHE KASTRIOTET" zhvilluan zgjedhjet e kryesise për periudhën 2014-2015. Pasi u ra dakort për ndryshime në statut në lidhje me kryesinë e re të shoqatës u zgjodhën edhe dy nënkryetarët e rinj, zonja Rajmonda Maleçka dhe zoti Medat Zogu, ndërsa zoti Enver Kaloshi u zgjodh sekretar i shoqatës.

Ndërsa kryetari i shoqatës, Muhamet Bitri, e ka marrë detyrën sipas statutit më 28 nëntor 2013, gjatë një veprimtarie që shoqata zhvilloi në Kalanë e Krujës, që përkoi edhe me 570 Vjetorin e ngritjes së flamurit nga Gjergj Kastriot Skënderbe.

Autonomia e Dibrës në Mbretërinë Ilire

Nga **ISLAM CANI**

A KA QENË DIBRA AUTONOME NË KOHËN E MBRETËRISË ILIRE ?

Janë të shumta të dhënat e mijëvjeçarit të III p.e.sonë që flasim për jetën e qytetit dhe të banorëve të Çidhnës së vjetër. Iljaz Kaca, në librin e tij "Faqet e një ditari arkeologjik" na thotë se qyteti i Çidhës e ka filluar jetën 2100 vjet para Krishtit. Pra, qyteti i Çidhnës njihet me shtrirjen në fisin ilir të Penestëve, por ndërkohë në luftrat e gjata iliro- romake- maqedonase që i takon epokës së bronxit e gjen Çidhnën në studimet historike si qyteti i Oenës së luftës, së masakrës së rrënimit nga pushtuesit, por dhe qyteti i qëndresës, falë mbrojtjes natyrore e maleve të shkreta.

Historianët e njohin këtë qytet ilir në kohën e pushtimit romak dhe të rrënimit e shkretimit nga Perseu me masakrat që realizoi mbi qytetin Oena në vitin 169 para erës sonë. Reprezaljet e Perseut mbi qytetin Oenës sollën rrënimin e qytetit me të njëjtin emër, por jo thyerjen e kalasë së Oenës, e cila është me pozicionin më të mbrojtur, më strategjik ndërmjet maleve të H. Zezë, ose malet e egra ku ishte vendosur kalaja dhe në bashkëjetesë me banorin e saj pëllumbin e egër. Pëllumbi të egër, (columba oenas) është simboli i kalasë dhe qytetit për të flasin toponimet që ende ruhen në gjuhën e banorëve në Çidhën si: kepi i pëllumbit, maja e pëllumbit, shpella e pëllumbit, por kohët e fundit na vjen në ndihmë gjetja e monedhës me oenën e egër në Bronx, monedha e qytetit që qarkullonte në kohën mbretërisë ilire të Gentit.

PO PËRSE DIBRA KA QENË AUTONOME NË KOHËN E MBRETËRISË ILIRE TË GENTIT?

Deri në pragun e pushtimit romak, Dibra (Penestia) gëzonte autonomi lokale nga mbretëria e Gentit, sikurse e zotëronte dhe Shkodra si kryeqendra e mbretërisë. Kjo për shumë arsye, jo vetëm se në atë kohë Romakët kishin bërë pushtimin e disa pikave bregdetare ilire, por qëllimin e kishin të depërtonin në Dibër për të mposhtur mbretin ilir Gentin (sepse Dibra ishte pika më mbrojtëse e tij), por në këtë mënyrë futej dhe si pykë ushtria romake për të dobësuar Perseun në luftë të hapur me të. Qëllimi i ushtrisë romake ishte të fitonte Dibrën dhe të shkëputse lidhjet e mbretërisë ilire me atë Maqedone, për të lehtësuar politikat e saj. Kështu, për të mbrojtur Penestinë, jo pa qëllim mbreti Genti, ngurroi të bëjë aleancë me Perseun në dërgatën e parë që ata i dërguan në Shkodër, për aleancë kundër Romës rreth viteve 172 pes, per te cilen shkruan K. Frashëri. Mbreti Gent që duhet ti priste në Shkodër e devijoi takimin për në Lisus (Lezhë). Ai kishte strategjitë e tij luftarake, sepse në aleancë me Perseun nuk donte ti jepte shkak ushtrive romake që të sulmonin Dibrën pjesën lindore të Penestisë, si një qendër e sigurtë për mbretërinë e tij. Romakët qëllimin e sulmit e kishin për shkatërrimin e qytetit të Çidhnës, e cila shërbente si pikë e lidhëse me kryeqendrën e mbretit në Shkodër. Jo vetëm kaq, por kishte dhe arsyet të tjera si :

• Çidhna ishte qendra më e madhe e qytetërimit të asaj periudhe dhe njihej si një ndër qytetet më të zhvilluara dhe më të sigurta përsa i përket pozicionit strategjik të saj të njohur me emrin Oena.(qyteti dhe kalaja me të njëjtin emër).

• Lidhjet e këtij qyteti ishin si të merimangës me qytezat në anë të Drinit, sikurse qyteza në luginë ne Qejzës, një qytezë kjo që lidhte Reçin me Dardhën me qendër në Çidhën. Nga këtu bëheshin lidhjet me rrugët e Prizrenit siç njihej rruga e dardanëve, që përbënte krahun verilindor më të fortë të Çidhnës.

• Çidhna mbrohej edhe nga gjithë pjesa tjetër e Dibrës, duke filluar nga qytezat e kalatë e Dibrës që kufizoheshin me Maqedoninë, malet e Korabit, të Sharrës, e të pjesës veriore duke përfshirë kalanë e Dodës dhe gjithë lidhjet që kishte me Prizrenin. Genti që e kishte të pëlqyeshme këtë zonë e cila kalonte në rrugën e labeatëve për në Penesti e në Dardani.

• Lidhjet e këtij qyteti bëheshin me qytezat në anë të Drinit, sikurse qyteza në luginën e Qejzës, një qytezë kjo që lidhte Reçin me Dardhën me qendër në Çidhën.

Krahas faktorëve që përmenda më lart, Dibra kishte autonomi dhe për disa arsye të tjera:

1. Dibra kishte shumë qytete e qyteza të zhvilluara sikurse ishte qyteti i vjetër Çidhna ose Oena.

2. Jo vetëm Çidhna, por e gjithë Dibra ishte vend strategjik natyror (sië është Çidhna një amfiteatër natyror).

3. Prerja e monedhës tregon për autonominë e Dibrës. Monedha e prerë në epokën e bronzit në qytetin tonë në Çidhën, flet për qytetërim dhe urbanizim e fiseve ilire në këto zona, për zhvillimin e ekonomisë dhe tregtisë ndërmjet zonave dhe ndërmjet fqinjëve, për lidhje e bashkpunime me kryeqendrën e mbretërisë ilirë që ishte Shkodra. Kjo periudhë e bronzit dhe e prerjes se monedhave na bën të theksojmë, se mbreti Gent i Ilirisë ju kishte lënë autonominë dibranëve.

4. Monedha ose medalioni i gjetur në kalanë e qytetit të Çidhnës ka si simbol pëllumbin Oena, ajo flet qartë për kohën e mbretërisë së Gentit me kryeqendër Shkodrën me zotërimet e shtrirjet e fiseve të labeatëve, pirustëve e penestëve, vende e male me pozicion te favorshëm strategjik e luftarak. Lidhjet me Shkodrën, Dibra i realizonte nëpërmjet maleve të shkreta ku shtriheshin fisi i Pirustëve fis Ilir që ishin në kufi me Dibrën, Matin,

> Dibra bashkë me malet e shkreta, kishte shumë kala mbrojtëse natyrore dhe të veçanta të ilirëve, dibranët kishin ndërtuar me qindra e kala e qytete, qyteza e pika vrojtimi, në gjithë territorin, këtë e tregon zhvillimi i asaj kohe, pavarësisht nga mbrojtja natyrore. Kjo ishte Dibra autonome e Ilirisë.

Mirditën e Kukësin, pra këto male ishin të vështira dhe të pakalueshme.

5. Një faktor tjetër ndikues në autonominë e Dibrës ishin dhe malet e shkreta, për të cilën do ta shtjelloj me gjerë më poshtë në tekst.

Dibra me fusha pjellore, por dhe me malet me livadhe të shumta. vend me ujëra të shumta, si Drini, Seta, Blliçja, Murra, Malla, dhe çdo fshat me disa burime pra e gjithë Dibra është një vend strategjik dhe vërtet një vend i lakmueshëm. Zhvillimi bujqësor me drithëra të shumta si meli, tepa, elbi, misri, urovi, etj. Çidhna nëpërmjet rrugës Artatusit, Lurës, Zall- Gjoçes, që merrte drejtimin e Durrësit mundësonte për bashkëpunime ekonomike, tregtare e më shumë jo vetëm me bregdetin por dhe me veriun e ilirisë.

Dibra me lugina të shumta dhe të ngrohta, pjellore me ujë, që në lashtësi ka vende që kanë marrë emrat të ruajtura në breza si:

- Shumërtajdh, vend ku bëhej reklamimi i bulmetrave si qumështit, djathit, gjalpit, etj ku dhe sot tunësit i thonë taj; ose shumë tajna (enë që përdorët për të kthyer kosin ne dhallë).

- Fushë dhensh (fusha e dhenve) që kur vinin bagëtitë nga kullotat, aty ndahej pjesë për më të varfërit duke ju dhënë mish apo bylmet.

- Trojet e Qestit ku festohej dita e verës, dhe festa të tjera paganike. Ku njerëzit në këto ditë festash dilnin e publikonin jo vetëm veshjet e tyre, por dhe punimet e tyre, qofte dhe ato të gatuara apo të konservuara. Në këto ditë feste nuk mungonin këngë, valle, vjersha, njohje e të rinjve me njeri- tjetrin.

- Dibra shquhej për odat, kuvendet dhe shkëmbimet e mendimeve më të mira më të pjekura në këto oda. Sheshet pranë kishave që kohë më vonë u bënë xhamia, ku mblidheshin për kuvende, ku dëgjohej fjala e burrave me emër dhe me zë në krahinë. Kanunet ishin pjesë edukative, siç ishin odat, vendet e kuvendeve, vendet e shenjta, etj.

- Në Dibër ka disa rregulla që dhe sot kanë vlera demokratike, njerëzore, si p.sh.; Gruaja nuk mund të lihet e të ndahet siç mund ti ndodhë njërit apo tjetrit në fqinje apo gjetkë, gruaja dibrane lihej po të ishte brac (hajdute) dhe imorale. Kjo na bind ne që vërtete Dibra ka patur tradita kulturë, emancipim dhe njerëz të mençur dhe këtu ka lind mençuria. Këto i gjejmë te shumë autorë, që shkruajnë për Dibrën, si K. Frashëri, A. Bunguri, Xh Martini, Z. Gjoni, I. Cani, etj.

MALET E SHKRETA, FAKTOR NDIKUES NË AUTONOMINË E DIBRËS

Malet e shkreta vetë me pozicionin natyror ishin vëzhguese të gjithë rrugëve dhe krahinave ku përfshiheshin Mirdita, Kukësi, Mati e deri në Shkodër. Zonë kjo me monumentet natyrore më të sigurta në këtë rajon, por me shtëpi të rralla, pa rrugë, territor i vështirë për jetuar. Monumentet natyrore siguronin vëzhgimin jo vetëm të Dibrës, por deri në Shkodër. Mund të përmendim disa prej tyre si pikat vrojtuese, ku njihen toponimet me emrin Rujat si;

a) Ruja e parë ishte Ruja që shihte nga Qejza e Reçit në malet e Çajs të Kukësit në krahun verilindor. Në anën V-P Ruja shihte, Lurën, Kumbullën e tërë Mirditën deri në pikën e lartë të Macukullit që shihte malet e Matit deri të ato të Krujës e të Gurit të Bardhë.

b) Ruja e dytë pika me lartë e vendosur në Lukan- Muhurr që shihte Qaf Murrë, Luzni, Selishtë, etj. Ndërsa nga pjesa perëndimore të zonës e Lurës dhe e Mirditës ku përfshihej nën vrojtim edhe kalaja e Çidhnës dhe e Stellushit e deri në pjesën jugore të kësaj zone dhe të Matit, që lidhej me malin e Gurit të Bardhë, Ruja lidhej me malet e Ollomanit, deri në Valikardhë, Martanesh në Shebenik e në Mokër.

c) Qyteza e Lurës është një pikë kryesore që realizonte lidhjen e Çidhnës me malet e shkreta. Të gjitha këto ishin në lidhje unike më malet e Mirditës që lidhte Lezhën, Shkodrën e deri në Mal Të Zi. Natyrisht që këto ishin lidhje malesh ndërsa nën hijen e tyre ishte lëvizja e banorëve që lidhej me shkëmbimin ekonomik e tregtar nëpërmjet sistemit rrugor që i kemi përmendur në librin e botuar "Çidhna Dje, Sot, Nesër".

E gjithë Dibra influenconte me zhvillimin e saj, me lidhjet rrugore dhe me lëvizjet njerëzore që e bënin të ishte dominuese ne informacion në lidhje me kryeqendrën e Shkodrës, por dhe me Durrësin, Shehrin, Prizrenin, Shkupin etj. Dua të gjykoj se, ndonëse Dibra bashkë me malet e shkreta kishte shumë kala mbrojtëse natyrore dhe të veçanta të ilirëve, dibranët kishin ndërtuar me qindra e kala e qytete, qyteza e pika vrojtimi, në gjithë territorin, këtë e tregon zhvillimi i asaj kohe, pavarësisht nga mbrojtja natyrore. Kjo ishte Dibra autonome e Ilirisë.

Dy vjet shoqata "Çidhna dhe Kastriotët"

(Vijon nga faqja 18)

pikave të të cilit është edhe "ndriçimi i historisë së krahinës", më lindi ideja për të bërë edhe një sesion tjetër shkencor kushtuar betejës së zhvilluar në Fushë-Alie në korrik të vitit 1944. Këtë projekt-ide, pasi e diskutova me disa nga anëtarët e Këshillit Drejtues dhe pasi ata ma mbështetën këtë projekt-ide, një grup shokësh të përbërë nga z.Ali Hoxha, Enver Kaloshi, Aranit Skepi-Kryetar i Komunës Fushë-Çidhën dhe Hajredin Dauti (ky i fundit rastësisht iu bashkëngjit grupit) me 21 shkurt 2013 organizoi një takim për këtë çështje në Institutin e Historisë të Akademisë së Shkencave në Tiranë me Prof. dr.Muharrem Dezhgiun, shef i sektorit të Historisë për periudhën e Luftës së Dytë Botërore në atë institut. Pas diskutimit të çështjes u arrit në përfundimin që për atë sesion të bashkëpunonte edhe Akademia e Shkencave (Instituti i Historisë), veç të tjerash edhe me dy kumtesa kushtuar asaj beteje: njëra nga Akademiku Prof.dr.Beqir Meta, Drejtor i Institutit të Historisë dhe një tjetër nga Prof.dr.Muharrem Dezhgiu, shef i sektorit të Luftës Nacionalçlirimtare. U bisedua dhe u ra dakort që me nga një kumtesë të angazhoheshin edhe historianët Prof.dr.Bajram Xhafa, Prof. dr.Qazim Xhelili, si dhe Prof.Abdi Baleta (nëse do të pranonte). Por ky projekt-plan nuk u realizua jo vetëm për shkak të angazhimeve të njerëzve (me problemet politike të fushatës së zgjedhjeve të pushtetit qendror të 23 qershorit 2013, që përkonin me një periudhë shumë të afërt me kohën që duhej bërë ai sesion shkencor, brenda muajit korrik), por për faktin se nga disa anëtarë të Kryesisë dhe të Këshillit Drejtues të Shoqatës këmbëngulën që një sesion i tillë për Betejën e Fushë-Alies, të korrikut 1944 nuk duhej bërë nga shoqata jonë.

Edhe pse z. Hysen Repa me studimin e tij dinjitoz me titull "Luftë civile, krim lufte, apo hakmarrje" të botuar edhe në gazetën "Rruga e Arbërit", sqaronte shumë gjëra të errëta rreth asaj beteje të cilat duheshin ndriçuar për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, përsëri të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes së datës 14 korrik 2013 për të diskutuar nëse duhej zhvilluar një sesion i tillë shkencor ose jo për atë betejë, ishin të mendimit që ai sesion të mos zhvillohej nga shoqata. Në të kundërt, në minorancë, që të bëhej ai sesion shkencor ishte vetëm mendimi i kryetarit të shoqatës, gjë që pasqyrohet si në protokollin e asaj mbledhjeje të zgjeruar të kryesisë, ashtu edhe nga letërkëmbimi ndërmjet sekretarit të shoqatës z.Hajredin Toca dhe z.Hysen Repa për këtë problem, respektivisht me dt.11, 17 dhe 23 korrik 2013.

Ajo që nuk u realizua, por që duhej të ishte bërë, ishte hapja e numërit të llogarisë në bankë në emër të shoqatës, gjë që për pasojë gjendja financiare e shoqatës sonë është zero. Kjo gjendje ka ndodhur për dy shkaqe: së pari, si pasojë e regjistrimit të shoqatës në gjykatë si person juridik me një vit vonesë, me 10.09.2012, ndërsa më pas për neglizhencë të Kryesisë së shoqatës, për lidhjen me shumë vonesë të kontratës së qirasë për zyrën e selisë së Kryesisë në 06 Nëntor të vitit 2013, (pavarësisht se formalisht) me pronarin Sefedin Bitrin. Në muajin nëntor 2013, zyra e Tatimeve ku bëhej regjistrimi, kur mësoi se kryetari aktual i shoqatës do të dorëzonte mandatin 20 ditë më pas, rekomandoi të shtyhej regjistrimi si person juridik OJF, dhe kryetari i ri të bënte regjistrimin pasi të bëheshin të gjithë ndryshimet në dokumentacionin përkatës në gjykatë. Sidoqoftë, kjo nuk na justifikon, por ndërkohë ka edhe anën e mirë të saj, sepse ky fakt tregon se shoqata jonë nuk ka karakter biznesi.

Aktiviteti i fundit i Kryesisë së Shoqatës sonë ishte ai i datës 28 Nëntor 2013 ku me rastin e 570 vjetorit të ngritjes së flamurit në Krujë nga Skënderbeu me 28 Nëntor 1443, i shoqëruar nga 300 kalorësit dibranë duke çliruar Krujën, nga përfaqësues të shoqatës u bë një vizitë në kalanë e Krujës dhe në Muzeun Historik "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu". Kryetari i shoqatës, z.Ali Hoxha, i njoftoi të pranishmit se mbështetur në statutin e shoqatës pas asaj date, në mbledhjen më të parë të radhës, siç është dita e sotme, mandatin e drejtimit të Kryesisë së Shoqatës për dy vjetët e ardhshme do t'ia transferojë Nënkryetarit aktual të shoqatës, z.Muhamet Bitri. Në këtë aspekt, duke përfituar nga rasti, edhe një herë i uroj nga zemra Kryesisë së re suksese në detyrë.

Në fund, ua të falënderoj nga zemra të gjithë shokët që në një mënyrë apo në një tjetër kontribuan për mbarëvajtjen e punëve të shoqatës, sidomos ata që ne shkrimet e tyre të botuara në shtyp, e me kumtesat në sesionin shkencor, veçanërisht autorët Xhaferr Martini, Dr.Islam Cani dhe Haki Përnezha, të cilët gjatë kësaj periudhe dolën para publikut me vepra të plota kushtuar Çidhnës, pa harruar këtu edhe ata që kanë shkruar më herët për Çidhnën si Ali Koçeku-Ziber Gjoni; Enver Kaloshi, Dali Tërshalla, Dali Noka, Miftar Alia e Asllan Loka.

Në aspektin personal ndjehem shumë i lumtur që gjatë kësaj periudhe në drejtimin e shoqatës konstatova se kisha shumë miq e shokë që më kanë mbështetur në punën time dhe më kanë mbrojtur dhe vlerësuar ndoshta më shumë se ç'mund ta mendoja.

** Autori ka qënë kryetar i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" gjatë viteve 2011-2014. Shkrimi i mësipërm është botuar me shkurtime nga raporti që i ka paraqitur Kryesisë pas dorëzimit të detyrës.*

Rruga e Arbërit nr. 93

Bëmat e të madhit Skënderbe, figura dhe virtytet e tij, luftërat epope si dhe ngjarjet në kalatë ku qëndronte e luftonte, populli dibranë i ka gdhendur në plot gojëdhëna.

gojëdhëna

Skënderbeu në gojëdhënat popullore dibrane

Nga **MEVLUD BUCI**



Bëmat e të madhit Skënderbe, figura dhe virtytet e tij, luftërat epope si dhe ngjarjet në kalatë ku qëndronte e luftonte, populli dibranë i ka gdhendur në plot gojëdhëna. Sa herë dëgjojmë apo gërmojmë këto gojëdhëna në gojën e njerëzve të moshave të ndryshme të transmetuara nga pleqtë e moçëm brez pas brezi apo ku rilexojmë studime të studiuesve virtuoz si Haziz Ndreu, Hilmi Kolgjegja, Hilmi Sadikaj, Rakip Sinani, Ali Hoxha e Sami Shehu na rishfaqet me tërë madhështinë e përmasave legjendare, prijësi i rrallë, i fuqishëm, i mençur, i duruar, i guximshëm, i thjeshtë e zemërgjerë, i lidhur shpirtërisht me ata të cilëve u printe, legjendari Skënderbe. Gojëdhënat janë krijime që burojnë nga muza popullore, nga shpirti i mençurisë dhe gjurmët e kujtesës, janë një dëshmi e qartë ku na pasqyrojnë ngjarje, figura, luftëra, ndodhi e mbi të gjitha lidhjen e Skënderbeut me popullin, me atdheun, na pasqyrojnë fisnikërinë dhe gjurmët e tij në Dibër. Skënderbeu na shfaqet sa strateg e legjendar, aq i thjeshtë e bujar, sa i guximshëm e i rreptë aq i duruar e i urtë, sa i ditur e fisnik aq edhe hyjnor e i pa mposhtur. Në Fushë të Lurës është një livadh që edhe sot i thonë "Ligjata e Skurës". Në këtë ligjatë (vend me ujë, me lagështirë) që buron lehtë – lehtë ujë edhe në dimër bora nuk zë vend se sa të bjerë shkrihet prandaj është gjithmonë jeshil me bar. Në një dimër të madh Skënderbeu la në këtë ligjatë atin e vet të sëmurë një ushtari që quhej Skurë. Skura e kulloti kalin gjithë dimrit në ligjatë dhe e nxori në pranverë shëndoshë e mirë. Që atëherë ligjatës i mbeti "Ligjata e Skënderbeut". Kur është rasti për të vërtetuar se Skënderbeu është i fuqishëm dhe autoritar populli i Qafëmurrës tregon këtë gojëdhënë: "Një ditë në Varosh bëhej Pazar dhe Skënderbeu po kalonte përmes gjindjes (popullit, njerëzisë). Papritmas njerëzit u zunë me njëri tjetrin. U bë zhurmë e madhe. Nga kjo ngjarje Skënderbeu u mërzit aq shumë sa nxori shpatën dhe goditi me forcë dy herë një gur që sot e kësaj dite është i ndarë në katër pjesë. Nga vringëllimat e shpatës dhe efekti i fuqisë mahnitëse të komandantit u vendos menjëherë qetësia në mes të gjindjes. Gojëdhënat, të cilat tregohen për Skënderbeun janë pasqyrë e qendrës e veprimtarisë dhe e nderimit të madh popullor kushtuar kësaj figure të ndritur të historisë tonë. Nga plaku Halil Peka, i cili sot nuk jeton kemi dëgjuar shumë kohë më parë se në Xhagjaj të Gurit të Lurës nën karakollin e Skënderbeut asht një gur i madh, i shpuar për mjedisi nga dy pëllëmbë që i thonë:"Dybeku i kafes së Skëndebeut". Në kohën e Skënderbeut kafen e kafërdisme e shtypnin në birën e këtij guri, më pas bënin kafen që e pinte Skënderbeu me ushtarë. Qysh atëherë i mbeti emri "Dybeku i kafes së Skënderbeut".

Në të folurit e Katër-Grykëve thuhet se kacniasit kanë qenë kovaçët e Skënderbeut e kryesisht Hasbajrami (fis armë punues të zot). Kjo gjë vërteton se së paku në atë kohë në Varosh janë marrë me punimin e metaleve e prodhimin e armëve. Një pjesë e këtyre zanatçinjëve (mjeshtër të punimit të armëve) mbas shkatërrimit të qytetit nga mësymja e osmanëve u larguan nga Varoshi në Balgjaj e u vendosën në luginën e fshehtë të Kacnisë, ku sipas të dhënave gojore të popullit, ushtria osmane nuk e shkelën asnjëherë dhe nuk është bërë asnjë përpjekje me ta në Kacni. Taktika dhe qëndresa e ngushtë me popullin, shpirti luftarak dhe shembulli prej komandanti legjendar e të pa mposhtur jepen mjaft bukur në sa e sa gojëdhëna të Dibrës, pasohen si testament gojë më gojë duke na dhënë me qartësi madhështinë e Skënderbeut.

"Skënderbeu, - tregonte plaku 102 vjeçar Bajram Nika në katundin Murrë e Vjetër të Qafëmurrës, - ka pas ni shpatë fort të madhe. Thonë e ka pas me rreze (lloj hallke metalike). E lidhte rrezen për krahi dhe si do të luftonte nuk ia çitte (nxirrte) kush pri dore". Po ky plak shekullor vijonte: "Përmaj (përmbi) Qafëmurrë asht ni shpat mali me mure të vjetra si i thonë Varosh. Në kohën e Skënderbegjut u poçën në Pazar të Varoshit di pleq ka niçin vjeç.

-Kah je taj?- e pajti njani shoçin.

-Pri Varoshi. Po taj?- ia ktheu qetri.

-Ene unë pri Varoshi.

-Ku e ke shpajnë?

-Në kraj të Varoshit. Po taj?

-Në fund të Varoshit.

-Çudi e madhe,- tha njani,-pri njaj veni jemi e ka niçin vjeç jemi e njani-qetrin se njofim". Aq i madh ishte në kohën e Skënderbeut Varoshi.

Populli ka trasmetuar plot gojëdhëna, të cilat tregojnë se gjeneza, luftërat dhe bëmat e Skënderbeut e kanë burimin edhe në Dibrën tonë të lashtë, e cila ka qenë vendlindja e Kastriotëve.

Në Çidhën plaku Hamit Cerri tregonte: "Njëherë Skënderbegjun e rrethuekshin mu në kala të ÇidhnësTurqit shtajshin me top, por sun ia qitshin kalasë. Nallbani e paeti Skanderbegjun se pse turqit s'un ia qitshin me top kalasë. Skanderbegju që i besonte Nallbanit, se e kishte ene kumar, i kallzoi venin se ku duhet ta veshin topin turqit me ia qit kalasë. Nallbani, si ishte pri Arrasi, në fajs të Marçene shkoi tinës ke turqit dhe u kallzoi venin se ku duhej të veshin topin për të marrë kalanë. Turqit vunë topin ataj ku u tha Nallbani në të bime të Gjalicave si edhe sot u thonë "Gurt e topit" dhe e prajshën kalanë. Skanderbegju me gjithë ushtri hiku prej Çidhne e zu vend ke karakolli i Xhagjajve. Kur muer vesh Skanderbegju se e kishte pre në besë Marçeni, si e kishte nallban dhe kumar e nemti: "Marçen qen, kurkun pushka mos t'zantë ven!".

Të shumta janë gojëdhënat e popullit të Qafëmurrës për Skënderbeun. Janë thënë gojë më gojë nama e Skënderbeut që i bëri pllajës së Lemoçes ku një i mençur herët kur po vështronte nga kalaja e Varoshit kur pa kaçubet e barit, kujtoi se ishin vendosur çadrat e turqve. "Kurrë mos mbifsh bar!". Edhe sot e kësaj dite Lemoçja e Qafëmurrës vërtet duket si djerrinë, nuk prodhon dhe nuk gjelbëron si rrethinat e tjera. Pra qysh prej mallkimit të Skënderbeut.

Kalaja e Kastriotit i ka themelet në gështenjat e fshatit Kastriot. Kalaja e Voles, në Vranjt, ka qenë e Skënderbeut. Në Xharxhisht të Lurës është kalaja e Skënderbeut. Në Lashkizë të Zalldardhës është një kodër në shkëmb që i thonë "Kalaja e Skënderbeut". Në trevat ku ndodhen kalatë në Çidhën, Kojavec, në shkëmb të Peladhisë (kalaja e qytetit),Grezhdan, Arras, Kalanë e Sfetigradit në Koxhaxhik, në Madriç. Gjurmët e Skënderbeut në toponime e gojëdhëna janë të shumta në të gjitha zonat e Dibrës. Ne mendojmë se Varoshi ka qenë qytet i lashtë dhe vendqëndrim i Skënderbeut, sepse Qafëmurra si fshati më i afërt i atij qyteti ruan të gjalla plot gojëdhëna. Në një territor të hapur zë vend kryesor lugina e Murrës e cila zgjatet në drejtim të Dibrës. Kjo luginë nga veriu komunikon me gryka të tjera që mbarojnë me pyje të dendura si Gryka e Gurrës dhe e Lukanit, kurse nga jugu me grykën e malit të Balgjajt, me grykën e malit të Kacnisë dhe me grykën e Selishtës. Pikërisht aty ku takohen Katër-Grykët e Murrës ngrihet në një lartësi të dukshme maja e kalasë ose kalaja e Shenepremtes, e cila ka shërbyer për vrojtim sikurse kanë shërbyer edhe Kurata, Mali i Dejës, Guri i Vashës, Qafa e Qytetas në Selishtë etj. Përveç tetrenit të thyer e të përshtatshëm malor që përkojnë me taktikën dhe strategjinë e përdorur nga Skënderbeu në luftë, ka edhe shenja të tjera si kala, kasha dhe varreza që tregojnë se grykat e Murrës kanë qenë shesh luftërash me turqit, kurse toponimet si "Kepi i Skënderbeut", "Gurra e Skënderbeut", "Dollapi i Skënderbeut", "Kroi i Skënderbeut", "Gjurmët e kalit në shkëmbin e Çetës në anë të Qafëmurrës", "Vorret e turkut" shoqërohen me plot gojëdhëna, të të urtëve popullor. Në Qafëmurrë thonë se qyteti i Varoshit ku lartësohet kalaja e Skënderbeut drutë për zjarr dhe ndërtim i merrte në Lis të Matit. Kjo është e çuditshme sepse vendi ku shtrihej qyteti i Varoshit sipas gojëdhënave sot është i rrethuar me pyje të

> Gojëdhënat janë krijime që burojnë nga muza popullore, nga shpirti i mençurisë dhe gjurmët e kujtesës, janë një dëshmi e qartë ku na pasqyrojnë ngjarje, figura, luftëra, ndodhi e mbi të gjitha lidhjen e Skënderbeut me popullin, me atdheun, na pasqyrojnë fisnikërinë dhe gjurmët e tij në Dibër.

dendura e shekullore, por vetë ai që tregon shton njëkohësisht se Skënderbu nuk lejonte të priteshin pyjet në periferi të qytetit, sepse ato i shërbenin për qëllime luftarake. Tregohet në Katër –Grykë se kur tradhtoi Hamza Kastrioti, Skënderbeu e dinte se ai dinte sekretin ku i udhëhoqi turqit deri tek Kepi i Kuq, i vetmi vend ky, prej ku mund të merrej kalaja e Sluçit. Skënderbeu e kuptoi se këtu kishte dorë tradhtia, u zemërua shumë dhe bashkë me të birin u detyruan të kalojnë në drejtim të humnerës për të dalë në Kepin e Çetës së Qafëmurrës. Skënderbeu kaloi menjëherë kurse i biri, ndonëse kishte marrë nga Skënderbeu kalin më të mirë, u rrëzua nga që i tërhoqi frerin kalit duke mos pasur parasysh kështu porosinë e t'et. Skënderbeu i zemëruar për disfatën mallkoi (nemti) të nipin Hamzanë për tradhtinë që bëri dhe të birin për pazotësi që tregoi dhe pastaj iku në drejtim të Çidhnës. Sipas kësaj gojëdhëne këto të dhëna kanë lidhje me ngjarjet e viteve 1456-1457, kur sipas historisë së shkruar, Hamza Kastrioti, mbasi tradhtoi Skënderbeun ndihmoi turqit për pushtimin e kështjellës së Krujës, të Albulenës, të Gurit të Bardhë dhe të Slluçit dhe prej këtu u kthye pastaj për në Albulenë për kremtimin e fitores sepse kishte menduar se Skënderbeu humbi përfundimisht.

Pa dashur të marr rolin e historianit, ne si studiues të folklorit e të krijimtarisë mjeshtërore të popullit ku hyjnë edhe gojëdhënat, sqarojmë se populli ka ndjekur me vëmendje fatin e qytetit të Varoshit mbas disfatës që pësoi si pasojë e tradhtisë së Hamza Kastriotit. Mbas pushtimit turk thuhet se varoshasit u shpërndanë në vende të ndryshme të Shqipërisë. Në vend qëndruan vetëm ata që gjetën strehë në luginën e fshehtë të Kacnisë dhe në Qafë të Dardhës qëndroi vetëm familja e Gjokës megjithëse kjo shtëpi e madhe e qytetit të lashtë ishte kundër Turqisë. Por një pjesë e qytetarëve të Varoshit kaluan jashtë kufijve të atdheut deri në Italinë e Jugut. Për këtë sjellim si argument tekstin e plotë të kësaj gojëdhëne të dëgjuar nga i urti Isuf Rustem Lala: "Shumë shqiptar për të përballuar kushtet e vështira të jetës në vitet e mëvonshme shkonin në kurbet. Rrugën e kurbetit mori edhe Xhafer Kaca nga Vinjolli i Matit, ngjitur me Qafëmurrën, i cili kur po kthehej në Shqipëri qëndroi disa ditë në mes shqiptarëve kalabrez të Italisë. Atje u takua me një plak të moçëm, i cili e pyeti: "A e keni larg qytetin e Varoshit? Aty sipas thënjeve të të parëve tanë, kur u larguam prej andej kanë fshehur sende me vlerë, prandaj sapo të kthehesh shko e kërko". Xhafer Kaca sapo u kthye në Vinjollë shkoi e kërkoi të gjitha shpellat e atij vendi dhe gjeti më në fund vetëm një ibrik sermi. Pas vdekjes së Xhaferit e trashëgoi i vëllai Haziz Kaca, i cili ua shiti disa kallajxhinjëve për tre napolona ar". Nga pleqtë e nderuar të Kastriotit si Sefedin Doçi, Selim Leshi, Bajram Skura kemi dëgjuar plot gojëdhëna për kalanë e Voles mbi Sohodoll, për kocinjtë e Skënderbeut që i mbanin si hajmali, se si Skënderbeu "para ka marrë Xhitetin në Arras mbas ka marrë istikamin e Xhitetit në Sinë, mrapa mori istikamin e Xharxhishtit ene hini në Xhogjaj".

Skënderbeu, ky legjendar i madh i historisë, ky vigan i thjeshtësisë e i guximit, ky hero i të gjithë breznive që kaluan, që janë e që do të vijnë, lartësohet i madhërishëm e i pamposhtur, lartësohet e gdhendet i paharruar e legjendar në mbarë shpirtrat e bijve të popullit shqiptar, veçanërisht në gojëdhënat e Dibrës, të cilat janë testament fisnikërie, testament i qëndresës dhe i luftërave, testament përjetësimi për brezat tanë.

intervistë

Libri u zbulua dikur në mes të vitit 1980 kur miku im Lars-Erik Morin, i cili është po ashtu përkthyes i gjuhës shqipe, e gjeti në një ankand në Stokholm

Skënderbeu, "sundimtari iluminist"

SHËNIM PËR LEXUESIT

Në median shqiptare u botua lajmi se ishte zbuluar një libër i ri për Skënderbeun. Në iu drejtuam me disa pyetje albanalogut Ullmar Qvick, mes të cilave, e pyesnim lidhur me faktin nëse ka ndonjë të dhënë në libër për Skenderbeun dhe a ka ndonjë lidhje të tij me Dibrën. Albanalogu u përgjigj:

"Faleminderit për interesimin tuaj. Ndërkohë që ju më shkruani, unë sapo kam dhënë një intervistë për z. Bujar Vitija në gazetën "Tribuna". Fatkeqësisht, lajmërimi për "zbulimin" e librit ishte i gabuar. Ju do të shihni në intervistë faktet.

Desha të shtoj se ju e keni lejen për ta botuar intervistën ose një përmbledhje të saj në gazetën tuaj. Dhe dua të shtoj se në faqen 8 të librit përmendet ardhja e Skënderbeut në Dibrën e Epërme, në vitin 1440. Autori thekson se banorët e Dibrës u gëzuan kur erdhi i biri i Prijësit të tyre, duke i premtuar përkrahje të plotë në luftë për të larguar turqit dhe për të shkatërruar pushtetin e Muratit. Përmenden edhe dy raste kur ai erdhi në Dibrën e Poshtme, me luftën e Dibrës që i solli Skënderbeut fitoren.

Dibra përmendet pra, dhe kjo sigurisht është me rëndësi.

Me të fala të përzemërta
Ullmar Qvick





Në foto: Ullmar Qvick. Djathtas, faksimile e kopertinës së librit

Nga **BUJAR VITIJA**

Në moshën 11-vjeçare, rreth viteve 1950 i kishte rastisur të dëgjojë muzikë popullore shqiptare. Kështu e kishte zbuluar Shqipërinë, e pastaj më vonë edhe Kosovën. Albanologu Ullmar Qvick, ka lindur në Kristinehamn, në rrethin e Vermlandës të Suedisë në vitin 1934. Ka 40 vite përvojë pune nëpër shkolla të ndryshme në vend, ndërsa nga viti 1999 është në pension, por vazhdon të merret me përkthime.

Shqipërinë e ka vizituar në vitin 1970, ndërsa 7 vjet më vonë për herë të parë vjen edhe në Kosovë, si pjesëmarrës në Seminarin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në Tiranë do të rikthehej përsëri në vitet 1978-79, 2004-05.

Për Qvick-un nuk janë të nevojshme vizitat e shpeshta fizike. Për të është e rëndësishme që nëpërmjet librave, radios e muzikës të krijojë udhëtimin shpirtëror në trojet shqiptare. Bukuria e natyrës e mikpritja e shqiptarëve janë përshtypjet e tija për Shqipërinë e Kosovën.

Në Krishtlindjet e vitit 1980, Qvick kishte marrë një dhuratë mjaft të veçantë nga bashkëshortja dhe miku i tij Lars-Erik Morin. Bëhet fjalë për një libër të shkruar në gjuhën suedeze nga një autor dalmato-malazez, Stefan Zanoviq, për historinë e heroit kombëtar shqiptar Skënderbeu dhe për ushtrinë shqiptare, "Den store Castriotto af Albanien kallad Scanderbeg – Historia" (Kastrioti i Madh i Shqipërisë i quajtur Skanderbeg - Historia). Qvick ka rrëfyer për këtë dhuratë, për përmbajtjen e librit, si dhe për të dhënat rreth autorit Stefan Zanoviq.

Kur dhe ku e keni zbuluar librin "Den store Castriotto af Albanien kallad Scanderbeg – Historia"?

- Libri u zbulua dikur në mes të vitit 1980 kur miku im Lars-Erik Morin, i cili është po ashtu përkthyes i gjuhës shqipe, e gjeti në një ankand në Stokholm. Ai dha një ofertë dhe fitoi. Libri u pagua nga bashkëshortja ime dhe unë e mora si dhuratë për Krishtlindje.

Çka shkruhet në këtë libër më konkretisht? Çka thuhet për Skënderbeun dhe shqiptarët?

- Libri u botua si vepër anonime në Stokholm në vitin 1788 nga Shtypshkronja e Anders Zetterbergut. Libri origjinal u botua frëngjisht dhe gjermanisht në të njëjtën kohë në vitin 1779, në Frankfurt dhe Paris, gjithashtu si vepër anonime. Suedisht libri përmban 120 faqe (173x100 mm).

Materiali i librit është marrë kryesisht nga libri "Historia e Skënderbeut" i autorit Marin Barleti nga fillimi i shekullit XVI, mirëpo në pjesën e fundit autori parashtron amanetin e Skënderbeut në bisedë me të birin, me siguri në përputhje me qëllimet e autorit.

Në libër shkruhet për luftën e shqiptarëve kundër ushtrisë osmane, për marrëdhëniet e Skënderbeut me aleatët vendas dhe të huaj, dhe në fund të librit jepet një vlerësim shumë pozitiv për vetitë personale dhe veprën e Skënderbeut. Libri thekson trimërinë e Skënderbeut dhe të ushtrisë shqiptare.

Na tregoni pak edhe për autorin, pse ka shkruar ai për Skënderbeun? A e ka vizituar ai Shqipërinë në atë kohë?

- U bë e njohur shumë herët se autori i librit ishte Stefan Zanoviq, një aventurier me burim dalmatin-malazez, i cili kishte përdorur mjete të dyshimta për të fituar nam dhe pasuri. Të dhëna për jetën e tij kam lexuar më përpara në burime shkencore shqiptare, një biografi u botua nga Pavel A. Rovinski në 'Montenegrina Digitalna Biblioteka'. Zanoviqi, si duket i lindur në vitin 1751, endej nëpër Evropë dhe në vitin 1769 u vendos në Vjenë. Ai kishte aftësi të madhe mashtrimi; u paraqit si "princ shqiptar" nga fisi i Skënderbeut! Në disa qarqe u prezantua si prift ortodoks. Ai fitoi një farë pozite në oborrin e Perandorit Josef II, dhe libri i tij fillon me një dedikim pangjirik ku fjalët e fundit tingëllojnë: "Ah, trashëgimtar i denjë i titujve të Qesarit, i virtyteve të Tij! Vetëm mos harroni se ju jeni APOLO, Kujdestari i shekullit tonë, ndërsa unë Klearku (Clearc- kuptimin?) i cili ju ofron frytet e dhuratave të tij, pa asnjë pretendim tjetër se sa t'i jap Perandorit atë që i përket atij, kur ju jap si flijim Virtytet e SKËNDERBEUT. Me atë jam i kënaqur në mes të dështimit tim, në mes të halleve të mia!"

Interesimi i Zanoviqit për Skënderbeun kishte qëllime egoiste, për të fituar një pozitë në një nga oborret e Evropës, në plan të parë në Austri. Si duket ai nuk vizitoi asnjëherë Shqipërinë. Pa pasur sukses në Vjenë, Zanoviqi shkoi në Gjermani dhe Poloni, dhe pastaj në Rusi, ku ai u dënua me 5 vite burgim (1783-1788) për arsye të tregtisë me monedha të falsifikuara. U kthye në Evropën perëndimore, ku ai u vendos në Holandë në gjendje shumë të vështirë ekonomike dhe morale. Atje bëri vetëvrasje.

Botimi i librit suedisht mund të arsyetohet si një përpjekje për të interesuar mbretin Gustav III (1746-1792) për librin dhe autorin. Në atë kohë ishte e përhapur në Evropë ideja e "sundimtarit iluminist", në përputhje me përshkrimin e Skënderbeut që na jep autori: Një sovran i cili trajton me dyshim dhe kujdes priftërinjtë dhe aristokracinë, duke u mbështetur te populli. Kjo ide pa tjetër kishte mbështetje te Mbreti Gustav III, i cili në vitin 1789, viti i Revolucionit Francez, shkatërroi aristokracinë suedeze! Mbreti u vra nga aristokrati i pakënaqur Jakob Johan Ankarström në vitin 1792. Libri i Zanoviqit pra kishte aktualitet të madh në Suedi! Dhe mund të ju tregoi se i biri i Gustav III, Gustav IV Adolf, i cili u largua nga froni në 1809, më vonë u takua në Janinë me Ali Pashë Tepelenën.

> Në faqen 8 të librit përmendet ardhja e Skënderbeut në Dibrën e Epërme, në vitin 1440. Autori thekson se banorët e Dibrës u gëzuan kur erdhi i biri i Prijësit të tyre, duke i premtuar përkrahje të plotë në luftë për të larguar turqit dhe për të shkatërruar pushtetin e Muratit. Përmenden edhe dy raste kur ai erdhi në Dibrën e Poshtme, me luftën e Dibrës që i solli Skënderbeut fitoren.
> Dibra përmendet pra, dhe kjo sigurisht është me rëndësi.

Fakti se Stefan Zanoviq ishte aventurier dhe mashtrues, nuk ka qenë me rëndësi për sa i përket vlerës së librit të tij për Skënderbeun. Në këtë vepër – në saje të materialit burimor në librin e Barletit – ai vizaton një pamje përgjithësisht të drejtë dhe pozitive të luftës së Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane. Duke qenë se libri u botua në disa gjuhë u rrit interesimi për luftën e Skënderbeut dhe për gjendjen e popullit shqiptar në Evropë. Dhe autori i librit – për lexuesin e rëndomtë – mbeti anonim. Aventurat e Zanoviqit nuk kishin ndikim në atë aspekt!

A është ky libër kontakti i parë i suedezëve me shqiptarët, apo ka pasur kontakt edhe më herët?

- Profesori suedez Hans Erik Tunman veproi në universitetin e Hales në Gjermani. Atje u takua me Konstandin Xhehanin nga Voskopoja, i cili kishte ndjekur studime universitare në Angli dhe Holandë. Me ndihmën e Xhehanit dhe me fjalorin e Kavaliotit, Tunmani përpiloi një studim rreth prejardhjes së popullit shqiptar dhe gjuhës shqipe, i botuar në vitin 1774, në të cilin vuri në dukje prejardhjen e lashtë të tyre.

A e keni përkthyer në gjuhën shqipe?

- Nuk kam dëgjuar për një botim shqip të librit anonim të Zanoviqit.

Ku gjendet kopja origjinale e tij dhe a ka pasur ndonjë interesim nga institucionet e Kosovës për këtë libër?

- Nuk jam i inkuadruar në institucionet universitare – akademike në Suedi, por nuk kam dëgjuar për asnjë interesim nga ana e institucioneve të Kosovës për këtë libër ose për marrëdhënie kulturore me Suedinë në përgjithësi, përveç angazhimit të MASHT-it në lëmin e arsimit. Sigurisht duhet të zhvillohen këto marrëdhënie, sepse kemi rreth 50.000 shqiptarë nga Kosova në Suedi, dhe marrëdhëniet kulturore janë me rëndësi të madhe.



Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com



Rruga e Arbërit nr. 93

Riza Tefik Dibrani , ky filozof dhe mendimtar i madh sado që të gjithë jetën e kaloi jashtë atdheut, kryesisht në Turqi dhe në vende të tjera, asnjëherë nuk e harroi vendin e tij.

portret

Riza Tefik Dibrani

Nga **XHELAL ROÇI**

Riza Tefiku ishte njeri me figurë të pastër, i matur, me edukatë dhe kulturë të gjerë, kishte një mënyrë të shkëlyqyer për të komunikuar me njerëz. Ai dinte t'i ndërtonte marrëdhëniet me ta në mënyrë të shkëlqyer. Kjo bëri që shumë shqiptar të afroheshin me Klubin e Stambollit, të simpatizonin e aktivizoheshin me detyra dhe pse jo edhe disa me ndihma e mjete financiare.

(Vijon nga numri i kaluar)

Një libër i shkurtër biografik i shkruar më 1912, kur ai ishte 44 vjeç titullohet "Filozofi Riza Tefiku". Shpesh emrit të tij në turqisht i shtohej edhe një tjetër, Riza Tefik Bilikbashi. Riza Tefiku përktheu mjaft artikuj të filozofëve të tjerë perëndimor në gjuhën turke.

Filozofinë ai e studionte për t'i vlejtur për jetën dhe për aktualitetin, si mjet për të ndihmuar praktikën dhe për t'u dhënë zgjidhje problemeve që shtronte koha e jeta. Riza Tefiku është përpiluesi në osmanishte i fjalorit të filozofisë me dy vëllime, prej të cilëve ai botoi vetëm vëllimin e parë prej 1200 faqesh. Por po t'i shtojmë faqet e veprave të tjera filozofike si ligjëratat filozofike, historinë e filozofisë, filozofinë e Omer Khajamit, Avdulla Hamitit dhe shënime filozofike, një dorë shkrim mbi estetikën, ata që ai ka shkruar mbi moralin e të tjera, ai nuk mbetet pas Sami Frashërit për prodhimtari shkencore që kapin 3000-4000 faqe.

Në gjurmët e të atit të tij Mehmet Tefikut eci dhe i biri i tij Riza Tefiku. Ai u bë pedagog i filozofisë në Universitetin e Stambollit dhe pedagog i letërsisë turke në këtë universitet, më vonë shef i katedrës së letërsisë turke dhe profesor i kësaj lëndë në universitetin e Kajros në Egjipt. Rizai nuk e ndau asnjëherë letërsinë nga filozofia dhe anasjelltash.

Rizai kishte kulturë të gjerë, të cilën e fitoi në sajë të punës së tij vetëmohuese. Për këtë dëshmojnë mijëra faqe të hedhura në letër dhe të pabotuara. Si njeri me prirje demokratike e përparimtare ai kërkonte përparimin e gjithë shoqërisë, por në të njëjtën kohë ai ishte i bindur se kjo nuk mund të arrihej, pa arsim, pa kulturë e pa shkolla.

Riza Tefiku këmbëngulte se të gjithë duhet të mësojnë. Kur në vitin 1919 në fakultetet e drejtorisë së universitetit të Stambollit shkuan për të mësuar për herë të parë vajza, Riza Tefiku shprehu gëzim të papërmbajtur. Ai shprehu entuziazmin e vet, duke u vënë në armiqësi të hapur edhe me ndonjë personaltiet konservator të kohës. Universiteti, deklaronte atëherë Riza Tefiku, është si një mollë, ku gjysma janë djem e gjysma vajza, në qoftë se neve e ndajmë këtë mollë do të prishet bukurija dhe shija e saj, prandaj mollën duhet ta ruajmë të pandarë. Fitorja e revolucionit demokratiko borgjez në Turqi i udhëhequr nga Mustafa Qemal Ataturku e detyroi Riza Tefikun të arratiset jashtë Turqisë dhe të qëndrojë për afër 20 vjet si i përndjekur nga regjimi i ri. Kuptohet se kjo bëhej edhe në kudrin e asaj lufte që u bëri Mustafa Qemal Ataturku bektashinjve. Gjatë kohës që isthe jashtë Turqisë Riza Tefiku u largua në Egjipt dhe punoi në universitetin e Kajros. Më 1 nëntor 1922 Mexhlizi Turk miratoi aktin për heqjen e Sulltanatit, që ishte një veprim i rëndësishëm që krijonte pakënaqësi në shumë shtresa shoqërore të popullsisë turke. Më 29 nëntor 1923, Mexhlisi e shpalli Turqinë Republikë. Mustafa Qemal Ataturku luftoi me vendosmëri jo kundra fesë myslimane për çka është akuzuar nga kundërshtarët e tij, por kundër Turqisë së Sheh Ul Islamit. Masat që mori edhe kundër sektit fetar Islam, Bektashizmit qenë të ashpra sa që më vonë e detyruan kryegjyshatën Botërore të Bektashizmit të largohet nga Turqia, të vijë në Shqipëri dhe të vendoset në Tiranë. Kjo qe një nga shkaqet që Riza Tefiku u detyrua të mërgojë jashtë shtetit në Kajro të Egjiptit dhe në Siri.

Më 1924 kur erdhi në fuqi Fan Noli në Shqipëri, Riza Tefiku ishte larguar nga Turqia dhe ishte në Siri. Noli dëshironte të krijojë një akademi të shkencave dhe një nga të cilët që do të thërriste ishte Riza Tefiku. Standardet shkencore të të cilit Noli i dinte, sepse ai e njihte fare mirë atë, vetë. Edhe në Siri apo Egjipt, sikurse në Stamboll, ai nuk e ndërpreu korrespondencën me shqiptarët mëmëdhetarë. Riza Tefiku i edukoi të dy djemtë e tij, që rrojnë deri sot me frymën e shqiptarizmit dhe të atdhetashurisë. Riza Tefiku ka shkruar disa artikuj në Librin Shqiptari i lustruar që nxirrej nga Dervish Hima. Në numrin e vitit 1911, në këtë libër, përveç parathënies janë tre shkrime për lëvizjen kryengritëse Shqipëri, me tituj respektivisht; "Ngjarjet e fundit në Shqipëri", "Ngjarjet e Lumës", "Kryengritja e malësisë së Shkodrës". Ky i fundit ishte shkruar nga Hasan Prishtina. Nga pozita patriotike ishin hartuar dhe jetëshkrimet e Abedin Pashë Dinos, Rexhep Pasha Matit, nga Dervish Hima dhe hoxhë Tahsimit nga Filati nga Riza Tefiku nga Dibra. Libri mbante gjithashtu poezi shqipe të poetëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në të gjitha këto shkrime u bëhej jehonë të kaluarës historike të popullit shqiptar, traditës së tij patriotike dhe qëndresës kundër sundimit osman. Ata ishin tinguj aktual, një lloj thirrje që u bëhej shqiptarëve për të ecur në vazhdën e të kaluarës e për t'u hedhur në luftë për çlirimin e atdheut nga pushtuesit e huaj. "Shqiptari i Lustruar" nuk pati jetë të gjatë për shkak të censurës së qeverisë osmane *(Libri monografi "Dervish Hima" f. 222, shkruar nga Kristaq Prifti).*

RIZA TEFIKU – BEKTASHI

Kur u kthye përsëri nga emigrimi në Turqi, si i falur, Riza Tefiku, duhet të ishte viti 1943. Ai ishte plakur shumë. Pasi u qetësua për disa kohë, filloi të shkruajë artikuj kulturorë dhe vjersha për gazetat dhe revista të ndryshme të Stambollit. Nga pikëpamjet e ndërgjegjes, Riza Tefiku gjeti si të përshtatshme për shpirtin e tij, bektashizmin, sekt i festë myslimane. Ai mori dorë për dritën e bektashizmit nga Edip Harabi Babai, gjë të cilën e shpjegon vetë në një vjershë kushtuar Harabiut. Vjersha është kjo:

Nga bot' e njëtimit gjë s'kisha kuptuar
I përgjumur botës, adrimit i hyra... *(Vazhdo në faqet 283-290 të librit "Misticizmi Islam dhe bektashizmi", shkruar Baba Rexhepi).*

Ai vazhdoi me besnikëri rrugën e bektashizmit dhe në të arriti të bëhet e të titullohet "Baba". Ky ishte një moment tjetër që duhet të ndriçojnë raportet e tij më përpara për rënie në pozitat e ateizmit, për "Volterjanizëm". Një gjë e tillë nuk ka qenë e vërtetë. Sigurisht fetar dhe injorancës. Megjithatë bashkëkohësit e tij theksojnë, se ai ka qenë një bektashian i mirë. si dibran që ishte dhe dihet se bektashizmi ka rrënjë të thella në tokën e Dibrës, e në veçanti në Dibër të Epër Zerqan, ai iu kushtua këtij sekti tolerant dhe ndaj dijes dhe shkencës. Edhe i ati i tij, Mehmeti, i përkiste sektit fetar bektashi, ishte një nga brezat e tij për Dibrën dhe tradicionalisht në qytetin (Shehërin) e Dibrës së Madhe, njerëzit e fisit të Rizait kanë qenë shumë të kulturuar. Sipas një burimi tjetër, një i afërt i tij, Baba Shabani dhe ek isthe teqenë e vet në qytetin e Dibrës së madhe.

Sipas konsullit italian të Manastirit, Bernardi, seanca e fshehtë e krerëve shqiptarë që mori pjesë në kongresin e Dibrës, në muajin korrik 1909 ku u morën vendime, atdhetare për kombin shqiptar me rëndësi dhe që iu imponuan këtij kongresi që ishte organizuar nga Xhon Turqit, u zhvilluan punimet në teqenë e Baba Shabanit, të Riza Tefikut. Si gjithmonë teqetë dhe baballarët e tyre kanë qenë vatra të shqiptarizmit. As teqja e Dibrës nuk bëri përjashtime në këtë drejtim. Edhe vetë Rizai nuk bëri gjë tjetër, veçse eci në gjurmët e të atit të tij. Në këtë drejtim. Ai kishte parasysh edhe shembullin e vëllezërve Frashëri e në mënyrë të veçantë të Naimit. Sikurse Naimi, veçse me një ndryshim, ai krijoi poema fetare bektashiane në gjuhën turke me subjekt të vjetër nga historia e islamit.

Me sa na thotë Gordlervskij, Rizai, ka bërë dhe një studim të botuar në serinë e veprave të tij. "Në kujtim të E. Gibb, historian i njohur anglez i poezisë osmane, i cili thotë se disa nga poetët futen një origjinalitet në poezinë osmane, turke, sepse ishin shqiptar domethënë, evropian. Kjo vlen dhe për poezinë që u zhvillua në teqet e tarikateve të ndryshme që mbatne një vulë të posaçme. Në këtë hulli janë edhe poemat apo poezia e Riza Tefikut me karakter fetar bektashian.

Shqiptarëve u ka pëlqyer poezia, folklori i lashtë i vendeve të lindjes, sidomos ai i botës arabe, kjo ndoshta se i bashkonte feja e përbashkët, islamizmi. Ata kanë lëvruar në një alrmi të pashoqe gjinishë. Këtë e dëshmojnë këngët legjendare dhe ata historike... Po citojmë disa përfaqësues të kësaj periudhe që përbëjnë një masë të konsiderueshme, në tërësinë e botës intelektuale shqiptare të botës. Ata janë mendimtarë, poetë, burra shteti, teologë, filozofë etj.

Këtu bëjnë pjesë disa, si Musa Qazimi Pashai 1821-1889, Adem Verxhi Babai 1841-1927, Abedin Pashë Dino, naim Frashëri, Sami Frashëri, Selim Ruhi Babai, dr. Riza Tefiku, Baba 1866-1949. Baba Hamzai 1922-1932. Këto shkruan poezi, divane etj. Marrim vetëm një shembull Abedin Pashë Dinon, anëtar i Komitetit të Stambollit, 1878, si dhe anëtar i kryesisë së Lidhjes Kombëtare Shqiptare të Prizrenit. Ky mori pjesë edhe në Kuvendin e Dibrës.

... Intelektualët shqiptarë të kësaj periudhe filluan të njihen edhe me letërsinë perëndimore, sidomos me literaturën franceze. Në Paris të Francës studio Hasan Tahsimi, Sami Frashëri, Abedin Pashë Dinoja.

Riza Tefiku e të tjerë përkthenin literaturë dhe shkruanin në gjuhën frëngjishte. (Libri Panteoni iralian, autor Shefik Osmani, f. 81).

... Kongresi i Dibrës datë 24 korrik 1969, që u bë në shtëpinë e Shaban Dedës, Teqenë e Baba Shabanit. Këtu u vendos që bisedimet të vazhdojnë... do të shkruante Haki Stërmilli në librin e tij Dirba në Prag të historisë i mbetur dorëshkrim.

Mësuesi Haki Sharofi në kujtimet e tij "Historia e Dibrës" shënon... Teqet bektashiane u bënë çerdhe ku predikonin luftën kundër sulltanatit të Turqisë. Kështu në Dibër, bektashizmi kishte fuqi dërrmuese në popull.

Baba Fejza, ose sheh Fejzë Bulqiza luftoi e rezistoi kundër Turqisë por e zhduku sulltani. Riza Tefiku i dërgonte një letër Kongresit Bektashian në Tiranë dhe ndër të tjera i thoshte: "Se misioni politik i bektashinjve tash ka marrë fund, me qenëse sulltanati osman ka rënë nga fuqia... Për këtë letër, autori Haki Sharofi i referohet Zija Shkodrës...

Ke xhamia në Dibër të Madhe ka pas edhe një teqe tjetër, shënon Haki Sharofi, edhe kjo duhet të ketë qenë teqe bektashiane.

Riza Tefiku, vazhdon Haki Sharofi, zotëronte tetë gjuhë të huaja të vjetra dhe të reja. Riza Tefiku ishte një figurë shumë e madhe, ne kemi shkruar shumë shkurt, sepse kemi pak materiale në dorë, nga ata që thuhen për të. Këtë person të madh e bëjnë veprat e tij. Ky ndikoi shumë në përhapjen e bektashizmit në sferat e njerëzve të dituri intelektual, për faktin se bektashizmit në sferat e njerëzve të ditur intelektual, për faktin se vlerësohej shumë si filozof, si shkrimtar, si politikan e të tjera.

Ky kolkoz me gjak shqiptari, i shërbeu fesë islame, sektit të bektashizmit, interesave të atdheut dhe të kombit shqiptar për kohën në radhët e emigrantëve shqiptarë dhe gjithë njerëzimit duke lënë edhe vepra shumë të rëndësishme. Ndër ta përveç artikujve, vjershave, studimeve e të tjera të botuara në gazeta janë dhe librat:

1 – Të gjitha vjershat e tij janë të përmbledhur në një volum që titullohet "Serabi Umrun". Rrjedha e jetës time, përkthehet në shqip, shtypur për herë të parë në Qipro 1934 dhe për të dytën herë në Stamboll më 1949.

2 – Abdul Hak Hamidve Muhahazati felsefijesi dhe përkthehet Abdyl Hak Hamidi dhe mendimet e tij filozofike shtypur 1913.

3 – Felsefe Dersleri, përkthehet Mësimet filozofike, shtypur 1914.

4 – Myfesal Kamusi felseferi, përkthehet fjalori me hollësi i filozofisë në dy volume të trasha, shtypur më 1914.

5 – Rubaiyjati Hayam të përkthyera nga persishtja në turqisht në bashkëpunim me profesor Hysen hanishin shtypur 1922.

Në vitin 1948 në gazetën "Jeni Sabah" (Mëngjesi i ri) shkroi kujtimet e tij me titull "Të flas pak dhe unë".

Përveç këtyre ka dhe shumë vjersha dhe artikuj kulturor me vlerë që ka botuar nëpër gazeta dhe revista letrare të vendit. Vjershat dhe veprat e tij nefese, ose në ritmin e ligjit poetik, mbeten një kohë të gjatë një kujtim i gjallë në popull, që i këndonte me zell të madh.

Ky filozof dhe mendimtar i madh sado që të gjithë jetën e kaloi jashtë atdheut, kryesisht në Turqi dhe në vende të tjera, asnjëherë nuk e harroi vendin e tij. Atdheun e tij, popullin e tij, ai në biseda dhe në shkrimet e tij do të shënonte gjithmonë se i ati ishte shqiptar, nga dibra dhe ai krenohej kur nëpër biseda e nëpër takime i përmendin emrin ose i shënonin emrin Riza Tefik Dibrani.

Me biografinë e këtij njeriu të madh janë marrë pothuajse studiues nga e gjithë bota. Për këtë kanë shkruar shumë veta nga shumë vende, sepse ai ishte i njohur kudo, ai kishte shëtitur shumë vende të botës, por të njohur e bënin veprat e tij. Sidomos pas vdekjes së tij, në dhjetor 1949, shkrimtarët turq u morën shumë me jetën edhe me veprat e tij, duke shkruar vepra të posaçme për të. Nga këto shkrimtarë si Ilmi Jacebash i cili ka botuar posaçërisht një libër për filozofinë Riza Tefiku prej 230 faqesh të titulluar: "Hajati Eserli se Halivalarin që përkthehet, Riza Tefiku, jeta, veprat dhe kujtimet e tij", botuar më 1956, në Stamboll. Nga ky libër janë marrë pjesë të biografisë së tij.

Shkrimet e tij në kohën e "Hyrjetit" kanë shkruar në vjersha e në prozë, kritikat dhe fjalët e tij në vitet 1908-1910 tërhoqën vëmendjen e të gjithëve, në veçanti të emigrantëve shqiptarë që ishin atje, ata hynin deh aktivizoheshin për të kryer detyra në organizatën e re kulturore që ishte formuar në Stamboll. Për disa kohë shkroi artikuj në revistën "Maalumat" (njohurime).

Riza Tefiku ishte njeri me figurë të pastër, i matur, me edukatë dhe kulturë të gjerë, kishte një mënyrë të shkëlyqyer për të komunikuar me njerëz. Ai dinte t'i ndërtonte marrëdhëniet me ta në mënyrë të shkëlqyer. Kjo bëri që shumë shqiptar të afroheshin me Klubin e Stambollit, të simpatizonin e aktivizoheshin me detyra dhe pse jo edhe disa me ndihma e mjete financiare.

Rizai u kthye në Turqi, pas vdekjes së Mustafa Qemal Ataturku rreth vitit 1943 dhe vdiq në dhjetor 1949 në Stamboll. Vdekja e tij ishte një humbje e madhe jo vetëm për familjen e tij, të afërmit, për shkencën dhe kulturën në shkallë botërore por edhe për Kombin Shqiptar i cili nuk pushoi së punuari për të qartësuar shqiptarët në mërgim.

Kujtimi i tij qoftë i paharruar. Kujtimin e tij po e mbyllim me këtë copë vjershë të tij të fundit:

"O Riza! Ti falu, bënë përmendimin!
Të t'shoqërojn;' dhe gurët n'atë hidhërimin
Fola, shum' dëgjo tash ç'është përfundimi
E shkruar e ndritur fantazi kish qenë!"

Shkruar nga Hilmi Juxhebash! Stamboll, më 16 tetor 1956. *(Libri i Baba Selim R. Kalicani, Historia e Bektashizmit si sekt mistik islam. Hasan Kaleshi, vepër e cituar 35-36. Baba Rexhepi, vepër e vituar).*

Materiale të shfrytëzuara:
- Baba Rexhepi , "Misticizma Islame dhe Bektashizma"
- Baba Selim R. Kalicani, "Historia e Bektashizmit si sekt mistiko Islam"
- "Dibra dhe Etnokultura e saj", vëllimi i dytë
- Hasan Kaleshi: "Kontributi i shqiptarëve në diturinë islame"
- Shefik Osmani: "Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë", shkruar nga
- Gazeta "Rilindja", Kosovë.
- Sejfi Vllamasi: "Ballafaqime politike në Shqipëri, viti 1897-1942"
- Kristaq Prifti: "Dervish Hima"
- Haki Stërmilli: "Dibra në prag të historisë"
- Materiale e tjera në muzeun Historik të Dibrës.
- Kujtime gojore nga Sheh Besimi – Besim Shehu, Peshkopi

FUND

Pjesa e parë dhe e dytë e këtij shkrimi është botuar në Nëntor dhe Dhjetor 2013.

Allajbegu, trajneri që fitoi padrejtësitë

Humb jeten njeriu i forcës, i taktikës dhe dijes së mundjes e sporteve të tjera, legjenda e gjallë, që për një kohë të gjatë do të jetë në kujtimet e sportistëve, dibrani që brenda jetës së tij nxori kampion shqiptar nga Shkupi e Prishtina, deri në fitimin e medaljeve të lojrave olimpike. Për këtë gjeni e legjëndë të sporteve, kujtimi do të jetë i paharueshëm si për dibranët e tij të dashur, por edhe për sportistët e tij, që me të mburren e janë krenar që e patën për trajner Mentaz Allajbegun, njeriu që me dijen dhe shkathtësinë e tij, sfidoi kohën duke mos iu nënshtruar politikanëve. Ai në emër të emblëmës së sportit, ngriti lartë imazhin e sportistit shqiptar në Maqedoni e ish-Jugosllavi. I paharueshëm qoftë kujtimi për të. Jam krenar që viteve të fundit pata mundësinë të rri më afër me të. Rrugën dhe deshirën e tij për bashkim kombëtar, sigurisht që do ta vazhdojne sportistvt e tij dhe njerëzit që ndejtën afer me të. LAVDI!

(Nga shënimi në FB i gazetarit Atli Dema. Kush ishte Mentaz Allejbegu? Për lexuesin po ribotojmë një portret të tij, marrë nga revista "SHENJA")



Foto: © Gani Kosumi

Nga **Hajrush MANI**

Profesori i nderuar nuk dëshiron të flasë shumë për të kaluarën e tij, nuk është shumë i pasionuar as të jetë fytyrë publike dhe atë nuk e shohim duke dalë para kamerave dhe fotoaparateve që të eksponohet.

Duke jetuar në një barakë mes qyteteve të Dibrës dhe Strugës, Allajbegu po kalon jetë të qetë në pleqëri. Është po ai i para 40 viteve, përveç se tani i sëmurë, por me të njëjtin stil, duke mos shkurtuar as mustaqet që i mban gjatë kohë, të cilat nga të zeza janë zbardhur që të tregojnë se pleqëria ka trokitur edhe në derën e tij tanimë në moshën 65 vjeçare.

GATIMI I BRUMIT TË RI FILLOI NË SHF "7 MARSI" NË SHKUP

Tani duke jetuar larg Shkupit, profesori i nderuar Mentaz Allajbegu tregon se ka disa arsye që e kanë shtyrë atë të jetë banor në mes të Dibrës dhe Strugës. Duke ndjerë dhimbjet e pleqërisë, kërkoi ajrin më të pastër në një ambient natyror. Ndërkaq baraka ku ka gjetur strehim, i është dhënë si dhuratë nga shkolla "7 Marsi" (ish-shkolla "Dame Gruev"), ku dhe për herë të parë filloi të punojë si arsimtar dhe ku Allajbegu krijoi seksionin e mundjes dhe të sporteve të tjera. Kampioni i parë që doli nga kjo shkollë ishte 15-vjeçari Ekrem Sulejmani, i cili u shpall kampion i ish-Jugosllavisë për të rinj në vitin 1966. Prej viteve të 70-ta Arsimtari, Mentaz Allajbegu, do të punon në klubin e mundjes "Skopje" së bashku me trajnerin Risto Takov, për të cilin thotë se ishte një parazit që nuk bënte punë. Është ky viti kur nxënësit e Mentaz Allajbegut do të bëhen shtylla kryesore e klubit "Skopje" (Mik-u dhe Metalurgu i dikurshëm), në të cilin ai kishte bërë hapat e para si trajner i mundjes.

Ky klub në pesë vitet e ardhshme do t'i rrëzojë nga froni ekipet e paprekshme – "Ballkanecin" dhe "Vardarin", të cilët që nga viti 1962 vazhdimisht kishin ndërruar vendet e kampionit shtetëror. Në atë kohë Allajbegu, si çdo i ri, detyrohet ta kryejë shërbimin ushtarak, ndërsa pas kthimit nuk kishte më vend në SHF "7 Marsi", andaj punësohet në SHF "Liria", ku do të hapë 9 seksione të sportit, si: mundja, basketbolli, hendbolli, futbolli dhe sporte të tjera. Trajneri Allajbegu punën e tij nuk e kishte orientuar vetëm në një drejtim. Ai punoi shumë edhe në sportet tjera, siç janë gjimnastika, shenjëtaria, atletika, ping-pongu, ndërsa kur nxënësit kishin pushime verore, ai arrinte që të organizonte kampingje në Liqenin e Ohrit në Ohër, në Strugë dhe në Prespë, që kështu fëmijët ta mësojnë edhe notin. Në kohën e komunizmit ka qenë rregull e pashkruar që dikush të mbjellë e tjetërkush të korrë. Në shkollën fillore "Liria" gatuhej e piqej "buka", të cilën pastaj e "shiste"dhe "hante" tjetërkush. Në vitin 1983 trajneri Mentaz Allajbegu do të largohet nga Shkupi dhe do të shkojë në Prishtinë, ku po ashtu do të punojë si trajner në Klubin e Mundjes "Prishtina" dhe ku po ashtu do të arrijë rezultate të mrekullueshme.

KLUBET KU KONTRIBUOI MENTAZ ALLAJEBGU

Në vitin 1977 u formua Klubi i Mundjes "Liria" dje Klubi i Basketbollit "Liria", ku trajneri kishte dhënë kontribut të veçantë, sepse ato gjenerata që ai i udhëhoqi, pastaj u rritën dhe ishin bërthama të klubit, të cilët arritën të mbajnë cilësinë dhe aftësitë e tyre tekniko-taktike për ta zhvilluar garën dhe për të bërë rezultate. Me ardhjen e trajnerit të njohur Mentaz Allajbegu në postin e trajnerit të Klubit të Mundjes "Prishtina" nga Prishtina, filloi edhe puna e mirëfilltë e Federatës së Mundjes së Kosovës, të cilin Allajbegu arriti ta themelojë me punë dhe mund të madh. Përveç që ishte trajner i këtij klubi, Allajbeu rregullisht shkonte edhe në vende të tjera të Kosovës, ku punonte me trajnerët e klubeve të tyre. Kështu shumë shpejt mundja nisi të zhvillohet jo vetëm në Prishtinë, por edhe në Prizren, Mitrovicë, Han të Elezit, Vushtrri, Ferizaj, Skenderaj dhe Dragash.

SPORTISTËT E ALLAJBEGUT QË BËNË FAMË NË BOTË

Shaban Sejdiu (i shpallur sportist i vitit 1977 në ish-Jugosllavi, Shaban Tërstena (i shpallur sportist i vitit 1984 në ish-Jugosllavi), janë ata që sollën famën e mundjes së ish Jugosllavisë, ndërsa Abdulla Memeti, Bajram Qerolli dhe disa të tjerëve nuk iu dha mundësia që të marrin pjesë në gara, gjë për shqiptarët paraqet humbje, sepse ashtu atyre nuk iu lejua të bëhen figura të mëdha të sportit. Në Evropë ka ndodhur ajo që deri më tani më nuk është përsëritur, pasi që vetëm në moshën 18-vjeçare Shaban Sejdiu do ta fitojë medaljen e artë në kampionatin Evropian në Bursa, ndonëse kundërshtarët e tij ishin të gjithë mbi 20 vjeç. Pastaj vijnë edhe sukseset e Shaban Tërstenës, i cili edhe sot njihet si sportisti më i suksesshëm shqiptar. Ai ka arritur të fitojë medaljen e artë në lojërat olimpike të vitit 1984 në

Të shkruash për kolosët e sportit është një ndër detyrat më të vështira, pasi ata janë që japin shumë për shtetin, kombin dhe shoqërinë, ndërsa harrohen shumë shpejtë, saqë nuk na kujtohet se vallë nëse janë dhe gjallë. Një prej atyre që shkriu veten për shumë arritje sportive dhe sportistë, pa dyshim se është trajneri më i mirë i të gjitha kohërave te shqiptarët, Mentaz Allajbegu.

Los-Anxhelos të SHBA-ve, si dhe të jetë fitues i medaljes së argjendtë në LO 1988 në Seul. Ai është kampion evropian i vitit 1984 dhe 1990, si dhe fitues i shumë titujve tjerë.

Trajneri Allajbegu në kohën e fundit ka stërvitur edhe kik-boksierët që fituan tituj botërorë, siç janë Mirdi Limani, Albert Selimi dhe Azem Maksutaj. Këto ishin rezultatet më të mëdha të trajnerit Allajbegu i cili gjatë kësaj periudhe punonte si vullnetar, duke punuar pa asnjë kompensim material.

MAQEDONIA DHE KOSOVA E HARROJNË ALLAJBEGUN

Ndërkohë Mentaz Allajbegu, trajneri më i madh shqiptar i mundjes, bën një dallim interesant se si është ndihmuar sporti në të kaluarën edhe nga individët. Ai tani ka mbetur pas asnjë ndihmë të shtetit, megjithëse prej viteve të '70-ta sukseset më të mëdha në sportin e mundjes shqiptare i dedikohen pikërisht atij. Allajbegu gati 10 vite është jashtë sportit, por nuk e harron kohën "e artë". Por, deri tani as Maqedonia e as Kosova nuk ka ndarë asnjë ndihmë për trajnerin Allajbegu. Megjithëse ai nuk ka lënë pa falënderuar individët që kohë pas kohe e takojnë, e nderojnë dhe e përshëndesin për të arriturat. Trajneri Allajbegu në fund të takimit na tha se tani nga e gjithë kjo periudhë i ka mbetur vetëm kënaqësia shpirtërore, që e bën të jetojë dhe të kënaqet me rezultatet e së kaluarës, të cilat në asnjë mënyrë nuk do të kishte arritur t'i blejë edhe sikur të donte.

(Profili për tashmë të ndjerin, Mentaz Allajabegu, është botuar para dy vitesh në Revistën SHENJA)

Lamtumirë Lik Berisha!

Nga **Halil RAMA**

Miq dhe shokë nga Peshkopia, Tirana, Durrësi dhe nga e gjithë Shqipëria i dhanë lamtumirën e fundit mësuesit të mirënjohur Lik Berisha.

Ai, ndërroi jetë, krejt papritur, nga një trompozë, më 9 janar 2014. Kjo ikje e papritur, e bëri më të thekshme dhimbjen e madhe për të, jo vetëm për familjen dhe të afërmit e tij të dashur, por për të gjithë ata breza nxënësish që ai kish mësuar në Peshkopi, Muhurr, Luzni, Gjoricë, Tiranë etj.., për të gjithë kolegët, pedagogët, intelektualët, me të cilët ai kish punuar.., për të gjithë të njohurit e tij të shumtë si në Dibër, në Tiranë e kudo.

Ai lindi në Fushë-Muhurr me 1945, në një familje me tradita të njohura patriotike. Si arsimin bazë në vendlindje, ashtu dhe të mesmen pedagogjike në Peshkopi dhe Institutin e Lartë për matematikë në Shkodër, i përfundoi me rezultate shumë të mira. Qysh në moshën e rinisë, me gjithë vështirësitë e panumërta ekonomike të familjes, tek ai spikati zelli dhe vullneti i madh për shkollën, për librat dhe dituritë.

U formua si intelektual dhe shërbeu si i tillë me devotshmëri në sektorë të rëndësishëm. Si një nga intelektualët e shquar dibranë, Lik Berisha edukoi dhe përgatiti breza të shumtë nxënësish. Në profilin e mësimdhënësit punoi me devotshmëri, përkushtim e pasion të rrallë. Ky pasion e bëri fatlum në jetë duke përjetuar gjatë karrierës pedagogjike kënaqësinë dhe lumturinë magjepsëse të orëve të mësimit.

Një klasë e tërë përhumbej në sytë dhe fjalën e mësuesit të tyre. Mësuesi që nuk u shpjegonte nxënësve mësimin e ditës, por i pasuronte me dije për të përballuar vështirësitë e jetës. Dije që do i bënin më të mençur, më të duruar, më të besuar…Ai besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme.

Fare të ri, Lik Berishën e shohim drejtor shkolle në zonën e Luznisë, ku ra shpejt në sy për një punë drejtuese sistematike dhe serioze!

Po ashtu, Lik Berisha njihet si ish instruktor e sekretar në Komitetin e Rinisë së rrethit Dibër, ku spikati puna e tij e palodhur dhe e frytshme me rininë e gjithë rrethit.

Mirëpo, kullën e kuqe të PP në Peshkopi e trembte atëherë morali i të riut të guximshëm, Lik Berisha dhe ia prenë hovin duke mos e pranuar në "vallen" e tyre. Kështu ai spostohet në detyrën e drejtorit të librit dhe të filmit për rrethin e Dibrës, detyrë që e kreu gjithnjë me devocion.

I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit.

Në përditshmërinë e jetës ai mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale dibrane. Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos kudoherë dinjitoz. Si përfaqësues i së resë, diti të orientohej mirë në jetë dhe tí përgjigjet jetës me dinjitet, me burrëri dhe fisnikëri.

Në vitet pas 90-ës, ai punon në Drejtorinë Arsimore të rrethit Dibër. Më pas, transferohet në Tiranë, ku punon deri në kufirin e moshës së pensionit si mësues në shkolla të ndryshme të kryeqytetit.



Lik Berisha

Lik Berisha ka qenë shembull i mësuesit, intelektualit dibran, njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe shumë punëtor e i respektueshëm; pishtar i rëndësishëm i arsimit dhe kulturës dibrane dhe shqiptare.

Ai u shqua si përkrahës i flaktë i proceseve e shndërrimeve demokratike në vitet e pluralizmit, duke e konsideruar demokracinë sfidë ndaj sistemit që u shemb, sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të tij ishte vetëm konkurrenca në vlera.

Në harkun kohor të katër dekadave, me një performancë të shkëlqyer, Lik Berisha krijoi profilin e intelektualit erudit, të mësuesit të talentuar e brilant që s'reshti së aplikuari metodat e reja shkencore në mësimdhënie, si dhe të bashkëshortit e prindit shembullor. Së bashku me bashkëshorten e nderuar, Nazmijen, krijuan një familje dinjitoze, një vatër të ngrohtë respekti e mikpritjeje. Ai ishte sinteza e cilësive fisnike.

Lik Berisha ka qenë shembull i mësuesit, intelektualit dibran, njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe shumë punëtor e i respektueshëm; pishtar i rëndësishëm i arsimit dhe kulturës dibrane dhe shqiptare.

Kujtimet më të mira për atë burrë të mençur, bujar, patriot dhe edukator shembullor ruajnë ish koleget e tij të nderuar Lutfi Hanku, Sami Doda, Kamber Farruku, Sali Murrja, Sabri e Lutfi Pira, Zylfi Spata, Mevlud Buci, Sefedin Xharri etj, por dhe ish nxënësit e shumtë që e mbajnë mend për mprehtësinë e mendimit dhe forcën e argumentit.

Pikërisht, si i tillë ai u përcoll për në banesën e fundit , me të gjitha nderimet që meritonte, nga familjarët, të afërmit, miqtë e shokët e shumtë, nga Dibra, Tirana, Kruja, Tropoja, Durrësi, Elbasani, e nga e gjithë Shqipëria.

Zakonisht në të tilla përcjellje, gjithkush për të ndjerin flet fjalë të mira, por rrallë ndodh që gjithkush të përjetojë vlera dhe mirësi nga vetë ceremonia e lamtumirës. Natyrisht është vlerë numri aq i madh i miqve e shokëve që erdhën për ngushëllime në familje, shumicë kjo që nuk u pakësua as në varrimin e tij.

I përjetshëm qoftë kujtimi i Likë Berishës!



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

Aty ka mjaft materiale për t'u informuar si dhe për të siguruar fakte për debatet tuaja. Të gjithë ata që kanë dokumente të tjera ose informacione të panjohura, të na i dërgojnë, që t'i arkivojmë bashkë me të tjerat.

LINKU I PETICIONIT KUNDER DEVIJIMIT TE LUMENJVE

https://secure.avaaz.org/en/petition/Qeveria_e_Shqiperise_Government_of_Albania_Te_mos_lejohet_te_ndalohet_devijimi_i_lumenjve_VJOSA_dhe_RADIKA/?cYIvdgb

---

Pajtohu në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin
PDF ose kopjen print

Për informacion shkruaj:
rrugaearberit@gmail.com



Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (92). DHJETOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

RRETH E RROTULL-A
Ç'kemi asaj Dibre!
Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 2

ESE
Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë..
Nga **RAMIZ GJINI** - FAQE 11

BOTIME
Në një odë dibrane me Haziz Ndreun
Nga **VIRON KONA** - FAQE 15

REPORTAZH
Ismail Keta, tre herë Kampion Bote
Nga **DEFRIM METHASANI** - FAQE 12-13

Çfarë do të ndodhë me **ujërat e Radikës?**

Një panoramë e çështjes dhe skenat dhe papaskenat mes qeverisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë? A do t'i merret ujërat Radikës dhe nëse ndodh, sa ujë do ti merret dhe cilat janë ndikimet në mjedis? Një vështrim "Pro" dhe "Kundër" që nga nisja e kësaj historie deri më sot.

kryesore
RRUGA E ARBRIT
A ka **dritë** në fund të tunelit?
Viti që po lëmë pas ka shënuar një histori të rëndësishme të shoqërisë civile, pëmsa i përket përgjegjësive për sensibilizim të opinionit dhe qeverisë në mugëin e Arbrit. Që nga nisja e peticionit online më 18 mars 2013, iniciuar nga Dr. Gëzim Alpion, profesor në Universitetin e Birmingamit, mbi 5 mijë qytetarë e kanë firmosur atë online dhe në letër, duke treguar domosdoshmërinë e ndërtimit të saj sa më shpejt dhe sa më mirë.
FAQE 3

reflektime
Maqellarë, festë dhe firma ditën e Krishtlindjes
Nga **IDA NURÇE** - FAQE 2

Për shumë vjet
Vitin e Ri!
Ardhtë me
Rrugën e Arbërit
dhe mos shteroftë Radikën!

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën
RRUGA E ARBËRIT
Merr versionin PDF ose kopjen print.
Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Çështja e ujërave të Radikës po gjen një vend të gjerë në mjedisin mediatik dhe politik në Maqedoni dhe Shqipëri. Gazeta "Rruga e Arbërit" i ka kushtuar një vend të rëndësishëm kësaj çështje që në Mars 2012, me një shkrim të Prof. dr. ing. Abdyl Koleci, por për më shumë se një vit, asnjë institucion apo organizëm popullor nuk u interesua. Vetëm gjatë verës disa qytetarë filluan të kërkonin reagime publike lidhur me çështjen dhe në gushtë 2013, institucionet vendore në Komunën e Dibrës së Madhe reagjuan kundër projektit, për të ardhur sot në fund të vitit, si çështje themelore dhe e pasojgjëlhur mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.
Po si kanë mjedhur ngjarjet rreth devijimit të ujërave të Radikës?
(Lexoni në faqet 4-5)

opinion
Radika është pjesë e **historisë** dhe **kulturës** shqiptare
Nuk është me rëndësi se cila do të jetë sasia e ujit që do t'i mbetbehet Radikës: një pjesë e tij, gjysma apo edhe më të ktrëta (informatat lidhur me këtë janë kontradiktore); shpetimues është fakti që po proket një pasuri natyrore, një lumë, ndër më të pastrit në Evropë, që i të cilit, qofte edhe pjesërisht, nuk do të dierdhet më në detin Adriatik, si gjithmonë, pesjse mbahet mend, por në detin Egje!
Nga **AGIM VINCA** - FAQE 6

oponence mjedisore
Rrezikohet Rrëqebulli i Ballkanit në Maqedoni
Në mënyrë ironike, kur kërkuam leje për të vizituar zonën e "Fusha e Llukovës" jo vetëm që na u mohua leja por autoritetet kërkuan që të ishte e nevojshme që disa javë shtatë të tyre të mbikqyrnin pranimë tonë. Në hesiqenë që disa javë zonave duhet të jenë dukshëm zona të ndaluara, por kjo duhet të aplikohet si për bulkizuesit ashtu edhe për ambientalistët...
Nga **PETR HLOBIL** - FAQE 7



Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (91). NËNTOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

PROTESTA: PROJEKTI I HIDROCENTRALIT TË LUKOVËS ËSHTË ME PASOJA SHKATËRRUESE PËR DIBRËN

Ndal devijimit të rrjedhjes së lumit **Radika**!

Ndryshimi i rrjedhjes natyrore të lumit të Radikës do të shkaktojë një katastrofë ekologjike për Gryken e Radikës. Ndërmarrja publike e Maqedonisë është e angazhuar për ndërtimin e hidrocentralit të Llukovës, ndërkohë që protestuesit presin edhe reagimin zyrtar të qeverisë së Shqipërisë. Qytetarët dhe pushtetarët lokalë në Dibër të Madhe janë kundër: Mos na e thani ardhmërinë!

Retrospektivë e ngjarjeve dhe veprimtarive lidhur me problemin ekologjik të vjedhjes së ujërave të lumit Radika nga Qeveria e Maqedonisë përmes ndërmarjes publike për prodhim të energjisë elektrike "ELEM"
SPECIALE NË FAQET 6-7

rreth e rrotull-a
Ç'kemi asaj Dibre!
Nga **BUJAR KAROSHI**
Mbajti filloi mbarë për Dibrën. Një Mbërban u takua me kryeministrin maqedonas dhe i kërkoi falje, sepse në Tiranë ia kishte bërë pis kostumin me vezë të prishur. Pas këtij takimi, vizita e kryeministrit shqiptar në Shkup shkoi fjollë. Thuaj pastaj se ne diplomacinë nuk ta thokim për diplomaci... Media e Tiranës njoftoi se dibranë ishte arrestuar nga policia, por njëi gjë nuk u kuptua, kur e takoi kryeministrin maqedonas, para apo pas arrestimit!!
Policia e Bulqizës nisi një aksion kundër kamionëve me krom. Njaqë nuk mundet dot ta ndalojë krimin që ndodh në minierë, janë nën tokë të galeritë, policia ndalon kamionët, sepse nuk kanë fatura tatimore që të tregojë çmimin dhe peshën. Ndërkohë, ministri i energjetikës dhe minierave urdhëroi bllokimin lejeve për shoqëritë që shfrytëzojnë minierat e Bulqizës, sepse nuk kanë respektuar investimet dhe kushtet e sigurisë në punë. "Ky është shtet", dukej se thoshin fajmet e para nga terreni, por vetëm pak ditë më vonë, disa punëtorë dosjeshin të vetëdijeshëm. Po vuajmë për bukën e gojës, na linë të punojmë... si skllevër! Kur minatorët humbin jetën në galeri, e gjithë shoqëria klekon dorën e ngrohtë të qeverisë, kur shteti ofron dorën e ngrohtë, punëtorët klekojnë dorën e frohët të skllavërisë...
Për armët kimike, që desh helmuan Shqipërinë, u protestua edhe ne Peshkopi. Bulevardi i rrallëhërë në këto 20 vite u mbush me fëmijë me parulla në dorë: Mbrovi fëmijët tanë!... Vaç në Peshkopi gjen fëmijë me fëmijë! Të rritur i ndo-qën me sy nga trotuarë dhe kafet, duke bërë shaka dhe duke pirë raki...
(Vijon në faqen 10)

Roli dhe rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit
Nga **ENVER HALILI - FAQE 3**

Prof.dr. Artan Fuga, mbështetje të fuqishme për Rrugën e Arbrit
Profesori i njohur, u bën thirrje miqve të tij në Facebook të firmosin peticionin për Rrugën e Arbrit.
"Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht", shkruan ai.
Iniciatorët e peticionit për Rrugën e Arbrit janë duke negociuar me institucionet qeveritare për të bërë të mundur dorëzimin formal të tij. Peticioni, i nisur që më 18 mars 2013, deri më tani ka mbledhur një numër të konsiderueshëm firmash. Më e fundit firmosur personalitetë të ndryshme të kulturës, shkencës e artit, të cilët janë janë bërë të njohura për publikun në numrat e kaluar. Kohët e fundit, atë e kanë firmosur edhe artistët e humorit Agron Llakaj e Behar Mera si dhe kënglitari Driton Jashari. Por ajo që ka spikatur këtë muaj, janë komentet në faqen personale të Facebook-at të Prof. Dr., Artan Fugës, Anëtar i Akademisë së Shkencave.
"Unë vetë jam me origjinë jugore, por si shqiptar, ndjek me shumë interes ecurinë e fatit të Rrugës së Arbrit, shkruan ai një status në faqen e tij personale. Falendereoj të gjithë ata miq të kësaj faqeje që po e nënshkruajnë me dhjetra peticionin dashamirës në mbështetje të saj.
Menjëherë në faqen e tij ka pasur reagime pozitive për mbështetjen, të cilën Fuga detyrohet më vonë edhe ta sqarojë. "Dibranët e meritojnë të afrohen me Tiranën, se familjet e tyre e kanë mbajtur gjallë kulturën tiranase duke qenë bancoet të hershëm të saj. Çlarë popujlli, çlarë familjesh, çlarë miqsh. Pa zë, plot mençuri, të thjeshtë, besnikë, pashërtoni, familjarë të mirë, solidarë, besimtarë në vlera. Nuk thoshin kot "Ke dibranët" Eh, histori e gjatë...
Dikush i shpreh falënderimet profesorit, dhe ai përgjigjet me modesti: "Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht". Më pas, dikush i kujton se "shihët pa mbyllur akoma aksi i Jugut", dhe profesori ia kthen kaqë miqësisht dhe me humor: "Aleks i ndiesur, për të shkuar në Sarandë, bjeri shkurt nga Dibra or mik! Peticioni nuk thotë asëkënd se ndaloni punimet në aksin e Jugut. Pa merak. Firmose edhe ti, të lutem!" Këmbënguljes së Aleksit se edhe aksi Memaliaj - Tepelenës/shtë keq, Fuga nuk pëtton sërish t'i përgjigjet: "E di, ke shumë të drejtë, i ndiesur Aleks!Por zemra e njerit nis kur nuk mendon vetëm për të kaqen e vet, por edhe për të kaqen e fqtrit. Bashkë do t' a bëjmë Shqipërinë."
(Vijon në faqen 18)

Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides